amf ALBANIA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

# 2013

## RAPORT VJETOR

amf ALBANIA

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

# 2013

## raporti vjetor

© 2014
**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare**

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi jeni të lutur të citoni AMF.

Për çdo informacion të mëtejshëm, ju lutemi na kontaktoni.
Adresa: Rruga "Dora D'Istria", Nr. 10,  P.O.Box. 8363, Tiranë
Tel: +355-4-2251355  / 6
Faks: +355-4-2250686
E-mail: amf@amf.gov.al
Web: www.amf.gov.al

# Fjala Përshëndetëse e Kryetares



Enkeleda Shehi,
Kryetare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

*I nderuar lexues i Raportit Vjetor 2013,*

*Në vitin 2013 mund të themi se për AMF-në nisi një cikël i ri në ushtrimin e funksioneve të veta* të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve financiare që mbikëqyren. AMF po mbikëqyr dhe rregullon tregje me dinamikë të lartë zgjerimi, me strukturë në ndryshim të shpejtë dhe gjithnjë e më komplekse. Në vitin 2013, totali i aktiveve në këto tregje arriti në 73 miliardë lekë (5.36% e PBB-së) ose pothuaj dyfishi i këtij treguesi një vit më parë; numri i operatorëve në tregjet financiare u rrit; struktura e tregjeve ndryshoi.

*Aktiviteti i fondeve të investimeve,* në lekë dhe në euro, *ka dominuar zhvillimin në tregjet financiare, për shkak të zgjerimit të aktivitetit të tyre.* Totali i aseteve nën administrim arriti në 50.3 miliardë lekë dhe përbën 69% të totalit të aktiveve të tregjeve financiare që mbikëqyren. Në më pak se dy vjet veprimtari numri i anëtarëve të këtyre fondeve është rritur me mbi dyfishin e një viti më parë.

*Tregu i sigurimeve*, në tërësinë e tij, ka paraqitur një *situatë të ngjashme me atë të vitit 2012*, ku problematika kryesore ka vijuar të jetë tregu i sigurimit të detyrueshëm motorik. Sikurse u konkluda edhe nga analizat e kryera nga ekspertët e misionit FSAP, tregu i sigurimeve është përfshirë në një konkurrencë të ashpër, gjë që është pasqyruar me luhatjet e vazhdueshme të primit të shitjes së produktit MTPL. Vëllimi i primeve të shkruara bruto ka pësuar tkurrje me rreth 4.6% më pak se viti 2012, ndërsa *në strukturën e tregut nuk vërehen ndryshime*. Duke iu referuar ecurisë se primit të aplikuar dhe primit të rrezikut, në harkun kohor shator 2011 – mars 2014, vihet re që në *53% të këtij harku kohor tarifat janë aplikuar nën vlerën e primit të rrezikut.* Tarifimi i vazhdueshëm nën nivelin e primit të rrezikut ka cenuar ndjeshëm likuiditetin dhe përfitueshmërinë e siguruesve, duke vënë në rrezik shëndetin financiar të tyre dhe për rrjedhojë cilësinë e procesit të shlyerjes së detyrimeve ndaj të siguruarve. Autoriteti ka përforcuar kërkesat rregullatore për provigjonimin e kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik.

Sikurse e kam theksuar në raportimin e vitit 2012, problematikat me Byronë Shqiptare të Sigurimit dhe në veçanti me ecurinë e financimit të fondit të kompensimit, si dhe dëmet subjekt i këtij fondi, janë trajtuar me përparësi nga ana e Autoritetit. Detyrimet për pagesat e dëmeve të papaguara, subjekt i fondit të kompensimit, kanë pësuar rritje të ndjeshme. Në këtë drejtim, përveç numrit të lartë të mjeteve të pasiguruara në qarkullim, që në fund të vitit 2013 vlerësohej rreth 27% të mjeteve të regjistruara, kanë ndikuar edhe vonesat në kryerjen e pagesave, si dhe administrimi jo efektiv i BSHS-së. Për këtë arsye, vendimet e AMF-së të vitit 2013 në lidhje me FK përcaktuan një nivel mjaft më të lartë fondi, si dhe përcaktuan njohjen përkatëse të detyrimeve për dëmet e mbetura pezull.

Një risi në procesin mbikëqyrës në tregun e sigurimeve është edhe përfshirja e AMF-së për herë të parë në kolegjet mbikëqyrëse të grupeve financiare austriake të pranishme në Shqipëri, pasi kapitali austriak në tregun e sigurimeve në Shqipëri ka një peshë të konsiderueshme prej 35%.

*Tregu i pensioneve po ashtu ka shfaqur një ritëm të lartë zgjerimi.* Totali i aseteve neto të fondeve të pensioneve private u rrit me rreth 57% dhe numri i anëtarëve me 8% krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, ritmet e zgjerimit të tregut këto dy vite shfaqen jo konsistente, për arsye se zhvillimi i tregut nuk mbështetet me nxitësit e përshtatshëm fiskalë, sikundër ndodh në tregjet e tjera, kryesisht ato evropiane.

Bazuar në këto zhvillime, *veprimtaria rregulluese dhe mbikëqyrëse e Autoritetit po riformatohet* për t'iu përshtatur rritjes sasiore të aktivitetit të tregjeve, rritjes së kompleksitetit, si dhe

ndryshimit të profilit të risqeve të tyre. Ndryshimet që po pësojnë tregjet nën mbikëqyrje kanë konturuar strategjinë afatmesme të AMF-së në drejtim të tregjeve, të objektivave të punës, si edhe të forcimit të kapaciteteve administrative të Autoritetit. Detyrat e përcaktuara për tregjet që mbikëqyren synojnë stabilizimin dhe nxitjen e zhvillimit të tyre.

Për **tregun e sigurimeve** tashmë është miratuar paketa e **masave stabilizuese**, ku përfshihen: rivendosja menjëherë e financimit të fondit të kompensimit, duke u kërkuar shoqërive të sigurimit të financojnë detyrimet e papaguara, si dhe vendosja e kërkesave për mbajtjen dhe financimin e një rezerve monetare, në llogari qëllimore që mund të përdoret vetëm për pagesat e dëmeve. *Masat më afatgjata lidhen me nxitjen e zhvillimit të tregut të sigurimeve* nëpërmjet prezantimit të kërkesave për sigurim të përgjegjësisë në shërbime të ndryshme profesionale apo të sigurimit të rreziqeve nga katastrofat, trajtimit të përshtatshëm fiskal të produkteve, si dhe zbatimit të mbikëqyrjes me fokus riskun.

Për **tregun e fondeve private të pensionit**, objektivat lidhen me forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së dhe forcimin e institucionit, si parakusht për të ndërmarrë reformën në kolonën e dytë të pensioneve dhe për të nxitur zhvillimin e kolonës së tretë.

Për **fondet e investimit**, kërkohet përmirësimi i mëtejshëm i transparencës dhe komunikimit të informacionit për investitorët, si dhe forcimi i rregullave për administrimin e riskut, duke u bazuar në direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare. Periudha aktuale vlerësohet e favorshme për të nxitur zhvillimin e tregut të kapitaleve në vend, me qëllim që kërkesa e investitorëve për shumëllojshmëri produktesh të këtij tregu të ballafaqohet me një ofertë të përshtatshme të këtyre produkteve.

Sfidë e rëndësishme mbetet forcimi i kapaciteteve administrative të Autoritetit, si një premisë për rritjen e efektivitetit të procesit mbikëqyrës dhe rregullator, zbatimin e mbikëqyrjes me bazë riskun, nxitjen e zhvillimit të tregjeve, si dhe forcimin e mbrojtjes konsumatore.

Shpresoj që lexuesi të gjejë në këtë raport një burim të vlefshëm informimi dhe edukimi,

Me konsideratë,

Kryetare

## Misioni, objektivat, funksionet themelore

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) u krijua në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", si institucion juridik publik, i pavarur që raporton në Kuvendin e Shqipërisë.

AMF është një autoritet mbikëqyrës e rregullator, i integruar i tregjeve financiare të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private vullnetare në Shqipëri, që në vijim do t'u referohemi si tregje financiare nën mbikëqyrje.

**Misioni**

Misioni i AMF-së është të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e sigurt të tregjeve financiare nën mbikëqyrje.

**Objektivat**

Në përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave të parashikuara në ligj, AMF udhëhiqet nga këto objektiva:

- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve;
- Nxitja e transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare nën mbikëqyrje;
- Sigurimi i respektimit të ligjit.

**Funksionet kryesore të AMF-së**

Funksionet kryesore të veprimtarisë së AMF-së janë rregullimi dhe mbikëqyrja:

- e tregut të sigurimeve dhe e veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit, të risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin nga këto veprimtari;
- e tregut të letrave me vlerë dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen veprimtaritë e subjekteve të lidhura me investime në letra me vlerë e që veprojnë në këtë treg;
- e tregut të pensioneve vullnetare dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit të pensioneve vullnetare, të ofruara nga subjektet e licencuara për të operuar në këtë treg;
- e veprimtarive të tjera financiare jo-bankare, sipas përcaktimeve të bëra nga ligjet e veçanta të fushës.

## Bordi i AMF-së

Bordi është organi drejtues dhe vendimmarrës i AMF-së. Të gjithë anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me afat 5-vjeçar. Gjatë vitit 2013, përbërja e Bordit të AMF-së paraqitet si më poshtë:



| | | |
|---|---|---|
| Enkeleda SHEHI | Kryetare | Vendim i Kuvendit nr. 10, datë 16.02.2012 |
| Mati PEPA | Nënkryetar | Vendim i Kuvendit nr. 11, datë 16.02.2012 |
| Enkela IDRIZI | Nënkryetare | Vendim i Kuvendit nr. 124, datë 13.09.2011 |
| Miranda RAMAJ | Anëtare | Vendim i Kuvendit nr. 148, datë 22.12.2011 |
| Riçard MARKU | Anëtar | Vendim i Kuvendit nr. 149, datë 22.12.2011 |
| Kestrin KATRO | Anëtare | Vendim i Kuvendit nr. 123, datë 13.09.2011 |
| Astrit HADO | Anëtar | Vendim i Kuvendit nr. 122, datë 13.09.2011 |

# Përmbajtja

**Kapitulli 1**
**Ecuria e tregjeve financiare nën mbikëqyrje** **10**
1.1 Qëndrueshmëria financiare 10
1.2 Tregu i sigurimeve 12
1.3 Tregu i letrave me vlerë 37
1.4 Tregu i pensioneve private vullnetare 43
1.5 Masat korrigjuese dhe administrative 46

**Kapitulli 2**
**Rregullimi i tregjeve financiare nën mbikëqyrje** **48**
2.1 Veprimtaria e Bordit të AMF-së 48
2.2 Aktiviteti rregullator 48
2.3 Përafrimi me direktivat e BE-së për tregjet 50

**Kapitulli 3**
**Qeverisja dhe mbrojtja e konsumatorit** **54**
3.1 Qeverisja dhe sjellja në treg 54
3.2 Mbrojtja dhe edukimi i konsumatorëve 57

**Kapitulli 4**
**Transparenca dhe bashkëpunimi institucional** **59**
4.1 Transparenca dhe marrëdhëniet me publikun 59
4.2 Bashkëpunimi institucional 60

**Kapitulli 5**
**Organizimi i brendshëm** **67**
5.1 Pasqyrat financiare 67
5.2 Struktura organizative dhe kualifikimi profesional 69
5.3 Kuadri rregullator i AMF-së 72
5.4 Teknologjia e informacionit 74

**Sfida dhe projekte të ardhshme, 2014-2016** **75**

**SHTOJCA** **79**
A: Struktura e AMF-së
B: Lista e institucioneve të mbikëqyrura
C: Anëtarësime dhe marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara nga AMF
D: Raporti i Ekspertit Kontabël të Regjistruar të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 dhe 31 dhjetor 2013

# Kapitulli 1
# Ecuria e tregjeve financiare nën mbikëqyrje

## 1.1 Qëndrueshmëria Financiare

Tregjet financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së, në tërësinë e tyre, gjatë vitit 2013 ruajtën të njëjtin nivel veprimtarie, si nga pikëpamja e aktivitetit ashtu edhe nga numri i operatorëve. Dinamika e lartë e zgjerimit vijon të përjetohet në tregun e fondeve të investimeve dhe në tregun e pensioneve private vullnetare. Arsyeja kryesore qëndron në faktin që këto tregje kanë nisur të zhvillohen dy-tre vitet e fundit dhe janë në fazë ekspansioni. Ndërsa tregu i sigurimeve shënoi tkurrje, kryesisht si pasojë e liberalizimit të çmimeve në sigurimin e detyrueshëm motorik. Ky proces ka ndikuar në luhatje të çmimeve në treg, me tendencë uljeje në dy vitet e fundit, me qëllim që shoqëritë të mos humbasin kuotat e tregut. Kjo gjë, e kombinuar me shtrirjen e kufizuar të tregut në produktet e tjera të sigurimeve, ka bërë që në tërësi ky treg të tkurret.

Nga analiza e ecurisë së tregjeve nën mbikëqyrje vërehet që profili i rrezikut i tyre ka ndikim relativ të ulët në sistemin financiar. Prandaj, në gjendjen aktuale të zhvillimit, tregjet financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së **nuk mund të shndërrohen në rreziqe sistemike serioze për sistemin financiar në tërësi**.

Pavarësisht nga kjo, AMF, si autoritet mbikëqyrës e rregullator për tregjet financiare të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private vullnetare, kontribuon në nxitjen e qëndrueshmërisë financiare. Kjo, për faktin tashmë të provuar se sistemi financiar qëndron në themel të një ekonomie moderne dhe ndikon gjerësisht në zhvillimin tërësor të ekonomisë. Mësimet e nxjerra nga krizat financiare ndër vite kanë bërë që të rritet theksi në procesin rregullues e mbikëqyrës të këtij sektori, si dhe vëmendja të përqendrohet jo vetëm në mbarëvajtjen e institucioneve financiare të marra veçmas, por edhe në nxitjen e qëndrueshmërisë financiare të tregjeve në tërësi, rritjen e bashkërendimit të veprimeve të autoriteteve rregullatore në vend dhe përtej kufijve, duke forcuar standardet mbikëqyrëse e rregullatore sipas praktikave më të mira ndërkombëtare.

Tregjet e sigurimeve, fondeve të pensioneve vullnetare private, apo letrave me vlerë, nëse janë të zhvilluara mirë shndërrohen në elemente të rëndësishme të një sistemi financiar të efektshëm dhe të shëndetshëm. Ato shërbejnë si bazë solide për formimin e kapitalit, rritjen dhe prosperitetin e ekonomisë, nëpërmjet kontributit që kanë në zgjerimin dhe thellimin e sistemit financiar të një vendi.

Pavarësisht shkallës më të ulët të zhvillimit të tyre, tregjet financiare të mbikëqyrura nga AMF kanë rëndësi për sistemin financiar në vend, dhe për këtë arsye, kryefjala për sektorin financiar në një periudhë afatmesme do të jetë *stabilizimi* i tyre.

Me *stabilizimin* e tregjeve financiare nën mbikëqyrje kuptohet një paketë masash që do të ndërmerren nga AMF në periudhën afatmesme (2014-2016), të cilat kanë për objektiv nxitjen e zhvillimit të tregjeve financiare, zgjerimin e gamës së produkteve financiare, edukimin dhe

mbrojtjen konsumatore, mbështetjen e reformave financiare, si dhe rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe të rregullimit të tregjeve.

Kjo paketë masash stabilizuese është diskutuar dhe konsultuar gjatë periudhës tetor - nëntor 2013, me grupin e përbashkët të ekspertëve nga **Banka Botërore (BB)** dhe **Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)** në kuadër të **Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (misioni FSAP)**. Misioni, pasi analizoi veprimtarinë e AMF-së, në bashkëpunim me të përcaktoi një sërë objektivash, të cilat u konkretizuan në disa drejtime kryesore, ku do të mbështetet zhvillimi afatmesëm dhe *stabilizimi* që AMF synon për tregjet nën mbikëqyrje:

- **Forcimi i pavarësisë së AMF-së**, sidomos pavarësisë operacionale dhe financiare, si kusht i domosdoshëm për të përmirësuar efektivitetin e procesit rregullator e mbikëqyrës.
- **Përmirësimi i funksionimit të tregut të sigurimeve** nëpërmjet vendosjes së standardeve të mirëpërcaktuara në lidhje me rezervat minimale, likuiditetin, zbatimin e mbikëqyrjes me bazë rreziku, apo të marrjes së masave me ndikim afatgjatë, të tilla si zhvillimi i programeve për sigurimin e përgjegjësisë së shërbimeve të ndryshme apo të risqeve nga ngjarjet e natyrës së katastrofave.
- **Mbrojtja e konsumatorëve**, duke përcaktuar masa që të rritin shkallën e transparencës dhe thjeshtësisë së dhënies së informacionit nga institucionet financiare për klientët e tyre. Gjithashtu, mbrojtja e konsumatorëve synohet të sigurohet nëpërmjet *nxitjes së konkurrencës së shëndetshme* në tregun financiar, që nënkupton ofrimin e produkteve me kosto të arsyeshme për klientët, por pa cenuar apo rrezikuar vijueshmërinë e ofrimit të shërbimeve dhe të përfitimeve që pret të marrë një klient nga institucionet financiare, të tilla si pagesat për dëmet nga shoqëritë e sigurimit; ofrimin e kthimit real nga investimet në fonde apo përfitimin e pagesave të pensioneve nga fondet e pensioneve private.
- **Ushtrimi i mbikëqyrjes së konsoliduar** që nënkupton një fazë të re në procesin mbikëqyrës të institucioneve financiare dhe të ndërthurjes së kompetencave mbikëqyrëse të AMF-së dhe Bankës së Shqipërisë (BSH), në banka dhe fondet e investimeve. Kjo dikton një forcim të bashkëpunimit të derisotëm me qëllimin e mbikëqyrjes më efektive të risqeve të tregut e të likuiditetit.
- **Nxitja e zhvillimit të shtyllës së tretë të pensioneve** dhe ndërtimi i shtyllës së dytë, si pjesë e reformës në fushën e pensioneve. Në këtë aspekt AMF ka një rol të rëndësishëm që nënkupton forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse për të siguruar mbikëqyrje të kujdesshme të fondeve të pensioneve dhe qëndrueshmëri të tyre.

Sigurisht që e gjithë strategjia për *stabilizim* po vihet në jetë jo me përpjekje të izoluara nga AMF, por në bashkëpunim të ngushtë me institucione të tjera, në veçanti me BB dhe FMN, dhe sidomos me Bankën e Shqipërisë (BSH), Agjencinë e Sigurimit të Depozitave (ASD)

dhe Ministrinë e Financave (MF), në kuadër të Grupit Këshillimor për Stabilitetin Financiar (GKSF).

Në vijim të analizës së kryer për ndikimin që kanë risqet e tregjeve financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së në sektorin financiar në tërësi, gjatë vitit 2013 AMF zhvilloi një strategji të administrimit të krizave me fokus tregun e sigurimeve. Hartimi i këtij dokumenti strategjik përmbushi angazhimin që AMF mori në kuadër të GKSF-së për të hartuar një plan strategjik, si pjesë e një plani kombëtar për bashkërendimin e veprimeve të institucioneve në situata të mundshme krizash, që mund të prekin tregjet financiare.

## 1.2 Tregu i Sigurimeve

Shqipëria karakterizohet nga një treg financiar sigurimesh relativisht i vogël nga pikëpamja e numrit të shoqërive që veprojnë në treg dhe vëllimit total të primeve të shkruara bruto. Gjatë vitit 2013, numri i shoqërive që kryejnë aktivitetin e sigurimit qëndroi i pandryshuar, ndërsa aktiviteti i tyre u tkurr. Primet e shkruara bruto për vitin 2013 kapën shifrën 8.54 miliardë lekë, duke u ulur me afro 4.61% krahasuar[1] me vitin 2012.

**Grafik 1: Ecuria e primeve të shkruara bruto dhe dëmeve të paguara bruto në vite** *(Në mln. lekë)*




| | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Dëme të paguara bruto* | 1,038 | 1,227 | 1,287 | 1,294 | 1,571 | 1,733 | 2,299 | 2,228 | 2,808 | 2,696 |
| *Prime të shkruara bruto* | 4,151 | 4,011 | 4,542 | 5,948 | 7,076 | 7,877 | 8,200 | 8,215 | 8,950 | 8,538 |

Shënim: [1] Krahasimi është bërë me shifrat e raporteve të shoqërive të sigurimit të audituara të vitit 2012.

**Tabela 1: Shoqëri sigurimi të licencuara sipas produkteve të sigurimit, 2009-2013** *(Në numër)*

| *Emërtimi* | *2009* | *2010* | *2011* | *2012* | *2013* |
|---|---|---|---|---|---|
| Sigurim Jo-Jetë[2] | 7 | 7 | 7 | 8 | 8 |
| Sigurim Jetë | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 |
| Miks (Jetë dhe Jo-Jetë)[3] | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |

Në strukturë, tregu vazhdoi të mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën rreth 88.13% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto në këtë treg. Ndërsa sigurimet e Jetës, sollën 11.24% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto. Gjatë 2013, sigurimet vullnetare zunë 54.72% dhe ato të detyrueshme zunë 45.28% të totalit të primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve.

**Grafik 2: Struktura e tregut të sigurimeve, 2013**




Edhe gjatë vitit 2013, tkurrja e tregut të sigurimeve është e ndikuar kryesisht nga dinamika e uljes së sigurimeve të detyrueshme motorike.

Shënim:
[2] Një nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës kryen edhe veprimtarinë e risigurimit. (SIGAL Uniqa Group Austria sh.a.)
[3] INSIG sh.a. - Shoqëria e vetme me kapital tërësisht shtetëror që ushtron veprimtarinë e sigurimit prej më shumë se 20 vitesh në tregun shqiptar, ushtron veprimtari në klasat e Jo-Jetës dhe Jetës.

**Tabela 2: Primet e shkruara bruto të sigurimit dhe ndryshimi vjetor, 2011-2013**

| *Veprimtaria* | *Primet e shkruara bruto* | | | | | | *Ndryshimi në %* | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | *(mln. lekë)* | | | *(mijë euro)*[4] | | | *(në lekë)* | |
| | *2011* | *2012* | *2013* | *2011* | *2012* | *2013* | *2012/2011* | *2013/2012* |
| Jeta | 941 | 880 | 960 | 6,707 | 6,329 | 6,844 | -6.48 | 9.08 |
| Jo-Jeta | 7,256 | 8,042 | 7,524 | 51,717 | 57,837 | 53,643 | 10.83 | -6.44 |
| Risigurimi | 18 | 28 | 54 | 131 | 202 | 383 | 52.91 | 91.12 |
| **Total** | **8,215** | **8,950** | **8,538** | **58,555** | **64,369** | **60,870** | **8.94** | **-4.61** |

## Shpërndarja gjeografike e sigurimeve

Duke i hedhur një vështrim volumit të primeve të shkruara bruto, sipas shpërndarjes gjeografike, vihet re një përqendrim i tregut të sigurimeve në prefekturat e mëdha.

Një tregues i rëndësishëm i këtij tregu është primi për frymë, i cili për vitin 2013 është rreth 2,929 lekë për frymë, me një ulje prej 272 lekë krahasuar me një vit më parë.

Përsa i përket primit për frymë sipas prefekturave, Prefektura e Tiranës me rreth 7,233 lekë për frymë zë vendin e parë, e pasuar nga Prefektura Gjirokastër me rreth 2,705 lekë për frymë, dhe më tej janë Durrësi dhe Vlora përkatësisht me rreth 2,265 lekë për frymë dhe rreth 1,525 lekë për frymë.

**Shpërndarja e primeve të sigurimit sipas prefekturave**




Shënim: [4] Kursi mesatar vjetor i këmbimit në Euro sipas viteve përkatëse, marrë nga faqja zyrtare e Bankës së Shqipërisë, www.bankofalbania.org (Viti 2011, 1 euro = 140.30 ; Viti 2012, 1 euro = 139.04; Viti 2013, 1 euro = 140.26 lekë).

**Grafik 3: Dëmet e paguara sipas prefekturave**




## Analiza Financiare

Në zbatim të kuadrit rregullator ekzistues, edhe gjatë vitit 2013, AMF ka mbikëqyrur dhe analizuar tregun e sigurimeve, duke vlerësuar pozicionin financiar, rezultatet dhe treguesit teknikë të veprimtarisë së shoqërive të sigurimit. AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e kërkesës ligjore mbi fondin e garancisë[5] të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij.

Shoqëritë e sigurimit zotërojnë fondin e garancisë të investuar në "depozita qëllimore" me afat maturimi jo më të vogël se 1-vjeçar pranë bankave të nivelit të dytë dhe bono thesari. Totali i fondit të garancisë për tregun është në vlerën 4.70 miliardë lekë më 31.12.2013. Tregu i sigurimeve ka qenë i mirëkapitalizuar, gjë që ilustrohet nga treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në masën 114.10%, duke bërë të mundur përballimin e një viti relativisht të vështirë e me luhatje të rezultateve teknike.

Shënim: [5] Fondi i garancisë nënkupton një shumë në mjete monetare (vlera e së cilës është përcaktuar në nenin 98 të Ligjit Nr. 9267, datë 29.7.2004) e depozituar nga shoqëria e sigurimit ose e risigurimit në një llogari bankare qëllimore me të njëjtin emër, në bankat në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku shoqëria ka selinë qendrore të saj, e detyrueshme për t'u disponuar nga siguruesi që nga çasti i fillimit të veprimtarisë dhe në vazhdim.

## Tabelë 3: Struktura dhe dinamika e aktivit dhe pasivit të tregut të sigurimeve[6]

| *Emërtimi* | *31.12.2011* | *31.12.2012* | *31.12.2013* |
|---|---|---|---|
| | | ***struktura (në %)*** | |
| Depozita | 45.90 | 41.38 | 37.81 |
| Toka dhe ndërtime | 9.32 | 9.56 | 9.25 |
| Aksione dhe pjesëmarrje | 13.65 | 12.90 | 12.11 |
| Bono thesari | 4.89 | 6.44 | 7.41 |
| Debitorë | 8.66 | 10.02 | 10.21 |
| Aktive të tjera | 17.58 | 19.70 | 23.22 |
| **Totali i Aktivit** | **100.00** | **100.00** | **100.00** |
| Provigjonet teknike bruto | 39.44 | 40.14 | 41.23 |
| Detyrime të tjera | 7.79 | 9.72 | 13.38 |
| Kapitalet e veta | 52.77 | 50.14 | 45.39 |
| **Totali i Pasivit** | **100.00** | **100.00** | **100.00** |

| *Emërtimi* | *31.12.2011* | *31.12.2012* | *31.12.2013* |
|---|---|---|---|
| | | ***dinamika (në %) viti i mëparshëm = 100*** | |
| Depozita | 96.94 | 96.43 | 97.94 |
| Toka dhe ndërtime | 97.82 | 109.80 | 103.69 |
| Aksione dhe pjesëmarrje | 157.41 | 101.10 | 100.60 |
| Bono thesari | 107.04 | 140.90 | 123.24 |
| Debitorë | 110.03 | 123.82 | 109.22 |
| Aktive të tjera | 116.07 | 119.86 | 126.32 |
| **Totali i Aktivit** | **107.37** | **106.98** | **107.18** |
| Provigjonet teknike bruto | 123.76 | 108.89 | 110.08 |
| Detyrime të tjera | 103.76 | 133.42 | 147.61 |
| Kapitalet e veta | 98.16 | 101.65 | 97.03 |
| **Totali i Pasivit** | **107.37** | **106.98** | **107.18** |

Shënim: [6] Pasqyrat e bilancit në këtë tabelë përfshijnë shoqëritë e sigurimeve të Jo-Jetës dhe Jetës. Raportimi i pasqyrave financiare të shoqërive të sigurimit bëhet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe mbështetur në bazën ligjore të AMF-së.

Gjatë vlerësimit të situatës financiare të shoqërive të sigurimit, me të dhënat e 31.12.2013 u vu re se:

Aktivet e tregut të sigurimeve krahasuar me 31.12.2012 u rritën me 1.49 miliardë lekë ose 7.18%, rritje kjo relativisht më e lartë krahasuar me vitet e mëparshme. Rritja e aktiveve të tregut reflektohet në rritjen e investimeve likuide si depozita në institucione krediti dhe bono thesari, debitorë, parapagime dhe të ardhura të llogaritura dhe provigjoni teknik i risiguruesit. Investimet në depozita në institucione krediti dhe bono thesari dominuan në totalin e aktiveve të shoqërive të sigurimit me 45.22%.

Kapitalet e veta për tregun e sigurimeve u reduktuan me 2.97% krahasuar me 31.12.2012 si rrjedhojë e nivelit të konsiderueshëm të humbjeve të mbartura, rezultatit financiar me humbje të periudhës, si dhe rritjes në detyrimet e tjera. Rritja në detyrimet e tjera në masën 47.61%, ose në vlerën 958 milionë lekë krahasuar me 31.12.2012, është rezultat i rritjes në kontratat dhe marrëdhëniet e shoqërive të sigurimit me risiguruesit. Ndërkohë provigjonet teknike bruto në 31.12.2013 janë rritur me 10.08% ose 838 milionë lekë krahasuar me 31.12.2012.

**Tabelë 4: Disa të dhëna mbi tregun e sigurimeve** *(Në mln. lekë)*

| *Periudha Ushtrimore* | | *2009* | *2010* | *2011* | *2012* | *2013* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Totali i aktiveve** | | **16,227** | **18,039** | **19,368** | **20,720** | **22,209** |
| | Jeta | 2,919 | 2,473 | 2,884 | 3,207 | 3,788 |
| | Jo-Jeta | 13,308 | 15,556 | 16,484 | 17,513 | 18,421 |
| **Totali i investimeve** | | **10,830** | **11,855** | **12,839** | **14,209** | **14,672** |
| | Jeta | 2,101 | 1,832 | 1,992 | 1,996 | 2,812 |
| | Jo-Jeta | 8,729 | 10,023 | 10,847 | 12,213 | 11,860 |
| **Provigjonet teknike bruto** | | **6,229** | **6,171** | **7,638** | **8,317** | **9,155** |
| | Jeta | 361 | 644 | 853 | 942 | 1,175 |
| | Jo-Jeta | 5,868 | 5,527 | 6,785 | 7,375 | 7,980 |
| **Totali i kapitalit** | | **8,546** | **10,413** | **10,221** | **10,389** | **10,081** |
| | Jeta | 1,754 | 1,764 | 1,791 | 1,899 | 2,195 |
| | Jo-Jeta | 6,792 | 8,649 | 8,430 | 8,490 | 7,886 |
| **Totali i kapitalit të nënshkruar** | | **5,787** | **6,684** | **7,607** | **8,617** | **9,022** |
| | Jeta | 1,097 | 1,278 | 1,283 | 1,284 | 1,351 |
| | Jo-Jeta | 4,690 | 5,406 | 6,324 | 7,333 | 7,671 |
| **Totali i investimeve të huaja** | | **1,985** | **3,587** | **3,472** | **3,597** | **3,435** |
| | Jeta | 355 | 347 | 380 | 398 | 458 |
| | Jo-Jeta | 1,630 | 3,240 | 3,092 | 3,199 | 2,977 |
| **Primi i fituar neto** | | **6,092** | **6,680** | **6,792** | **6,736** | **6,101** |
| | Jeta | 496 | 636 | 819 | 823 | 890 |
| | Jo-Jeta | 5,596 | 6,044 | 5,973 | 5,913 | 5,211 |

Bazuar në sistemin me treguesit e paralajmërimit të hershëm, është vërejtur se:

**Raporti i mbajtjes neto** në tregun shqiptar të sigurimeve të Jo-Jetës është në masën 67.45%. Ky raport është reduktuar në krahasim me periudhat paraardhëse, si rezultat i marrëdhënieve dhe kontratave të shoqërive të sigurimit me risiguruesit, specifikisht marrëveshjeve të risigurimit *Quota Share* në vlera domethënëse për shoqëritë e sigurimit me kapital të huaj.

**Raporti i kombinuar**, i cili përfaqëson rezultatin e llogarisë teknike të shoqërisë së sigurimit, ka një tendencë në rritje, nga 97.05 në 129.81%, tregues ky i humbjeve të tregut Jo-Jetës në aktivitetet operacionale. Rritja në këtë raport vjen si nga rritja e raportit të shpenzimeve ashtu dhe nga rritja në raportin e dëmeve neto.

**Raporti dëme/prime** për tregun shqiptar të sigurimeve të Jo-Jetës ka arritur në 49.87%. Faktorët që kanë ndikuar në rritjen e këtij raporti janë rritja në nivelin e provigjoneve për dëme pezull që ndikon drejtpërdrejt në rritjen e nivelit të shpenzimeve neto për dëme të paguara, si dhe rënia në primet e fituara neto. Rënia e volumit të primeve të shkruara bruto për tregun e Jo-Jetës, kryesisht si rezultat i aplikimit të tarifave të ulëta në sigurimet e detyrueshme, si dhe cedimi i lartë në risigurim nga disa shoqëri me kapital të huaj, kanë ndikuar në rënien e primeve të fituara neto.

**Raporti i shpenzimeve** në masën 79.94%, ka pasur një tendencë në rritje gjatë vitit 2013, duke tejkaluar normat e përcaktuara ndërkombëtare. Peshën më të madhe në strukturën e shpenzimeve e zënë shpenzimet operative të veprimtarisë në masën 69.11% për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës. Faktorët që ndikojnë në vlerën në rritje të këtij raporti për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës janë rritja në totalin e shpenzimeve dhe reduktimi në primet e shkruara neto krahasuar me periudhën paraardhëse.

**Tabelë 5: Teste IRIS për tregun e sigurimeve Jo-Jetë** *(Në %)*

| *Raporti* | *31.12.2011* | *31.12.2012* | *31.12.2013* | *Kufiri* | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *MIN* | *MAX* |
| Norma e rritjes së primit | - 1.06 | 10.94 | -6.10 | -40 | 40 |
| Raporti i mbajtjes neto | 81.61 | 76.89 | 67.45 | 40 | 80 |
| Raporti dëme/prime neto | 42.97 | 34.27 | 49.87 | 50 | 80 |
| Raporti i shpenzimeve | 73.98 | 62.78 | 79.94 | 25 | 50 |
| Raporti i kombinuar | 116.96 | 97.05 | 129.81 | 85 | 105 |
| Të ardhurat nga investimet | 7.67 | 6.37 | 10.81 | 4 | 8 |
| Raporti operativ | 107.50 | 88.76 | 117.49 | n/a | 100 |
| Raporti i kapitalit | 57.00 | 55.30 | 43.76 | 20 | 50 |
| Raporti i provigjoneve teknike | 66.78 | 73.43 | 52.31 | 10 | 30 |
| Raporti i aftësisë paguese | 333.30 | 346.00 | 290.05 | 150 | 300 |

**Grafik 4: Treguesit IRIS 2013 (sipas shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës)**



Duke parë dinamikën në vite të treguesve të paralajmërimit të hershëm, vihet re se **norma e rritjes së primit**, ndonëse brenda kufijve të lejuar, ka pasur një tendencë në ulje. Rënia e primeve të shkruara bruto për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës me 6.10% dhe primeve të fituara neto ka ardhur kryesisht si pasojë e rënies së çmimeve të produkteve motorike.

**Raporti i kapitalit ndaj provigjoneve teknike**, për tregun Jo-Jetë, ka pasur një tendencë në ulje gjatë vitit të fundit. Në 31.12.2013 ky raport është ulur me 43.67% krahasuar me 55.30% që ka qenë në 31.12.2012.

Rënia e primeve të fituara neto ka ndikuar në rritjen e raportit të të ardhurave nga investimi, raportin e dëmeve neto dhe raportin e shpenzimeve.

## Inspektimi në shoqëritë e sigurimeve

Gjatë vitit 2013, AMF ka realizuar 26 inspektime në vend në shoqëritë e sigurimit të Jetës dhe Jo-Jetës, nga të cilat 13 janë kryer tek agjentët e shoqërive të sigurimit dhe 13 të tjera në shoqëritë e sigurimit.

Inspektimet në shoqëritë e sigurimit përfshinin çështje që lidheshin me verifikimin e zërave të pasqyrave financiare, shqyrtimin e politikave dhe procedurave të brendshme të shoqërisë, me marrjen në sigurim, limitet e mbajtjes së rrezikut sipas llojit të produktit të marrë në sigurim, analizën e përgjegjësive të kontraktuara nga shoqëritë për vitin e mbyllur financiar, risigurimet, pagesat e risiguruesve. Po ashtu, gjatë inspektimeve është verifikuar llogaritja e rezervës së risiguruesve, efektiviteti i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe siguria e sistemeve të informacionit.

Në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve, për të garantuar një trajtim të drejtë dhe ligjor të tyre, në këto inspektime u verifikuan edhe procedurat e ndjekura për trajtimin e dëmeve të paguara dhe atyre të mbetura pezull (përfshirë dëmet në proces gjyqësor dhe dëmet e refuzuara), vlerësimin, menaxhimin dhe praktikat e provigjonimit të tyre.

Nga inspektimet e kryera në shoqëritë e sigurimit janë evidentuar çështjet e mëposhtme që lidhen me:

- Raportim të pasaktë dhe jo në kohë, në bazën e të dhënave të regjistrit të dëmeve të shoqërive të sigurimit, lidhur me dëmet shëndetësore në proces gjyqësor të sigurimit të detyrueshëm motorik;
- Administrim të rreziqeve të kontraktuara nga shoqëritë e sigurimit;
- Trajtimin jo të drejtë dhe jashtë afateve kohore të policëmbajtësve;
- Transaksione financiare me palë të lidhura;
- Sistemin e kontrollit të brendshëm të shoqërive, përfshirë këtu edhe sigurinë e sistemeve të informacionit.

AMF qëndron në komunikim të vazhdueshëm me shoqëritë e sigurimit, duke u përcjellë atyre gjetjet dhe rekomandimet përkatëse të inspektimit nëpërmjet raportit të inspektimit, i cili u dërgohet shoqërive të sigurimit në formën e "Letrës për drejtuesit", duke vendosur edhe afate kohore për zbatimin e rekomandimeve të lëna në këtë raport.

Pas këtyre gjetjeve, AMF ka marrë masa në formën e vendimeve të Bordit apo edhe nëpërmjet shkresave përkatëse drejtuar shoqërive të sigurimit, të cilat konsistonin në:

- Eliminimin e shkeljeve për detyrimin për raportim të saktë dhe të detajuar;
- Respektimin e afateve të trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim;
- Eliminimin e shkeljeve lidhur me refuzimin pa shkaqe ligjore të praktikave të dëmeve;
- Plotësimin e mungesave në dokumentacionin e dosjeve të dëmeve me qëllim pagesën sa më shpejt të palës së dëmtuar.

Në vijim, zbatimi i këtyre masave ka sjellë përmirësime në drejtim të administrimit të rreziqeve të kontraktuara, në raportimin e saktë të dëmeve në proces gjyqësor në bazën e të dhënave të regjistrit të dëmeve të shoqërive të sigurimit, si edhe në reduktimin e transaksioneve financiare me palë të lidhura.

Gjatë 2013, AMF realizoi 9 inspektime të planifikuara dhe 4 të paplanifikuara tek agjentët në sigurime. Objekti i këtyre inspektimeve konsistoi në verifikimin në vend të të dhënave të policave të sigurimit TPL të shitura dhe të raportuara në sistemin e shitjeve *online* në AMF, duke përfshirë këtu edhe të dhënat e transaksioneve bankare të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik të shitura dhe të raportuara në AMF sipas projektit "Integrimi i regjistrit të policave me shitjen nëpërmjet sistemit bankar". Verifikimi i transaksioneve bankare për policat e sigurimit TPL kryhet në vazhdimësi nga AMF si pranë agjentëve të sigurimit, ashtu edhe në bankat e nivelit të dytë ku realizohen këto transaksione.

Nga inspektimet e kryera tek agjentët në sigurime u evidentuan problematika që lidhen me raportim të pasaktë dhe jo në kohë reale në regjistrin e shitjeve *online* të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik, të kodit të raportimit të AMF dhe kodit të transaksionit bankar në policën fizike të sigurimit TPL.

Në kuadër të bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë, në funksion të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve financiare, AMF ka kryer gjatë vitit 2013 tre inspektime të përbashkëta tematike në disa banka të nivelit të dytë. Kështu, objekt i këtyre inspektimeve në vend ishte ekspozimi agregat i shoqërive të sigurimit për produktet e sigurimit të garancive bankare, verifikimi i depozitave të bllokuara, kredive të marra nga shoqëritë e sigurimit pranë bankave të nivelit të dytë, si edhe kolateralet e garantuara prej tyre.

Nga këto inspektime të përbashkëta kanë rezultuar problematika lidhur me raportime të pasakta në AMF të të dhënave të policave të sigurimit të zjarrit dhe rreziqeve shtesë, me përfitues bankat, konkretisht:

- Shumën e siguruar, duke raportuar vlerë më të vogël se vlera e përcaktuar në policën fizike të sigurimit;
- Periudhat e mbulimit të kontratës së sigurimit;
- Numrat serialë të policës së sigurimit dhe vlerës së primit të sigurimit.

Sa më sipër, AMF ka kërkuar prej shoqërive të sigurimit marrjen e masave për eliminimin e shkeljeve të konstatuara.

## Provigjonet Teknike

Në kuadrin e analizës financiare, AMF vlerëson nëse provigjonet teknike janë të mjaftueshme dhe në përputhje me nivelin e rrezikut të kontraktuar nga shoqëritë. Mjaftueshmëria e provigjoneve teknike, vlerësohet në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe mospërmbushja e këtij detyrimi përbën shkelje të rregullave të menaxhimit të rrezikut.

Ecuria në nivel tregu e provigjoneve teknike, ndër vite, shfaq një tendencë në rritje. Peshën më të lartë nga pikëpamja e veprimtarisë së ushtruar e mbajnë provigjonet teknike bruto të shoqërive të Jo-Jetës, duke reflektuar edhe strukturën e tregut të sigurimeve në Shqipëri.

### Provigjoni Teknik

Provigjoni teknik është shuma e llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas mënyrave aktuariale të caktuara, e cila mbahet nga siguruesi, për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit.

**Provigjonet teknike përfshijnë:**

- Provigjonet për primet e pafituara;
- Provigjonet për bonuse dhe rabate;
- Provigjonet për dëmet;
- Provigjone të tjera teknike.

Provigjonet matematike duhet të mbahen nga shoqëritë e sigurimit që operojnë në sigurimin e Jetës. Po kështu, këto provigjone duhet të mbahen nga shoqëritë e Jo-Jetës për produktet ku primet janë akumuluar në formën e kursimeve apo aktiveve të përdorura për mbulimin e rreziqeve në vite të ardhshme për sigurime të natyrës afatgjatë.

Provigjone të tjera teknike krijohen duke iu referuar detyrimeve të pritshme dhe rreziqeve për dëme të mëdha të mundshme, të tilla si: për sigurimin e përgjegjësive nukleare, prodhimeve farmaceutike, tërmeteve, përmbytjeve, si dhe provigjone për detyrime ose rreziqe të tjera, që nuk përfshihen në asnjë nga provigjonet e përmendura më sipër.

**Grafik 5: Provigjoni Teknik Bruto** *(Në mln. lekë)*




Nga të dhënat në nivel tregu, të pasqyruara në grafikun më lart, vihet re tendenca në rritje e treguesit të provigjonit teknik të dëmeve dhe primeve, duke reflektuar edhe përpjekjet e vazhdueshme të Autoritetit në drejtim të përmirësimit të këtij treguesi. AMF në mënyrë të vazhdueshme ka dhënë rekomandime për përmirësimin në rritje të treguesit të provigjonit teknik. Këto rekomandime janë bazuar në analizat e të dhënave të shoqërive të sigurimit, në gjetjet e konstatuara gjatë inspektimeve në vend, si dhe nga informacioni i marrë nga palë të treta (gjykatat për dëmet në proces gjyqësor) lidhur me detyrimet dhe rrezikun ndaj të cilit janë të ekspozuara shoqëritë.

## Sigurimi i Detyrueshëm Motorik

Edhe pse tregu i sigurimeve të Jo-Jetës, gjatë vitit 2013, shënoi ulje të primeve të shkruara bruto me rreth 6.47% krahasuar me vitin 2012, sigurimi motorik vazhdoi të zërë peshën kryesore në këtë treg. Ai solli pjesën më të madhe të të ardhurave, ose 58.27% të totalit të primeve të shkruara bruto të sigurimeve të Jo-Jetës.

**Grafik 6: Struktura e tregut të Jo-Jetës, primet e shkruara bruto, 2013**



Në vitin 2013, primet e shkruara bruto në sigurimin motorik arritën vlerën 4.38 miliardë lekë, kundrejt 5.12 miliardë lekë në vitin 2012. Efekti uljes prej 14.39% i primeve të sigurimit motorik ka ardhur kryesisht nga produkti MTPL e brendshme.

**Grafik 7: Sigurimi motorik, primet e shkruara bruto 2004-2013** *(Në mln. lekë)*




### Liberalizimi i Sigurimit të Detyrueshëm Motorik

AMF në bashkëpunim me BB, ka realizuar projektin mbi Liberalizimin e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në Shqipëri, projekt ky që mundëson kalimin drejt një tarifimi më efektiv në llogaritjen e primit të sigurimit të detyrueshëm motorik, që është ai me bazë riskun.

**Objektivat themelorë të strategjisë së zhvillimit të tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik janë:**

- Çmime të sigurimit të detyrueshëm motorik bazuar në risk;
- Ndërtimi i mekanizmave të saktë të grumbullimit të të dhënave;
- Reduktimi i mashtrimeve, duke ndërtuar edhe mekanizmat e përshtatshëm për t'i luftuar ato;
- Forcimi i kapaciteteve të siguruesve për të menaxhuar bilancet e tyre;
- Minimizimi i numrit të të pasiguruarve.

### AMF e ka konsideruar të parakohshëm liberalizimin e sigurimin e detyrueshëm motorik

Por pavarësisht projektit të nisur, tregu u liberalizua në një moment delikat dhe pa përgatitjen e të gjithë aktorëve. Liberalizimi do të kryhej me bashkëpunimin dhe asistencën e BB-së dhe pasi të ishte ngritur infrastruktura e duhur për këtë qëllim. Mendimet e AMF-së për etapat e procesit nuk u morën parasysh. Ajo që AMF kërkonte të shmangte, duke propozuar një proces gradual liberalizimi që të mbështetej paraprakisht me infrastrukturë rregullatore dhe teknologjike, ishte pikërisht luhatja e shpeshtë e çmimeve dhe sidomos zbatimi i çmimeve të ulëta për marrje tregu. Duke anashkaluar institucionin e AMF-së, ekzekutivi dhe legjislativi vepruan me një proces të shpejtë liberalizimi dhe pasoja e kësaj vendimmarrjeje është pikërisht ajo që ka ndodhur dy vitet e fundit në këtë treg.

Nisur nga gjendja aktuale, kur tarifat e zbatuara në produktet e sigurimit kanë pësuar luhatje të shpeshta dhe vlerësohen se janë në nivele jo të përshtatshme në raport me risqet që karakterizojnë produktet, AMF ka theksuar nevojën e zbatimit të sistemit *Bonus-Malus*.

Nga krahasimi i të dhënave të primit mesatar për sigurimin e detyrueshëm motorik me vendet e tjera të rajonit, Shqipëria ka një nivel primi që është më i ulëti në rajon.

**Grafik 8: Primi mesatar i sigurimit të detyrueshëm motorik**[7] *(Në euro)*




## Dëmet

Gjatë vitit 2013, shoqëritë e sigurimeve paguan rreth 2.70 miliardë lekë dëme, ose rreth 3.97% më pak se në vitin 2012. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimeve motorike me 2.20 miliardë lekë, apo 81.51% të totalit.

## Byroja Shqiptare e Sigurimeve (BSHS)

AMF, edhe gjatë vitit 2013, ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e detyrimeve të BSHS.

Shënim: [7] Të dhënat janë marrë nga faqja *online* www.xprimm.com

### Byroja Shqiptare e Sigurimeve

BSHS është person juridik, e krijuar jo për qëllime fitimi, në përbërje të së cilës në fund të viti 2013 ishin anëtarë 9 shoqëri sigurimi. Byroja është përfaqësuese kombëtare në Këshillin e Byrove (Shoqata Ndërkombëtare e Byrove Kombëtare të Siguruesve Motorik) dhe është përgjegjëse për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia në sistemin e Kartonit Jeshil.

Objekt i veprimtarisë së Byrosë është përmbushja e funksioneve, detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga dispozitat e Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", Ligjit 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime, "Rregullorja e brendshme e Këshillit të Byrove" dhe Statuti i saj.

Autoriteti, në funksion të mbikëqyrjes së BSHS dhe me qëllim mbrojtjen e interesave të konsumatorit, ka ndjekur me përparësi detyrimet e shoqërive të sigurimit ndaj Byrosë për financimin e Fondit të Kompensimit (FK) dhe kryerjen e pagesave të dëmeve objekt i këtij Fondi.

### Fondi i Kompensimit

Qëllimi për krijimin dhe mbajtjen e FK-së është pagesa e dëmeve pasurore dhe jopasurore të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, në rastet e dëmeve të shkaktuara nga përdorimi i një mjeti të pasiguruar, të paidentifikuar dhe në rastet e mbylljes apo falimentimit të një shoqërie sigurimi. Ai krijohet nga:

- Kontributi i përvitshëm i shoqërive të sigurimit, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimin e detyrueshëm motorik, (i financuar në përpjesëtim të drejtë me primet bruto, të shkruara në këto lloj sigurimesh, në vitin paraardhës);
- Arkëtime nga rimbursimi i shumave nga personat përgjegjës për dëmet te Byroja;
- Gjobat e vëna pronarit të mjetit të transportit të cilët nuk kanë lidhur kontratat e sigurimit të detyrueshëm;
- Burime të tjera të cilat nuk ndalohen me ligj.

Referuar të dhënave ndër vite, FK ka pësuar rritje të ndjeshme për shkak të aksidenteve të shumta të shkaktuara nga mjetet e pasiguruara. Në fund të vitit 2013 numri i mjeteve motorike të pasiguruara[8] arriti në 120,027 ose 26.9 % e totalit të mjeteve të regjistruara.

Shënim: [8] Sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTR)

Gjatë vitit 2013, BSHS është inspektuar dy herë nga AMF. Inspektimi i parë ishte tematik i paplanifikuar dhe lidhej me verifikimin e procedurave të pagesës së një dëmi shëndetësor, objekt i Fondit të Kompensimit. Inspektimi tjetër ishte i plotë dhe i planifikuar dhe mbulonte periudhën e viteve 2012-2013.

Objekti i inspektimit të planifikuar përfshinte verifikimin e procedurave të:

- Trajtimit të dëmeve të paguara, të dëmeve të pezull nga FK dhe dëmeve të papaguara, për të cilat ka vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Ndjekjes së padive të regresit dhe arkëtimit të tyre;
- Trajtimit të dëmeve të paguara të Kartonit Jeshil, për mjetet me targa të huaja që aksidentohen në vendin tonë dhe rimbursimit të pagesave të tyre;
- Zbatimit të detyrimeve ligjore që lidhen me dëme të shkaktuara nga Polica Kufitare.

Nga inspektimi i planifikuar rezultuan problematika të cilat lidhen me vonesa në pagesën e dëmeve tej afateve ligjore, prej shoqërive të sigurimit, dëme të cilat i takojnë FK dhe Fondit të Kartonit Jeshil, duke mos ndjekur radhën e pagesave të dëmeve sipas vitit të aksidentit, duke paguar më parë dëme të vitit 2013, ndërkohë që janë ende pa paguar dëme më të hershme. Për këto dëme u konstatuan vonesa në ngritjen e padive të regresit, ndaj shkaktarëve të aksidenteve, të cilët kanë qenë të pasiguruar në datën e aksidentit; mangësi të theksuara në ndjekjen e arkëtimeve të padive të regresit, madje edhe për ato çështje që janë fituar në gjykatë.

Problematika tjetër e konstatuar gjatë inspektimit të planifikuar lidhej me procedurat e trajtimit jo të drejtë të dëmeve të Policës Kufitare, në kundërshtim me bazën ligjore në fuqi, sipas së cilës këto dëme duhet të trajtohen nga shoqëria përgjegjëse e sigurimit, e cila ka lëshuar kontratën e sigurimit dhe jo nga BSHS-ja. Gjatë verifikimeve në vend të praktikave të këtyre dëmeve rezultoi se BSHS ka vijuar me trajtimin e këtyre dëmeve me të njëjtën procedurë si ajo e trajtimit të dëmeve të FK, ndërkohë që këto dëme duhet të trajtohen nga vetë shoqëritë e sigurimit dhe të raportohen në Autoritet si të gjitha praktikat e tjera të dëmeve të shoqërive të sigurimit.

Grafiku i mëposhtëm paraqet totalin e detyrimeve për pagesat e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit, për periudhën 2009-2013.

**Grafik 9: Detyrimet objekt i Fondit të Kompensimit për vitet 2009-2013** *(Në mln.lekë)*




Bazuar në nenit 45 të Ligjit 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", Autoriteti me propozim të BSHS, vendos çdo vit shumën e kontributeve të Fondit të Kompensimit. Për vitin 2013, FK i miratuar është rreth 265 milionë lekë. Pavarësisht se ky fond është paguar nga shoqëritë e sigurimit gjatë vitit 2013, detyrimet për dëmet objekt i FK janë ende në vlerë të konsiderueshme. Detyrimet e mësipërme, objekt për FK, deri më 31.12.2013 është përcaktuar se do të shlyhen tërësisht përgjatë viteve 2014-2016, duke respektuar radhën e pagesës sipas ngjarjes më të hershme të sigurimit, ndërsa për pagesa të praktikave me ngjarje sigurimi pas kësaj date, do të financohet një fond tjetër.

AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e detyrimeve të BShS-së, lidhur me zbatimin e Marrëveshjes Uniforme dhe Rregullores së Brendshme të Këshillit të Byrove. Në tetor të vitit 2013, Këshilli i Byrove ka marrë vendim për monitorim të Byrosë Shqiptare të Sigurimit. AMF, më datë 7 nëntor 2013, ka marrë pjesë në një takim zyrtar, pranë Këshillit të Byrove në Bruksel, lidhur me sqarimin e detajeve teknike për çështjet e përcaktuara në vendimin e monitorimit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit. Këshilli i Byrove ka kërkuar plotësimin e kritereve financiare që i adresohen BSHS-së tashmë në monitorim, kritere të cilat janë plotësuar brenda muajit dhjetor 2013.

### Provigjoni Teknik Bruto për sigurimin e detyrueshëm motorik

Provigjoni teknik bruto për produktin e MTPL zë peshën më të madhe specifike në totalin e provigjoneve teknike të tregut të Jo-Jetës. Ky tregues ka ardhur në rritje krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në 74% për 31.12.2013 nga 66% për 31.12.2012.

**Tabelë 6: Vlera e provigjonit teknik të sigurimit të detyrueshëm** *(Në mln. lekë)*

| *Emërtimi* | *31.12.2012* | *31.12.2013* |
|---|---|---|
| Provigjone Teknike Bruto - MTPL | 4,903 | 5,546 |
| Provigjone Teknike Bruto - Jo-Jetë | 7,375 | 7,980 |

**Tabelë 7: Struktura e provigjonit teknik bruto të sigurimit të detyrueshëm** *(Në %)*

| *Emërtimi* | *2011* | *2012* | *2013* |
|---|---|---|---|
| Provigjoni Teknik Bruto - Dëme MTPL | 62 | 56 | 52 |
| Provigjoni Teknik Bruto - Primi i Pafituar MTPL | 38 | 44 | 48 |
| Provigjone Teknike Bruto - MTPL | 100 | 100 | 100 |

## Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik

Ruajtja e infrastrukturës së shërbimeve dhe pasurimi i sistemeve informatike të teknologjisë së informacionit (TI) me elementë të rinj kanë qenë gjithnjë ndër synimet e teknologjisë në AMF, duke i shërbyer mbikëqyrjes dhe analizës sa më efektive të tregut. Kështu në vazhdimësi të bashkëpunimit me BB, në kuadër të projektit mbi Liberalizimin e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në Shqipëri, *(The Road Ahead for Albanian Motor TPL Market)* pranë Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik përgjatë vitit 2013 u mundësua integrimi i plotë me sistemin bankar i regjistrit elektronik të shitjeve. Si fazë testuese, ky integrim nisi në muajit e fundit të vitit 2012, por u shtri gjerësisht gjatë viti 2013. Nëpërmjet përfshirjes së detyrueshme të transaksionit të pagesës në policat e sigurimit, mundësohet zhvillimi dhe kontrolli i tregut të sigurimeve motorike dhe vendosen standarde në veprimet financiare duke filluar nga lëshimi i policave të sigurimit të detyrueshëm motorik.

**Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik,** pranë AMF-së përbëhet nga:

- Regjistri Elektronik *Online* i Shitjeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike, i cili është një platformë raportimi dhe identifikimi në kohë reale të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik në formën e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, Kartonit Jeshil dhe Sigurimit Kufitar.

- Regjistri i Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike, i cili është një platformë raportimi i dëmeve të ndodhura në kuadër të sigurimeve të detyrueshme motorike. Për të mundësuar fazën e tretë të projektit, që është krijimi i sistemit *Bonus-Malus*, Regjistri i Dëmeve përmban të dhënat historike të dëmeve duke filluar nga 1 janari 2006.

Gjithashtu, sistemet e TI në AMF janë në bashkëveprim të vazhdueshëm me këto sisteme pranë shoqërive të sigurimit për të parë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e manualit të mbikëqyrjes lidhur me sistemet TI të tregut të sigurimeve.

## Sistemi i Administrimit të Informacionit




AMF dhe shoqëritë e sigurimeve që veprojnë në treg kanë në përdorim të vazhdueshëm sistemin "AMF In-Reg" i cili përbëhet nga një platformë raportimi në *online*, nëpërmjet së cilës operatorët e subjekteve të mbikëqyrura raportojnë të dhënat e kërkuara nga Autoriteti në mënyrë elektronike nëpërmjet internetit.

Gjatë vitit 2013, AMF ka saktësuar mënyrat e funksionimit dhe ka punuar në ndërtimin e pjesëve të reja të sistemit. Kështu, janë plotësuar formatet e raportimit për subjektet e mbikëqyrura, si edhe janë ndërtuar raporte të reja analitike bazuar në të dhënat e mbledhura në sistem nga shoqëritë.

## Licencime në tregun e sigurimeve

Ecuria e zhvillimeve të tregut të sigurimeve, si pjesë e rëndësishme e tregjeve financiare nën mbikëqyrje e ka bërë këtë treg tërheqës edhe për profesione të reja dhe investime në vazhdimësi. Gjatë vitit 2013, AMF ka vijuar me licencimin dhe kualifikimin e ndërmjetësve në sigurime: broker dhe agjentë; si edhe licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime.

### Ndërmjetësimi në sigurime

Gjatë vitit 2013, Autoriteti miratoi një licencë të re për veprimtari brokerimi, si dhe shtimin e veprimtarisë në klasat e sigurimit për një shoqëri të licencuar më parë. Ndërkohë, numri i brokerave fizikë u rrit nga 10, në fund të vitit 2012, në 13 brokera, në fund të vitit 2013.

**Tabelë 8: Të dhëna mbi brokera të licencuar në sigurime** *(Në numër)*

| *Statusi i brokerit* | *Të licencuar në fund të vitit 2012* | *Licenca të reja në 2013* | *Rinovim licence në 2013* | *Përfunduar afati i licencës në 2013* | *Të licencuar[9] në fund të vitit 2013* |
|---|---|---|---|---|---|
| *Shoqëri brokerimi* | 7 | 1 | | - | 8 |
| *Broker fizikë* | 10 | 4 | 3 | 4 | 13 |

Bazuar në kuadrin ligjor rregullues, veprimtarinë e brokerimit e ushtron shoqëria e brokerimit, ndërsa brokeri fizik vepron në emër dhe për llogari të shoqërisë së brokerimit. Sipas llojit të licencës, shoqëritë e brokerimit klasifikohen si më poshtë:

**Tabelë 9: Shoqëri brokerimi sipas produkteve të sigurimit** *(Në numër)*

| | *2009* | *2010* | *2011* | *2012* | *2013* |
|---|---|---|---|---|---|
| *Shoqëri brokerimi Jo-Jetë* | 3 | 7 | 5 | 5 | 5 |
| *Shoqëri brokerimi Jetë dhe Jo-Jetë* | - | - | - | 1 | 2 |
| *Shoqëri brokerimi Jetë, Jo-Jetë dhe Risigurimi* | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| ***Totali*** | **4** | **8** | **6** | **7** | **8** |

Shënim: [9] Gjatë vitit 2013, një shoqëri brokerimi si dhe 3 brokera fizikë zgjeruan veprimtarinë e tyre të brokerimit, duke u pajisur me një licencë të re për klasa sigurimi të papërfshira në licencën e mëparshme. Zgjerimi i veprimtarisë nuk e ka ndryshuar numrin e subjekteve që operojnë në treg. Numri gjithsej i brokerëve të licencuar në fund të vitit 2013 llogaritet si shumë e brokerave të licencuar në fund të vitit 2012 + licenca të reja në 2013 + rinovim licence në 2013 – licencat që u ka përfunduar afati në fund të vitit 2013.

Veprimtaria e shoqërive të brokerimit konsiston në ndërmjetësimin e produkteve të sigurimit të Jetës ashtu dhe të Jo-Jetës si: *Shëndeti në Udhëtim, Garanci Oferte dhe Kontratë, Kasko, TPL, Karton Jeshil, Sigurimi Kufitar, Sigurimi i karburanteve, Sigurimi nga zjarri, Sigurimi CAR* dhe *Sigurimi i Jetës me Kursim*, etj.

Nga raportimet e shoqërive të brokerimit në lidhje me të dhënat statistikore për veprimtarinë që ato kryejnë, rezulton se në fund të viti 2013, totali i primeve bruto të tregut të sigurimeve që shiten me ndërmjetësimin e brokerave është rreth 7.2% e primeve totale të tregut.

## Agjentë në sigurime

Gjatë vitit 2013 vazhdoi licencimi i personave fizikë për ushtrimin e veprimtarisë si agjentë në sigurime të Jo-Jetës në emër dhe për llogari të dy shoqërive të sigurimit: "Sigal Uniqa Group Austria" sh.a. dhe shoqërisë "Insig" sh.a.

**Tabelë 10: Të dhëna mbi agjentët e licencuar** *(Në numër)*

| *Statusi i agjentit* | *Të licencuar në fund të vitit 2012* | *Rinovim licence 2013* | *Licenca të reja 2013* | *Përfunduar afati i licencës 2013* | *Tërheqje licence 2013* | *Të licencuar[10] në fund të vitit 2013* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *Persona juridikë* | 3 | - | - | - | - | 3 |
| *Persona fizikë* | 279 | 13 | 33 | 9 | 1 | 315 |

## Vlerësuesit e dëmeve në sigurime

Gjatë vitit 2013, AMF licencoi 7 vlerësues të tjerë të dëmeve në sigurime, si edhe rinovoi 3 licenca ekzistuese.

Shënim: [10] Numri gjithsej i agjentëve të licencuar në fund të vitit 2013 llogaritet si shumë e agjentëve të licencuar në fund të vitit 2012 duke i shtuar numrin e licencave të reja në 2013 dhe licencat e rinovuara në 2013 dhe duke zbritur numrin e licencave që u ka përfunduar afati në fund të vitit 2013 si edhe tërheqjet e licencave.

**Tabelë 11: Të dhëna mbi vlerësuesit e licencuar, sipas llojit të licencës dhe statusit** *(Në numër)*

| *Vlerësues dëmesh në sigurime* | *Të licencuar në fund të vitit 2012* | *Licencime të reja 2013* | *Rinovim Licence 2013* | *Përfunduar afati i licencës 2013* | *Të licencuar 2013* |
|---|---|---|---|---|---|
| *Sipas statusit të vlerësuesit* | | | | | |
| I pavarur | 17 | 7 | 1 | 5 | 20 |
| I punësuar | 41 | | 2 | 19 | 24 |
| Licenca jo aktive | 7 | | - | 2 | 5 |
| *Sipas llojit të licencës* | | | | | |
| Për dëme materiale | 5 | 2 | - | 1 | 6 |
| Për dëme shëndetësore | 5 | 3 | - | 2 | 6 |
| Për dëme materiale dhe shëndetësore | 55 | 2 | 3 | 23 | 37 |
| **Gjithsej vlerësues të licencuar** | **65** | **7** | **3** | **26** | **49** |

## Testi profesional për profesionet në fushën e sigurimeve

Një nga kriteret për pajisjen me licencë të profesionistëve në fushën e sigurimeve është kalimi me sukses i testimit për njohuritë në fushën profesionale dhe ligjore. Qëllimi i organizimit të testeve ka qenë vënia e theksit tek profesionalizmi i aplikantëve që kërkojnë të licencohen. Në përbërje të komisioneve të testimit janë përfshirë përfaqësues me reputacion dhe eksperiencë si nga rrethi akademik, ashtu edhe nga tregu.

Mbështetur në kërkesat rregullative, gjatë vitit 2013, u organizuan 5 testime, ku morën pjesë 35 aplikantë për licencë si vlerësueses të dëmeve në sigurime apo broker në sigurime. Në testim janë përfshirë edhe profesionistë, të cilët kanë kërkuar rinovimin e licencës së mëparshme. Programet e testimit kanë kërkesa lidhur me njohuritë për bazën ligjore dhe çështje teknike të përshtatura në raste studimi sipas problematikave për zgjidhje që kërkon tregu.

## Risigurimet

Shoqëritë e sigurimit, gjatë vitit 2013, kanë kontraktuar rreziqe të cilat i përkasin produkteve të sigurimit vullnetar dhe sigurimit të detyrueshëm motorik për automjetet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, por edhe në vendet e tjera anëtare të sistemit të Kartonit Jeshil, si dhe sigurimit të përgjegjësisë ligjore të tregtuesve të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre. Për portofole të veçanta sigurimi, shoqëritë kanë kryer transferim të rrezikut për të zbutur efektet financiare të dëmeve të mëdha, të mundshme. Ky transferim është realizuar

**Risigurimi Fakultativ**

Risigurimi Fakultativ nënkupton transferimin e një pjesë të një rreziku të veçantë të siguruar nga shoqëria e sigurimit te shoqëria e risigurimit, sipas një kontrate të veçantë të risigurimit.

nëpërmjet bashkësigurimit, kalimit në risigurim të portofoleve të sigurimit në tërësi dhe mbulimit me risigurim fakultativ në kontrata të veçanta.

Gjatë vitit 2013, konstatohet se kemi një rritje me 9% të vlerës së primit të shkruar bruto në sigurimin e Jetës në nivel tregu, krahasuar me vitin 2012. Ndërkohë që primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës janë në masën 89% të vlerës së primit të shkruar bruto në nivel tregu.

Në bazë të kërkesave rregullatore, shoqëritë e sigurimit, raportojnë në Autoritet programin e risigurimit. Bazuar në funksionin e saj mbikëqyrës, AMF ndjek ecurinë e zbatimit të këtij programi dhe kontratave specifike të lidhura, duke synuar të sigurojë stabilitetin e vazhdueshëm financiar në lidhje me standardet e mbajtjes së rrezikut nga këto shoqëri risigurimi dhe kritereve të lidhura me cilësinë e risiguruesve.

Marrëveshjet risiguruese në portofolet e sigurimit të Jo-Jetës kanë qenë të formës jo proporcionale të tipit *Excess of Loss* (Tejkalim Humbje) dhe të formës proporcionale të tipit *Quota Share* e *Surplus*. Në sigurimin e Jetës, mbulimi me risigurim është kryer nëpërmjet marrëveshjeve risiguruese të formës proporcionale të tipit *Surplus* dhe të tipit *Quota Share*.

Primet e ceduara në risigurim për vitin 2013 rezultojnë:

- Për totalin e tregut të sigurimeve në vlerën prej 2.49 miliardë lekë ose sa 29.42% e vlerës së primeve të shkruara bruto në nivel tregu;
- Për sigurimin e Jo-Jetës në vlerën prej 2.44 miliardë lekë ose sa 32.48% e vlerës së primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jo-Jetës;
- Për sigurimin e Jetës në vlerën prej 54.51 milionë lekë ose sa 5.63% e vlerës së primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jetës.

Gjatë vitit 2013, kalimi në risigurim krahasuar me vitin 2012 është rritur:

- Në nivel tregu me vlerën prej 591.48 milionë lekë ose 23.71%;
- Për sigurimin e Jo-Jetës me vlerën prej 575.31 milionë lekë ose 23.57%;
- Për sigurimin e Jetës me vlerën prej 16.16 milionë lekë ose 29.65%.

Ecuria e raportit të primeve të ceduara në risigurim mbi primet e shkruara bruto gjatë viteve 2011-2013 jepet si më poshtë vijon:

**Grafik 10: Primi i ceduar në risigurim/prime të shkruara bruto, totali i tregut** *(Në %)*




**Grafik 11: Primi i ceduar në risigurim/prime të shkruara bruto, Jeta** *(Në %)*



**Grafik 12: Primi i ceduar në risigurim/prime të shkruara bruto, Jo-Jeta** *(Në %)*




Ndër pjesëmarrësit kryesorë në këto programe risigurimi, për sigurimin e Jo-Jetës mund të përmendim VIG Re, Munich Re, Hannover Re, Swiss Re, Partner Re, Scor, Lloyd's Syndicates, etj. Për sigurimin e Jetës, shoqëria e vetme risiguruese e përfshirë në këtë program është Scor Global Life. Më shumë se 90% e partnerëve risigurues të shoqërive të sigurimit kanë klasifikim më të lartë se BB- nga Standard & Poors, nga ku mbi 50% kanë klasifikim më të lartë se A.

## 1.3 Tregu i Letrave me Vlerë

### Fondet e Investimeve

Tregu i sipërmarrjeve të investimeve kolektive, gjatë vitit 2013, ka pësuar një rritje të konsiderueshme. Në këtë treg ushtrojnë aktivitetin e tyre dy fonde investimi, përkatësisht Fondi i Investimeve "Raiffeisen Prestigj" i licencuar më datë 13.12.2011 dhe Fondi i Investimeve "Raiffeisen Invest Euro" i licencuar më datë 26.09.2012, të cilat administrohen nga shoqëria "Raiffeisen Invest". Qëllimi i fondeve të investimit të licencuar deri tani nga AMF është ofrimi i një kthimi nga investimi, duke ruajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetin e nevojshëm.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 31.12.2013, vlera neto e aseteve të tyre arriti në rreth 50.33 miliardë lekë me një rritje prej 34.32 miliardë lekë ose 214.40% krahasuar me 31.12.2012.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në obligacione qeveritare të cilat përbëjnë 83.97% të aseteve të fondeve. Vetëm investimet në Obligacione qeveritare pësuan rritje prej 268.71% krahasuar me 31.12.2012. Ndërkohë, numri i anëtarëve që kanë investuar në fondet e investimit më 31.12.2013 është 28,442, ku rreth 99.96% e zënë investitorët individualë.

**Tabelë 12: Tregues të numrit të fondeve të investimit dhe anëtarëve, 31.12.2013**

| *Përshkrimi* | *Nr.* | *Vlera e aseteve neto (mln. lekë)* | *Në %* |
|---|---|---|---|
| Numri i shoqërive administruese të fondeve të investimeve | 1 | | |
| Numri i fondeve të investimit | 2 | | |
| **Numri i anëtarëve në fond** | **28,422** | **50,328.54** | **100.00** |
| Individë | 28,417 | 50,308.93 | 99.96 |
| Persona juridikë | 5 | 19.61 | 0.04 |

**Tabelë 13: Tregues për vlerat e kuotave të fondeve të investimeve** *(Në lekë)*

| *Përshkrimi* | *Vlera fillestare e vlerës neto të aseteve për kuotë* | *Vlera neto e aseteve për kuotë 31.12.2012* | *Vlera neto e aseteve për kuotë 31.12.2013* |
|---|---|---|---|
| Raiffeisen Prestigj | 1,000[11] | 1,061.72 | 1,147.69 |
| Raiffeisen Invest EURO[12] | 14,000[13] | 14,069.20 | 14,537.91 |

Shënim:
[11] Vlera fillestare në 31.03.2012.
[12] Vlerat e Raiffeisen Invest EURO janë konvertuar me kursin 1euro = 140 lekë.
[13] Vlera fillestare në 22.11.2012.

**Tabelë 14: Tregues të detajuar të aseteve të fondeve të investimeve**

| *Përshkrimi* | *31.12.2012 mln. lekë* | *31.12.2013 mln. lekë* | *Ndryshimi në %* | *Pjesa ndaj totalit në %* | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ***31.12.2012*** | ***31.12.2013*** |
| **Asetet neto të fondit** | **16,007.90** | **50,328.54** | **214.40** | | |
| Totali i aseteve të fondit | 16,061.31 | 50,506.80 | 214.46 | **100.00** | **100.00** |
| *nga të cilat:* | | | | | |
| Obligacione qeveritare | 11,502.27 | 42,410.25 | 268.71 | 71.61 | 83.97 |
| Bono thesari | 2,074.59 | 4,639.99 | 123.66 | 12.92 | 9.19 |
| Mjete monetare | 2,138.10 | 2,582.67 | 20.79 | 13.31 | 5.11 |
| Asete të tjera | 346.35 | 873.90 | 152.32 | 2.16 | 1.73 |
| **Totali i detyrimeve të fondit** | **53.42** | **178.25** | **233.71** | **0.33** | **0.35** |

## Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2013 u dominua në masën 53.52% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 46.48% nga instrumente afatgjatë (obligacione). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 96.10% e të gjitha transaksioneve të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Transaksionet "Blerje në tregun primar" dhe "Shlyerje e vlerës nominale në maturim" dominojnë tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2013. Ato arritën përkatësisht në masën 64.82% dhe 23.71% kundrejt volumit të përgjithshëm të transaksioneve.

Investitorët individualë dominojnë në këtë treg duke kryer rreth 99.37% të të gjitha transaksioneve në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë.

**Tabelë 15: Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë**

| | *Lloji i Transaksionit* | *Vlera nominale (mln. lekë)* | | *Ndryshimi (në%)* |
|---|---|---|---|---|
| | | ***2012*** | ***2013*** | ***`13/`12-1*** |
| A | **Blerje në tregun primar** | **19,991** | **46,342** | **131.82** |
| | *Individë* | *10,896* | *8,310* | *(23.73)* |
| | *Persona juridikë* | *9,095* | *38,031* | *318.18* |
| B | **Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar** | **7,066** | **5,217** | **(26.17)** |
| | *Individë* | *5,873* | *4,912* | *(16.36)* |
| | *Persona juridikë* | *1,193* | *305* | *(74.45)* |
| C | **Blerje nga individët para afatit të maturimit** | **5,663** | **2,876** | **(49.21)** |
| | *Individë* | *5,021* | *2,442* | *(51.37)* |
| | *Persona juridikë* | *642* | *435* | *(32.33)* |
| D | **Vendosje e bonos si kolateral** | **97** | **105** | **7.23** |
| | *Individë* | *54* | *78* | *44.21* |
| | *Persona juridikë* | *43* | *26* | *(39.16)* |
| E | **Shlyerje e vlerës nominale në maturim** | **12,578** | **16,955** | **34.79** |
| | *Individë* | *11,041* | *14,696* | *33.10* |
| | *Persona juridikë* | *1,537* | *2,258* | *46.93* |

Gjatë vitit 2013, AMF filloi përdorimin e sistemit të raportimit elektronik, AMF In–Reg, për subjektet e licencuara që ushtrojnë veprimtari në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë. Sistemi synon informatizimin e procesit të raportimit në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, duke rritur efektivitetin dhe duke garantuar siguri dhe besueshmëri në analizën e tyre.

Format e raportimit elektronik, për aktivitetin në tregun e letrave me vlerë të Qeverisë, u testuan nga subjektet dhe po ashtu edhe nga AMF, deri në dhjetor 2013, për të parë ecurinë e raportimit. AMF synon që ta shtrijë plotësisht këtë sistem gjatë vitit 2014 për të gjeneruar raporte mbi tregun.

### Platforma GSRM  (Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë)

Gjatë vitit 2013, platforma e GSRM-së, vazhdoi të funksionojë dhe të përmbushë rolin e saj duke siguruar rritje të transparencës në kuotimet dhe transaksionet në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë. Në treg veprojnë 10 operatorë të licencuar nga AMF për të tregtuar letrat me vlerë të Qeverisë. AMF, duke synuar mbrojtjen më të mirë të interesave të investitorëve, monitoron veprimtarinë e këtyre operatorëve dhe kujdeset që informacioni të jetë i përditësuar dhe në kohë reale. Platforma përfshin dhe një bazë të dhënash historike, e cila u vjen në ndihmë personave të cilëve u nevojiten të dhëna për qëllime statistikore apo akademike.

Platforma e GSRM-së jep një informacion të plotë për publikun dhe investitorët institucionalë në lidhje me kërkesat dhe ofertat ditore në tregun me pakicë të instrumenteve të borxhit të Qeverisë.

Me emetimin nga Qeveria për herë të parë, në tetor 2013, të obligacionit 10-vjeçar, në sistemin e GSRM-së, u pasqyruan transaksionet që lidheshin me këtë emetim duke bërë edhe përshtatjen në formatet e raportimit.

Gjatë vitit 2013, në platformën GSRM janë kryer 11,594 klikime, duke zënë rreth 4% të të gjithë vizitave në faqen zyrtare të AMF-së.

## Tregu i kapitaleve

Si autoritet rregullator dhe mbikëqyrës i tregut të kapitaleve, AMF është shprehur vazhdimisht për nevojën e zhvillimit të këtij tregu dhe rolin e tij në zhvillimin e ekonomisë.

Tregu i kapitaleve vazhdon të mbetet i pazhvilluar. Bursa e Tiranës, e zotëruar tërësisht nga shteti si aksionar i vetëm, ka të gjithë strukturat e një shoqërie aksionare, por nuk ka filluar të tregtojë tituj dhe nuk ka asnjë shoqëri të listuar.

Në kushtet aktuale të tregut të kapitalit, AMF në bashkëpunim me ekspertë të përzgjedhur nga FSVC, USAID, gjatë vitit 2013, ndërmorën nismën për hartimin një strategjie për zhvillimin e tregut të kapitaleve. Strategjia përmban drejtimet afatmesme dhe afatgjata për zhvillimet e mundshme të tregut të kapitaleve. Në hartimin e strategjisë u mbajtën parasysh:

- Vlerësimi i mjedisit ekzistues ligjor dhe rregullator;
- Vlerësimet e grupeve përkatëse të interesit;
- Përparësitë dhe problematikat e mundshme në zhvillimin e tregut të kapitalit.

Strategjia qartëson se zbatimi i elementëve përbërës të saj kërkon mbështetjen e Qeverisë dhe të grupeve private të interesit, si elementë thelbësorë për zhvillimin e një tregu kapitalesh.

Në mungesë të një tregu të organizuar, aksionet vazhdojnë të tregtohen mes aksionarëve, duke reflektuar ndryshimin e pronësisë në regjistrat e shoqërive aksionare. Nga ana tjetër, një pjesë e shoqërive aksionare kanë regjistruar aksionet e tyre në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve, si qendër e specializuar për mbajtjen e regjistrit të aksioneve. Në fund të vitit 2013 numërohen 101 shoqëri të regjistruara pranë kësaj Qendre, ndërsa numri i aksioneve të tregtuara në krahasim me totalin e aksioneve të regjistruara është shumë i ulët, janë tregtuar vetëm 0.16% të totalit të aksioneve.

## Aktiviteti licencues në tregun e letrave me vlerë

Risia e vitit 2013, në aspektin licencues në tregun e titujve, ka qenë miratimi i licencës së parë për këshillimin për investime në tituj.

Këshilltari për investime, sipas dispozitave ligjore, punon në emër dhe për llogari të shoqërisë së këshillimit/brokerimit. Profesioni i këshilltarit të investimeve kërkon eksperienca më specifike në krahasim me profesionin e brokerit. Në bazën rregullative të hartuar nga AMF është shprehur qartë se aplikanti për këshilltar investimesh, përveç kërkesave të tjera, duhet të plotësojë një nga kushtet e mëposhtme:

- Të ketë përfunduar një kualifikim pasuniversitar në fushën e investime financiare, ose të analizës financiare për një periudhë jo më të shkurtër se 1 vit; ose
- Të ketë përvojë profesionale brenda ose jashtë vendit për një periudhë jo më pak se 3 vjet në fushën e këshillimit në tituj.

**Veprimtaria e këshillimit** përfshin këshillimin e vazhdueshëm me qëllim fitimi apo ofertën për një shërbim të tillë.

Kjo veprimtari parashikon shërbimet e mëposhtme:

- Këshillim mbi titujt dhe tregtimin e tyre, ofertën publike, marrjen e paketës kontrolluese, krijimin e portofoleve, si dhe operacione të tjera të ngjashme me to;
- Organizimin e blerjeve, shitjeve apo këmbimin e titujve nëpërmjet shoqërisë së brokerimit;
- Studim, përgatitje, mbikëqyrje e zbatim i një plani investimi në tituj;
- Përgatitje e dokumentacionit të kërkuar sipas ligjit mbi titujt dhe legalizimin përkatës.

Në fund të vitit 2013, në tregun e titujve kanë ushtruar veprimtari 13 shoqëri komisionere, 18 brokera fizikë të punësuar në shoqëritë komisionere, 1 agjent i një brokeri të licencuar, 8 kujdestarë të letrave me vlerë, 1 regjistrar për regjistrimin e aksioneve.

Pjesa më aktive e tregut të letrave me vlerë është tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë shqiptare. Në këtë treg operojnë kryesisht bankat, të licencuara nga AMF për të kryer këtë veprimtari.

**Tabelë 16: Subjekte të licencuara që operojnë në tregun e letrave me vlerë** *(Në numër)*

| *Subjekte* | *2010* | *2011* | *2012* | *2013* |
|---|---|---|---|---|
| Shoqëri komisionere | 12 | 13 | 13 | 13 |
| Broker fizik në shoqëri komisionere | 16 | 17 | 18 | 18 |
| Kujdestarë të titujve të Qeverisë së R.Sh. | 7 | 8 | 8 | 8 |
| Regjistrues aksionesh | 1 | 1 | 1 | 1 |
| Shoqëri këshillimi për investime në tituj | 0 | 0 | 0 | 1 |
| Këshilltar për investime në tituj | 0 | 0 | 0 | 1 |

## Miratimi i ofertës private të obligacioneve

Gjatë vitit 2013, Autoriteti miratoi prospektet respektive për 4 emetime obligacionesh me ofertë private, të ofruara nga 2 shoqëri në shumën 1,360 milionë lekë.

### Ofertë private e obligacioneve

Sipas Ligjit nr. 9879 datë 21.2.2008 "Për titujt", Oferta Private e Titujve është emetimi, në të cilin oferta për të nënshkruar tituj u drejtohet vetëm investitorëve institucionalë, aksionarëve ose punonjësve, por jo më shumë se 100 investitorëve të jashtëm, të cilët janë adresuar drejtpërdrejt tek emetuesi. Shoqëria emetuese është e detyruar të përgatisë prospektin dhe ta dorëzoje atë tek investitorët e mundshëm, vetëm pasi prospekti të jetë miratuar nga AMF.

## Inspektime në sipërmarrjet e investimeve kolektive

Sipërmarrjet e investimeve kolektive kanë pasur dinamikë të lartë zhvillimi dhe vlera të konsiderueshme të aseteve nën administrim. Këto arsye kanë qenë përcaktuese të rëndësishme në vendosjen e prioriteteve të AMF-së lidhur me inspektimin në vend pranë shoqërisë administruese dhe depozitarit të saj. Ky inspektim u përqendrua në tre drejtime kryesore që lidhen me:

- Mbikëqyrjen efektive të veprimtarisë së shoqërisë, duke u fokusuar në politikat e investimit, procedurat e përzgjedhjes dhe miratimit të llojit të investimit, funksionimin e sistemeve të automatizuara që përdor shoqëria administruese për përllogaritjen e aseteve neto të fondeve të investimit dhe mënyrën e përllogaritjes së çmimit së kuotës, shlyerjet e kuotave të anëtarëve që tërhiqen nga fondi i investimit, mënyra e përllogaritjes së vlerës së shlyer si dhe çmimi i kuotës që përdoret në momentin e shlyerjes;

- Transparencën me investitorin, duke u fokusuar në administrimin e fondeve të investimeve kolektive, strukturimin dhe ndarjen e funksioneve të brendshme të shoqërisë, mënyrat dhe kushtet e shitjes së kuotave investitorit nga ana e shoqërisë administruese, procedurat e trajtimit të ankesave të klientëve nga shoqëria administruese;
- Përmbushjen e detyrimeve ligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, duke u fokusuar në rregulloret, udhëzimet apo procedurat e brendshme që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave, kryerjen e kontrolleve nga auditues të brendshëm të shoqërisë dhe konkluzionet e mbajtura, raportimet e transaksioneve të dyshimta dhe transaksioneve në para fizike për vlerat sipas legjislacionit në fuqi.

Gjetjet e konstatuara nga këto inspektime iu komunikuan shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe depozitarit në takimin përmbyllës me nivelin drejtues të tyre.

Mbi bazën e këtyre gjetjeve, AMF ka dhënë rekomandimet përkatëse, të cilat lidhen me rritjen e transparencës ndaj investitorit, me përcaktimin e vlerës së aseteve të sipërmarrjeve të investimit kolektiv dhe llogaritjen e vlerës neto të aseteve të tyre për kuotë ose për aksion, duke rakorduar çdo ditë vlerën neto të aseteve të fondit të investimit dhe çmimin e kuotës për fondin e investimit.

## 1.4 Tregu i Pensioneve Private Vullnetare

Gjatë vitit 2013 numri i operatorëve të tregut të pensioneve private vullnetare nuk pati ndryshime. Në këtë treg ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni vullnetar të administruar nga tri shoqëri të ndryshme administruese, përkatësisht Raiffeisen Invest sh.a., e cila administron Fondin e Pensionit Vullnetar Raiffeisen, Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a., e cila administron Fondin e Pensionit Vullnetar Sigal, si dhe SiCRED sh.a., e cila administron Fondin e Pensionit Vullnetar SiCRED.

Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare në fund të vitit 2013 tregon një total asetesh nën menaxhim prej 436.03 milionë lekë dhe me një rritje prej afro 152.44 milionë lekë (53.75%).

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve në fund të vitit 2013 ishte 7,887 anëtarë, duke shënuar rritje prej 8.32% krahasuar me fundin e vitit 2012.

**Tabelë 17: Tregues të fondeve të pensioneve**

| Përshkrimi | Vlera *(mln. lekë)* | | Ndryshimi *(në %)* |
|---|---|---|---|
| ***Periudha*** | ***2012*** | ***2013*** | ***2013/2012*** |
| Asetet neto të FP | 283.01 | 434.82 | 53.64 |

**Tabelë 18: Asetet neto dhe numri i anëtarëve sipas fondeve të pensioneve, 31.12.2013**

| *Fond Pensioni* | *Numri i anëtarëve në FP* | *Asete Neto (mln. lekë)* |
|---|---|---|
| SIGAL | 3,503 | 202.19 |
| RAIFFEISEN | 2,548 | 174.49 |
| SiCRED PENSION | 1,836 | 58.14 |
| **TOTAL** | **7,887** | **434.82** |

**Grafik 13: Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensioneve, 31.12.2013**



Grafik 14: Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensioneve, 31.12.2013




Asetet e fondeve të pensioneve janë investuar në obligacione të thesarit të Republikës së Shqipërisë dhe në depozita bankare. Totali i investimeve për 31.12.2013 ka qenë 421.68 milionë lekë, duke shënuar një rritje me 53.13% krahasuar me fundin e vitit 2012.

**Tabelë 19: Vlera e investimeve të tregut të fondeve të pensioneve** *(Në mln. lekë)*

| *Periudha* | *2011* | *2012* | *2013* |
|---|---|---|---|
| Totali i investimeve të FP | 152.91 | 275.38 | 421.68 |

Sipas neneve 88-91 të Ligjit 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" parashikohen lehtësira tatimore të kontribuesve si anëtarë të fondeve të pensioneve private vullnetare. Aktualisht, skemat e pensioneve private vullnetare nuk kanë mundur të tërheqin shumë anëtarë, pasi lehtësirat fiskale të parashikuara në ligjin "Për fondet e pensionit vullnetar", nuk zbatohen tërësisht nga legjislacioni tatimor.

## 1.5 Masat Korrigjuese dhe Administrative

Legjislacioni që rregullon veprimtarinë e subjekteve financiare nën mbikëqyrjen e AMF si edhe ligji "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" parashikojnë masa korrigjuese dhe administrative me qëllim parandalimin dhe eliminimin e shkeljeve në kohën e duhur, duke bërë të mundur ndërprerjen e veprimeve që përbëjnë shkelje të ligjit, mbrojtjen konsumatore dhe forcimin e rolit të AMF-së.

Gjatë vitit 2013, AMF në disa raste ka proceduar në përshkallëzim të masave parandaluese dhe korrigjuese. Në raste të tjera AMF ka kërkuar plane të pranueshme për parandalimin e problemeve. Këto plane kanë përfshirë hapa të detajuar për zgjidhjen e problematikave të konstatuara brenda një afati të caktuar kohor. Për shoqëritë që veprojnë në tregun e sigurimeve, Bordi i AMF-së, gjatë vitit 2013, ka marrë gjithsej 16 vendime për masa administrative si rezultat i konstatimeve të bëra nga analizimi i treguesve financiare ashtu edhe nga inspektimet në vend të kryera nga Autoriteti. Në krahasim me vitin 2012, ka pasur rritje të numrit të masave korrigjuese dhe parandaluese ndaj shoqërive të sigurimit, gjë që tregon për një rritje të shkallës së ndërhyrjes së Autoritetit me qëllim parandalimin dhe eliminimin e shkeljeve në një kohë shumë të shkurtër.

**Tabelë 20: Masa administrative të marra nga AMF, 2013** *(Në numër)*

| Tregjet | Masa administrative | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | *Urdhër për eleminim shkeljeje* | *Plan masash financiare* | *Urdhër për rritje kapitali* | *Urdhër për ndalim transaksionesh* | *Rekomandim per këshillin mbikëqyrës* | *Heqje miratimi license* |
| Tregu i sigurimeve | 16 | 2 | 2 | 1 | 1 | |
| Tregu i pensioneve | 1 | | 1 | | | |
| Tregu i letrave me vlerë | 3 | | | | | 1 |

Gjatë vitit 2013, Bordi i AMF-së, ka marrë 4 vendime për masa administrative ndaj operatorëve që veprojnë në tregun e letrave me vlerë. Tre prej këtyre vendimeve kanë parashikuar urdhërimin për korrigjimin e shkeljes. Vendimi tjetër ishte në nëntor 2013, për heqjen e "Miratimit të shoqërisë "Easy Trade Consulting" sh.p.k. për të vepruar si agjent i brokerit të licencuar të letrave me vlerë".

Bordi i AMF-së, gjatë vitit 2013, mori një vendim për shoqëritë që veprojnë në tregun e pensioneve private vullnetare, duke parashikuar masat urdhër eliminim shkeljeje dhe urdhër për rritje kapitali.

Gjatë vitit 2013 asnjë masë e re nuk është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe për rrjedhojë, të gjitha proceset gjyqësore kanë qenë për masa të mbartura nga vitet e kaluara. Gjatë vitit 2013 ka përfunduar procesi i gjykimit për 4 çështje, tri prej çështjeve janë fituar nga AMF.

Në një çështje, ku kundërshtohej vendimi i Bordit për sanksion me gjobë, Gjykata pushoi gjykimin pasi shoqëria hoqi dorë nga ankimimi dhe u procedua me zbatimin e vendimit të Bordit të AMF-së.

Në një tjetër çështje, ku Bordi kishte vendosur heqjen e licencës për të ushtruar veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve në sigurime, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendosi pushimin e gjykimit, pasi pala që kishte bërë ankimin nuk shprehu interes për vijimin e gjykimit. Çështja më parë ishte kthyer nga Gjykata e Apelit për rigjykim.

Në çështjen e tretë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit kanë rrëzuar kërkesë-padinë, duke mos pranuar ankimin e shoqërisë së sigurimit. Ankimi ishte ndaj një sanksioni me gjobë të vendosur nga Bordi i AMF-së.

Çështja e humbur nga AMF lidhet me një ankim ndaj vendimit të Bordit për vendosjen e sanksionit me gjobë ndaj një shoqërie sigurimi. Sanksioni lidhej me mosparaqitjen në AMF nga ana e shoqërisë të një llogaridhënie të detajuar në përputhje me afatet, formën dhe listën sipas parashikimeve të aktit nënligjor nr. 10, datë 08.02.2007 "Për listën e dokumenteve të llogaridhënies së detyruar vjetore e periodike të shoqërive të sigurimit e risigurimit". Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit kanë pranuar ankimin, duke shfuqizuar vendimin e Bordit të AMF-së. AMF ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë e cila ka vendosur mospranim rekursi.

**Tabelë 21: Proceset gjyqësore lidhur me masat administrative të marra nga AMF, deri në 31.12.2013**

*(Në numër)*

| Totali | Të përfunduara | Në proces |
|---|---|---|
| 14 | 4 | 10 |

# Kapitulli 2
# Rregullimi i tregjeve financiare nën mbikëqyrje

## 2.1 Veprimtaria e Bordit të AMF-së

Bordi i AMF-së, në përmbushje të funksioneve të tij, gjatë vitit 2013 ka zhvilluar 13 mbledhje dhe ka marrë 135 vendime. Tabela më poshtë pasqyron numrin e vendimeve të Bordit të AMF-së të ndarë sipas llojeve.

**Tabelë 22: Ndarja e vendimeve të Bordit të AMF-së sipas llojit të vendimit**

| *Llojet e vendimeve* | *Numër* |
|---|---|
| Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e sigurimeve | 95 |
| Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e letrave me vlerë | 7 |
| Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e pensioneve private vullnetare | 2 |
| Vendime për masa administrative e korrigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura | 21 |
| Vendime për kuadrin rregullues të AMF-së | 10 |
| **Vendime në tërësi** | **135** |

## 2.2 Aktiviteti rregullator

Gjatë vitit 2013, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator, AMF finalizoi hartimin dhe dërgimin në Ministrinë e Financave, të dy projektligjeve:

- "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", si dhe
- "Mbi disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare"".

Gjithashtu, gjatë vitit 2013, është punuar me asistencën e ekspertëve të BB, për ndryshimin e Ligjit nr. 10197 nga 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" me qëllim përafrimin e këtij të fundit me direktivat e BE-së dhe rekomandimet e Raportit të Progresit të BE-së.

*Projektligji "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit"*

Gjatë vitit 2013, AMF punoi për pasqyrimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave, të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe reflektoi sugjerimet e FMN dhe BB në projektligjin "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Gjithashtu në zbatim të rekomandimeve të misionit FSAP[14], nëntor-dhjetor 2013, ku theksohej rëndësia e aplikimit të mbikëqyrjes me fokus rrezikun, që nënkupton ndryshimin e filozofisë së mbikëqyrjes aktuale, AMF ripunoi projektligjin "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", i cili është dërguar në Ministrinë e Financave.

Shënim: [14] Albania Technical Note "Insurance"

Qëllimi i projektligjit është forcimi dhe zhvillimi i sektorit të sigurimeve në vend duke vënë theksin në garantimin e një mbrojtje efektive të interesave të konsumatorëve.

Projektligji vendos parime dhe përcakton veprimtarinë dhe procedurat në lidhje me krijimin, organizimin, administrimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, në mënyrë që tregu i sigurimeve të funksionojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, si dhe për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e konsumatorit të përfshirë në një kontratë sigurimi. Hartimi i këtij ligji është edhe në përputhje me synimin e AMF-së për të rritur më tej shkallën e përputhshmërisë dhe zbatimin e Parimeve Bazë të Sigurimeve (Insurance Core Principles, ICP) të IAIS.

*Ndryshimi i ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar"*

Gjatë 2013, AMF në bashkëpunim me ekspert të BB punoi për ndryshimin e ligjit nr. 10197 të datës 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar". Ndryshimet në ligji synojnë përqasjen e tij me direktivat e BE-së, parimet e mbikëqyrjes së pensioneve private të hartuara dhe të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrjes së Pensioneve (IOPS) si dhe Udhëzuesit e OECD-së.

Si rezultat i punës disa mujore AMF arriti të finalizojë draftin e parë të këtij projektligji dhe tashmë po punon për reflektimin e komenteve dhe sugjerimeve të grupeve të interesit.

## Aktet nënligjore në fushën e sigurimeve

Për rregullimin ligjor të tregut të sigurimeve gjatë 2013, u hartua dhe u miratua Udhëzimi nr. 45, datë 24.04.2013 "Për kriteret, procedurat dhe afatet për rinovimin e licencës/autorizimit të profesionistëve në tregun e sigurimeve". Qëllimi i këtij udhëzimi ishte përcaktimi i kritereve, procedurave dhe afateve për rinovimin e licencës/autorizimit për të gjithë profesionistët e tregut të sigurimeve (agjent, broker, vlerësues dëmesh, aktuar), të cilët zotërojnë një licencë/autorizim me afat të përcaktuar dhe që kërkojnë ta rinovojnë atë.

Gjithashtu, me qëllim ushtrimin e një mbikëqyrjeje sa më efektive të aktivitetit të tregut dhe operatorëve, u ndryshuan aktet nënligjore si më poshtë:

- Rregullorja nr. 2, datë 28.01.2010 **"Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së BSHS-së"**. Këto ndryshime janë miratuar me qëllim përmirësimin e mbikëqyrjes së veprimtarisë së shoqërive të sigurimit dhe Byrosë nëpërmjet rregullimit të mëtejshëm të mënyrës së raportimit periodik.
- Rregullorja nr. 9, datë 08.02.2007 **"Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të Jo-Jetës"**. Ndryshimet e miratuara kanë si qëllim rregullimin e bazës së të dhënave që duhet të raportohet në AMF dhe duhet të merret në konsideratë për përllogaritjen e provigjoneve teknike.

- Rregullorja nr. 6, datë 08.02.2007 **"Për rregullat, mënyrat dhe kushtet e raportimit të shoqërive të sigurimit në AMF"**. Nëpërmjet këtyre ndryshimeve janë shtuar dokumentet që shoqëria e sigurimit duhet të dorëzojë në Autoritet.

- Rregullorja nr. 18, datë 27.03.2008 **"Për organizimin e testimit për vlerësuesit e dëmeve në sigurime"**. Ndryshimet e miratuara në këtë rregullore kanë si qëllim përmirësimin e mënyrës dhe procedurës së organizimit të testimit për vlerësuesit e dëmeve në sigurime.

- Rregullorja nr. 110, datë 28.07.2011 **"Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit"**. Këto ndryshime janë realizuar në bashkëpunim me ekspertë të BB-së, duke reflektuar dhe analizat e tregut të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, lidhur me mënyrën e llogaritjes së primit të sigurimit për kontratat e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit si dhe duke futur të tjerë elementë aktuarialë në vlerësimin e tyre me qëllim përmirësimin e praktikës aktuale të ndjekur. Ndryshimet në Rregulloren nr. 110, datë 28.07.2011, synojnë shmangien e ndryshimeve të shpeshta të tarifave të aplikuara në tregun e sigurimit të kontratës së sigurimit të detyrueshëm motorik MTPL.

### Aktet nënligjore në fushën e pensioneve private vullnetare

Me qëllim përafrimin e mëtejshëm të akteve ligjore në fuqi me direktivat e BE, u miratua Rregullorja nr. 112, datë 25.11.2013 **"Për tarifat e miratimit të prospektit"**, e cila ka si qëllim përcaktimin e tarifave të shërbimit për miratimin e prospektit të ofertës publike dhe private, si dhe miratimin e prospektit të fondit të investimeve dhe fondit të pensionit vullnetar për llogari të AMF-së.

## 2.3 Përafrimi me direktivat e BE për tregjet

Një nga objektivat kryesore të Autoritetit, që prej krijimit e në vazhdimësi, ka qenë dhe mbetet hartimi dhe miratimi i legjislacionit rregullator dhe mbikëqyrës në fushën e shërbimeve financiare nën mbikëqyrje, duke mundësuar zhvillimin dhe fuqizimin e mëtejshëm të tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit. Ky kuadër ligjor i plotësuar synon përafrimin me standardet ndërkombëtare, në kuadër të përmbushjes së angazhimeve të institucionit dhe të vendit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (ZMSA) me BE.

AMF është institucioni koordinues për Kapitullin 9 "Shërbimet financiare" në kuadrin e Raport Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë. Në bashkëpunim me BSH janë pasqyruar qartësisht zhvillimet aktuale si përsa i përket përafrimit të kuadrit ligjor, aktiviteteve zbatuese, zhvillimeve dhe reformave në sektorin financiar për tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së. Gjatë vitit 2013, AMF ka përgatitur dhe prezantuar informacione pranë Komisionit Evropian (KE) në kuadrin e zhvillimit të takimeve periodike midis

Shqipërisë dhe BE-së, si takimi i katërt i Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri, në mars 2013 dhe takimi i Nënkomitetit BE–Shqipëri për "Tregun e brendshëm dhe konkurrencën" në prill 2013.

Më datë 16 tetor 2013 KE publikoi Raport Progresin për Shqipërinë, i cili përshkruan progresin e bërë nga Shqipëria gjatë periudhës tetor 2012-shtator 2013. Për çështjet në lidhje me veprimtarinë e AMF-së, KE në Kapitullin 9 "Shërbimet financiare" të këtij raporti, vlerësoi pozitivisht disa përparime në fushën financiare jo bankare.

**Komisioni Evropian - Raport Progresi 2013 për Shqipërinë**

***(Kapitulli 9-Shërbimet financiare)***

Në fushën e ***tregjeve të letrave me vlerë dhe shërbimet e investimit***, AMF mori masa për të forcuar mbikëqyrjen dhe menaxhimin e tregut të letrave me vlerë dhe sipërmarrjet kolektive të investimeve.

*Përfundim*

Janë bërë disa përparime në shërbimet financiare, në fushën e bankave. Nevojiten përpjekje shtesë për përafrimin e legjislacionit me acquis në fushat e sigurimit dhe pensioneve të punës, infrastrukturës së tregut financiar, tregut të investimeve dhe shërbimeve të investimit. Kapacitetet mbikëqyrëse duhet të forcohen. Në tërësi, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

## Harmonizimi i kuadrit rregullator me legjislacionin e BE dhe Standardet Ndërkombëtare

Harmonizimi i kuadrit rregullator me standardet ndërkombëtare në fushën e tregjeve financiare nën mbikëqyrje vijoi të jetë në fokus të Autoritetit edhe gjatë vitit 2013. Kështu, gjatë këtij viti u finalizuan një sërë projektesh me synim harmonizimin e plotë të legjislacionit me Direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare.

### *Projekte të përfunduara*

- Amendimet e Ligjit 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" u hartuan duke u bazuar mbi Parimet Bazë dhe standardet ndërkombëtare (ICP 1 dhe 2) të IAIS, anëtare e së cilës është AMF;
- Projektligji "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" u hartua duke u përafruar me kuadrin rregullator evropian të Solvency I, përkatësisht direktivat: 73/239/KEE, 73/240/KEE, 87/344/KEE, 87/343/KEE, 88/357/KEE, 92/49/KEE, 2002/13/KE, 98/78/KE, 2002/92/KE, 2005/68/KE, 2002/83/KE, 2001/17/KE dhe 84/641KEE.

Gjatë vitit 2013 dhe në vazhdim po punohet për:

- Hartimin e amendimeve të Ligjit 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" në përputhje me Direktivat 2003/41/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës e 3 qershor 2003, mbi aktivitetet dhe mbikëqyrjen e institucioneve për dhënien e pensioneve profesionale. Ky projektligj do të përafrohet gjithashtu edhe me direktivat: Direktiva 98/49/KE, Direktiva 2006/54/KE, Direktiva 2008/94/KE, Direktiva 2002/83/KE, Direktiva 2004/39/K, Direktiva 2009/65/KE, si dhe parimet e IOPS dhe OECD-së.
- Hartimin e amendimeve të Ligjit Nr. 10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" në përputhje me Direktivën 2009/103/EK e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 shtator 2009 në lidhje me sigurimin ndaj përgjegjësisë civile në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike, si dhe zbatimin e një detyrimi të tillë, për sigurimin e përgjegjësisë civile në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike.

**Direktiva Solvency II (Direktiva 2009/138/EC)**

Më 2 tetor 2013, KE propozoi një rregullim të dytë të shpejtë të Direktivës *Solvency* II që kishte të bënte me shtyrjen e datës së zbatimit të kësaj direktive deri më 1 janar 2016.

Në tetor 2013 EIOPA publikoi Udhëzim për Përgatitjen e *Solvency* II. Ky udhëzim ka për qëllim të garantojë që autoritetet kompetente kombëtare, shoqëritë e sigurimit dhe grupet e sigurimit të marrin hapa aktivë për një zbatim të qëndrueshëm dhe bashkërendues të elementeve kryesore të Solvency II dhe duke mbuluar fushat e mëposhtme:

- Sistemet e qeverisjes;
- Vlerësimet paraprake për rreziqet që mbartin vetë ndërmarrjet;
- Dhënien e informacionit;
- Zbatimin paraprak për modelet e brendshme.

Më 21 nëntor 2013, në Parlamentin Evropian u mbajt një votim plenar për të ndryshuar dhe të finalizuar datat për zbatimin dhe transpozimin e Direktivës *Solvency* II. Parlamenti miratoi vendosjen e datës së transpozimit për 31 janar 2015 dhe zbatimit për 1 janar 2016.

### Direktiva Omnibus II

Më 13 nëntor 2013 u arrit marrëveshja e përkohshme mes Parlamentit Evropian, KE dhe Këshillit Evropian për Direktivën *Omnibus* II.

Direktiva e emërtuar *Omnibus* II do të plotësojë Direktivën e *Solvency* II dhe rregulloren që krijoi Autoritetin Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (Rregullorja e BE-së Nr. 1094/2010), duke krijuar një kornizë moderne rregullatore dhe mbikëqyrëse më bazë risku për sektorin e sigurimeve.

Direktiva quhet *Omnibus* II për shkak se një Direktivë më parë, e njohur si "*Omnibus* I" futi në fuqi ndryshimet teknike në 11 Direktiva të ndryshme duke qartësuar kompetencat e Autoriteteve Evropiane Mbikëqyrëse. Megjithatë, për arsye teknike, këto ndryshime nuk mbuluan Direktivën e *Solvency* II për sektorin e sigurimeve, për të cilën autoriteti mbikëqyrës kompetent është Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), dhe as Direktivën e Prospektit (Direktiva 2003/71/EC), për të cilën autoriteti mbikëqyrës kompetent është Autoriteti Evropian i Titujve dhe Tregjeve (ESMA).

Direktiva *Omnibus* II, përmban një sërë ndryshimesh të Direktivës *Solvency* II dhe të Direktivës së Prospektit. Këto ndryshime përfshijnë përcaktimin e detyrave të veçanta për EIOPA-n dhe për ESMA-n. Në veçanti, projektdirektiva sqaron rolin e EIOPA-s në garantimin e harmonizimit të qasjeve teknike për llogaritjen e provigjoneve teknike dhe kërkesave të kapitalit. Ajo, gjithashtu, përmban një paketë masash për të garantuar një qartësi në trajtimin e produkteve të sigurimit me garanci afatgjatë për të zbutur efektet e luhatshmërisë artificiale.

### Direktiva UCITS (Direktiva 2009/65/EC)

KE miratoi propozimin e direktivës UCITS V më 3 korrik 2012. Propozimi fokusohet në shtimin dhe përmirësimin e rregullave rreth depozitarëve, pagesave dhe shpërblimeve, sanksioneve dhe kryesisht ka për qëllim të garantojë një përshtatje të Direktivës së UCITS me atë të AIFMD (Direktiva 2011/61/EU).

Parlamenti Evropian votoi për përmbajtjen e projekt direktivës UCITS V më 3 korrik 2013. Një numër propozimesh të diskutueshme që u propozuan nga Komiteti Ekonomik dhe Çështjeve Monetare të Parlamentit Evropian (ECON), më 24 prill 2013 nuk u morën në konsideratë.

Parlamenti Evropian së shpejti do të fillojë negociatat për përmbajtjen e saktë të direktivës së propozuar UCITS V me Këshillin Evropian dhe KE.

### Direktiva e Ndërmjetësimit në Sigurime (IMD) (Direktiva 2002/92/EC)

Në korrik 2012, KE miratoi një propozim për një rishikim të direktivës IMD2. Komisioni propozoi që objekti i IMD2 të zgjerohet për të përfshirë edhe subjektet që shesin produktet e sigurimit, veçanërisht shoqëritë e sigurimit, si dhe rregulla të reja për dhënien e informacioneve shpjeguese dhe rregulla shtesë për një standard më të lartë shitjesh për produktet e sigurimit të investimeve si ato të përcaktuara në MiFID. Propozimi është aktualisht duke u debatuar në Parlamentin dhe Këshillin Evropian.

# Kapitulli 3
# Qeverisja dhe mbrojtja e konsumatorit

## 3.1 Qeverisja dhe sjellja në treg

Gjatë vitit 2013, Autoriteti ka miratuar ndryshime apo riemërime në përbërjen e këshillave mbikëqyrës në dy shoqëri sigurimi, si dhe ka miratuar emërime në organet drejtuese në një shoqëri sigurimi dhe drejtorin ekzekutiv të BSHS.

**Grafik 15: Skema e strukturës aktuale të drejtimit të shoqërive të sigurimit**




**Tabelë 23: Qeverisja e shoqërive të sigurimit – Statistika**

| | *2007* | *2008* | *2009* | *2010* | *2011* | *2012* | *2013* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. mesatar i aksionarëve | 6.0 | 4.5 | 4.2 | 4.4 | 4.2 | 3.7 | 3.6 |
| Nr. mesatar i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës | 5.0 | 3.6 | 3.4 | 3.6 | 4.0 | 4.2 | 4.1 |
| Nr. mesatar i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës që nuk janë aksionarë | 2.0 | 2.8 | 2.7 | 3.1 | 3.5 | 3.7 | 3.6 |
| Nr. i Drejtorëve Ekzekutivë me pjesëmarrje influencuese mbi 10% | 3.0 | 3.0 | 2.0 | 2.0 | 3.0 | 3.0 | 3.0 |

### Tabelë 24: Të dhëna për aksionarët e shoqërive të sigurimit

| *Emërtimi* | *Numri* |
|---|---|
| Shoqëri sigurimi | 11 |
| Aksionarë gjithsej | 40 |
| *Klasifikimi i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese:* | |
| nën 10% | 22 |
| mbi 10% nën 20% | 4 |
| mbi 20% nën 33 % | 3 |
| mbi 33% nën 50% | 1 |
| mbi 50% | 10 |
| *Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës:* | |
| Aksionarë të huaj | 3 |
| Aksionarë vendas | 37 |
| *Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit:* | |
| Aksionarë individë | 31 |
| Aksionarë shoqëri | 8 |
| Aksionarë shteti | 1 |

### Grafik 16: Të dhëna për aksionarët sipas pjesëmarrjes influencuese

*(Në %)*



**Grafik 17: Të dhëna për aksionarët sipas vendit të origjinës** *(Në %)*




**Grafik 18: Të dhëna për aksionarët sipas statusit** *(Në %)*




## Prania e kapitalit të huaj në shoqëritë e sigurimit

Gjatë vitit 2013, në tregun shqiptar të sigurimeve nuk pati ndryshime në numrin e aksionarëve të huaj që zotërojnë aksione në shoqëritë shqiptare të sigurimit dhe aktualisht në tregun shqiptar të sigurimeve operojnë:

- *Vienna Insurance Group AG Wiener Versicherung Gruppe* me seli qendrore në Vienë, Austri;
- *Uniqa International Beteiligungs-Verwaltungs GmbH* me seli qendrore në Vienë, Austri;
- Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve.

### Miratime të ndryshimeve statutore të shoqërive të sigurimit

Gjatë vitit 2013, AMF ka miratuar kërkesat e shoqërive të sigurimit në lidhje me ndryshimet statutore, si më poshtë:

- Miratim i statutit të ri në përshtatje me ndryshimet ligjore, si dhe miratim i ndryshimit të neneve të statutit, për 2 shoqëri sigurimi;
- Miratim i ndryshimit të statutit si rezultat i zmadhimit të kapitalit aksionar, për 3 shoqëri sigurimi;
- Miratim i ndryshimit të statutit si rezultat i ndryshimit të strukturës aksionare, për 2 shoqëri sigurimi.

**Tabelë 25: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutore** *(Në numër shoqërish)*

| *Arsyeja e ndryshimit të statutit* | *2008* | *2009* | *2010* | *2011* | *2012* | *2013* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Statut i ri e ndryshime të tjera | 2 | 2 | 2 | 6 | 6 | 2 |
| Rritje kapitali | 9 | 4 | 2 | 4 | 4 | 3 |
| Ndryshim i strukturës aksionare | 2 | 2 | 5 | 3 | 2 | 2 |

## 3.2 Mbrojtja dhe edukimi i konsumatoreve

Një objektiv shumë i rëndësishëm i AMF-së është mbrojtja e konsumatorit në tregjet financiare në mbikëqyrjen e AMF-së. Për realizmin e këtij objektivi, Autoriteti ka një njësi funksionale të specializuar për trajtimin e problematikave që kanë konsumatorët në përputhje me kuadrin ligjor rregullator në fuqi.

Gjatë vitit 2013, Autoriteti ka trajtuar 48 ankesa, të cilat lidhen kryesisht me pretendime për pagesën e dëmshpërblimeve në sigurime që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm, si dhe kërkesa për interpretime. Nga këto ankesa, 11 prej tyre janë interpretime të kontratave të sigurimit dhe 36 ankesa lidhen me sistemin e dëmshpërblimit në sigurime. Gjatë vitit 2013 ka pasur vetëm një ankesë lidhur me shoqërinë administruese të fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

**Grafik 19: Ankesat dhe zgjidhjet 2007-2013** *(Në numër)*




AMF përdor forma të ndryshme komunikimi dhe informimi të konsumatorit, përsosja e vazhdueshme e të cilave bëhet gjithnjë për të inkurajuar dhe rritur besimin e konsumatorit në rolin e AMF-së.

**Mekanizmat e AMF-së për realizimin e transparencës, komunikimit efektiv me publikun dhe edukimin financiar**

- Sistemi telefonik i ndihmës së konsumatorëve. Ky sistem përfshin numrin e komunikimi me telefoninë fikse, (355 4 2257 557) numrin e telefonit jeshil pa pagese për konsumatorin (0800 6969), sistemin e sms falas për kontaktet (355 694060671) dhe adresën elektronike të email (konsumatori@amf.gov.al);
- Faqja *online* e AMF-së www.amf.gov.al pasqyron në mënyrë të vazhdueshme informacionin lidhur me bazën ligjore të përditësuar për tregjet nën mbikëqyrje, njoftimet për veprimtarinë vendimmarrëse të Bordit të Autoritetit;
- Faqja *online* pasqyron informacion për subjektet që veprojnë në tregjet e mbikëqyrura duke dhënë formën e organizmit dhe stafin drejtues ekzekutiv;
- Në rubrika të veçantë në faqen *online* pasqyrohen informacione edukuese për konsumatorin si edhe njoftime për zhvillimet e reja në vendet e rajonit për këto tregje, nëpërmjet publikimeve të përmuajshme të lajmeve.

# Kapitulli 4
# Transparenca dhe bashkëpunimi institucional

## 4.1 Transparenca dhe marrëdhëniet me publikun

Gjatë vitit 2013 publikut i është ofruar informacion i gjerë në lidhje me tregjet financiare nën mbikëqyrje. Mediat e shkruara, kryesisht ato me tirazh më të lartë, kanë pasqyruar në mënyrë sistematike aktivitetin e AMF-së. Ndër tematikat më të pasqyruara në media kanë qenë ato që lidheshin me ndjeshmëritë e publikut për tarifat e sigurimit të detyrueshëm motorik dhe përgjithësisht zhvillimet në tregun e sigurimeve; informacioni mbi pensionet private vullnetare; ecuria në tregun e letrave me vlerë. Këto janë shprehur në mbi 140 prezantime në gazetat e përditshme si edhe rreth 30 dalje në televizionet me mbulim kombëtar dhe rajonal.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe komunikimeve të Kryetares së Autoritetit me tregun, grupet e interesit, si edhe me publikun në prezantimin e strategjive të zhvillimit. AMF ka organizuar disa takime me drejtorët e shoqërive të sigurimit me fokus ecurinë e tregun për sigurimin e detyrueshëm motorik, tarifat dhe pagesa e dëmeve. Gjatë takimeve u propozuan një sërë masash për ecurinë e mëtejshme të tregut. Gjerësisht në takime dhe më pas edhe në media është pasqyruar puna për zbatimit të sistemit *Bonus-Malus* dhe ecuria teknike për të filluar tarifimin me bazë risku.

Në mars 2013, pas një pune të përbashkët me ekspertë të BB u përgatitën propozime konkrete për ndryshime të ligjit, rregulloreve dhe udhëzimeve që rregullojnë pensionet private vullnetare në Shqipëri. I gjithë kuadri rregullues do të përshtatet me ndryshimet në legjislacionin evropian të viteve të fundit si edhe zbatimin e tyre në kushtet konkrete të tregut shqiptar të pensioneve vullnetare. Ky proces gjeti pasqyrim të gjerë në një program televiziv të caktuar me këtë tematikë.

Përfundimi i projektit të liberalizimit të sigurimit të detyrueshëm, i cili u realizua në mbështetjen e BB, në prill të 2013 gjeti një mbulim të gjerë mediatik në shtypin e shkruar dhe televizionet kombëtare e lokale. Mbulimi mediatik ishte si në formën e kronikave ashtu edhe në emisione të dedikuara këtij procesi. Mediave dhe publikut ju prezantuan përmirësimet që do të sjellë skema e re dhe si do të ndikojë ajo edhe në promovimin e drejtimit më të sigurt të mjeteve motorike.

Krahas komunikimit në media, AMF përdor një larmi formash dhe metodash për të arritur një komunikim sa më efektiv me publikun. Këtu mund të veçojmë komunikimin përmes faqes zyrtare

**Botimet e AMF-së**

- Raporti Vjetor
- Raporti i Mbikëqyrjes
- Gjeografia e Sigurimeve
- Buletini zyrtar
- Fletëpalosje për tregjet nën mbikëqyrje

**Publikime elektronike të AMF-së**

- Periodiku mujor informativ
- Buletini Statistikor i tregut të sigurimeve
- Buletini Statistikor i tregut të letrave me vlerë
- Buletini Statistikor i tregut të pensioneve private vullnetare

të internetit, buletinet mujore informuese për të tre tregjet e mbikëqyrura, botimet periodike vjetore, fletëpalosjet, etj.

Edhe gjatë vitit 2013 një vëmendje e veçantë ju kushtua faqes zyrtare të AMF-së www.amf.gov.al duke e pasuruar atë me informacion të vlefshëm, të përditësuar me zhvillimet më të fundit të tregjeve. Këto informacione janë mjaft të vlefshme si për shoqëritë e sigurimit ashtu edhe për publikun si konsumator i këtyre shërbimeve.

Faqja është e organizuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht dhe në këtë mënyrë ajo i shërben edhe investitorëve apo analistëve të huaj si burim informacioni për strukturën dhe zhvillimin e tregjeve financiare të sigurimeve, pensioneve private dhe letrave me vlerë në Shqipëri. Faqja zyrtare në internet e AMF-së jep të përditësuar edhe të gjithë informacionin mbi të gjithë vendimit e Bordit të AMF-së. Gjatë vitit 2013 në faqen *online* të AMF-së ka pasur 288,538 klikime dhe mbi 90% e tyre i referohen kërkimit të lajmeve të vendosura në faqen kryesore, njoftimeve periodike dhe publikimeve statistikore.

## 4.2 Bashkëpunimi institucional

### Bashkëpunimi me institucionet e vendit

Rritja e bashkëveprimit të rregullatorëve të ndryshëm ekonomikë dhe financiarë është vënë në qendër të proceseve që promovojnë nxitjen e shëndoshjen financiare të tregjeve. Nisur nga ky këndvështrim, AMF ka bashkëpunuar ngushtësisht me institucionet e tjera ekonomike të vendit, rajonit e më gjerë për zhvillimin e rregullimin e tregut të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private vullnetare.

Në funksion të forcimit të tregut të sigurimeve, dhe specifikisht për sigurimet e detyrueshme motorike, AMF ka punuar ngushtësisht me Ministrinë e Brendshme, **Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit** si edhe **Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor.** Në sajë edhe të marrëveshjeve të realizuara më parë me këto institucione, bashkëpunimi ka mundësuar kontrollin e zbatimit të legjislacionit për sigurimin e detyrueshëm, evidentimin e saktë dhe pajisjen e mjeteve motorike që lëvizin në territorin e Republikës së Shqipërisë me kontrata sigurimi të vlefshme.

Në kuadrin e liberalizimit të tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik, AMF ka vënë në dispozicion gjithë informacion e kërkuar nga **Autoriteti i Konkurrencës** për ta ndihmuar atë në punën investiguese në tregun e sigurimeve.

AMF edhe gjatë 2013 ka mbajtur kontakte të rregullta me **Ministrinë e Integrimit Evropian** si institucioni koordinues i të gjitha përpjekjeve të vendit drejt integrimit evropian. Në raportet periodike të përgatitura, AMF ka pasqyruar progresin e arritur në drejtim të realizimit të masave ligjore dhe aktiviteteve zbatuese, sipas afateve të parashikuara në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA), si dhe

përshkrimin e shkallës së përputhshmërisë së akteve juridike të miratuara për tregun financiar nën mbikëqyrje me *acquis communautaire*.

Gjatë vitit 2013, AMF vazhdoi punën në proceset e iniciuara nga Ministria e Integrimit Evropian lidhur me sistemin *online* ndërinstitucional për përcaktimin e *acquis communautaire* që lidhen me veprimtarinë në tregjet që mbikëqyr Autoriteti. Po kështu vazhdoi të bëhet pasqyrimi *online* në sistem i masave ligjore në kuadër të PKZMSA-së 2012-2015.

Ekspertë nga **Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)** kanë trajnuar specialistë të mbikëqyrjes në AMF lidhur me përgjegjësitë ligjore dhe specifikat e punës së Autoritetit në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në institucionet që janë subjekt i legjislacionit përkatës. Kjo ka thelluar më tej bashkëpunimin midis AMF-së dhe këtij institucioni.

Gjithashtu, AMF gjatë vitit 2013, në programin e saj të inspektimit në vend duke bashkëpunuar me DPPPP për një nga subjektet e mbikëqyrura ka përfshirë për herë të parë edhe disa çështje që lidhen me verifikimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore të përbashkëta të të dy institucioneve.

## Bashkëpunimi Evropian

Një pjesë mjaft e rëndësishme e bashkëpunimit ndërkombëtar për AMF edhe gjatë vitit 2013 ishte me vendet e BE dhe organizmat rregullatore të ngritura nga EU.

Në korrik 2013, AMF nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me 23 organizma rregullatorë evropianë që veprojnë në tregjet e letrave me vlerë dhe më specifikisht për fondet alternative të investimeve. Nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve u koordinua nga **Autoriteti Evropian i Tregjeve dhe Letrave me Vlerë, ESMA** në zbatim të direktivave të BE-së. Marrëveshjet bilaterale me secilin nga rregullatorët homologë synojnë bashkëpunimin për konsultime, shkëmbim të informacionit lidhur me mbikëqyrjen e Subjekteve Administruese të Fondeve Alternative të Investimeve. Ato gjithashtu përcaktojnë qëllimin e bashkëpunimeve, procedurat që ndiqen në rastin e vizitave ndërkufitare, rregullat e konfidencialitetit për informacionin, etj. Edhe pse në Shqipëri aktivitetet e këtyre fondeve janë ende të pazhvilluara, nënshkrimi i marrëveshjeve konsiderohet si një hap i rëndësishëm në rritjen e bashkëpunimit mbikëqyrës midis AMF dhe vendeve anëtare të BE-së.

Në kuadër të programeve teknike nga BE, instrumenti **TAIEX**, (*Technical Assistance and Information Exchange*) AMF gjatë vitit 2013 u asistua nga një mision ekspertize "Mbi përafrimin e Direktivë së BE-së në lidhje me sigurimin e detyrueshëm motorik". Qëllimi i këtij misioni ishte të ndihmonte Autoritetin në procesin e amendimit të Ligjit "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", për të arritur përafrimin e plotë me legjislacionin e BE.

Fushat kryesore ku AMF do të ndihmohet në vazhdimësi nga instrumenti TAIEX me

ekspertizë lidhen me përshtatjen e legjislacionit, ndërgjegjësimin e mëtejshëm të publikut për sistemin e pensioneve private vullnetare, krijimin e një Depozitari Qendror për letrat me vlerë, mbikëqyrjen në grup për sigurimet, si edhe mbikëqyrjen me bazë risku për fondet e pensioneve private vullnetare.

## Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare

AMF është anëtare e **Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS)** që prej vitit 2001. Gjatë vitit 2013, AMF vazhdon të jetë pjesëmarrëse me kontribut aktiv në IAIS. Kryetarja e AMF-së është anëtare e Nënkomitetit të Përfshirjes Financiare (*Financial Inclusion Subcommittee*) i cili promovon në veçanti tregjet dhe ekonomitë në zhvillim lidhur me zbatimin e Parimeve Themelore të sigurimeve për të mbështetur rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve të sigurimeve dhe forma të tjera të veçanta të sigurimit.

### Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me IAIS

- Mbledhje të Nënkomiteteve të Punës, mars;
- Mbledhja e Nënkomitetit të Përfshirjes Financiare, prill;
- Seminar "*Çështje kryesore të mbikëqyrjes*", prill;
- Seminar "*Fleksibiliteti i siguruesve në një botë financiare në ndryshim*", prill;
- Seminar "*Aplikimi i teknikave të menaxhimit të riskut dhe kuptimi i modeleve të brendshme në sigurime*", tetor;
- Konferenca vjetore, 2013 "*Ndërtimi i mbikëqyrjes së qëndrueshme në sigurime në një botë që ndryshon*", tetor.

AMF është anëtare me të drejta të plota në **Organizatën Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO)** dhe njëkohësisht nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të IOSCO-s që prej vitit 2009. AMF është gjithashtu pjesëmarrëse aktive në Komitetin Evropian të IOSCO (*European Regional Committee, ERC*) dhe në Komitetin e Tregjeve në Rritje e Zhvillim (*Growth and Emerging Markets Committee, GEM*).

### Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me IOSCO

- Mbledhja e Komitetit Rajonal Evropian, mars, qershor;
- Program trajnimi "*Çështje rregullatore*", maj;
- Mbledhja vjetore, 2013 "*Bashkëpunimi financiar në nivel global*", shtator;
- Mbledhjet e Komiteteve të Punës, tetor;
- Seminar "*Çështje të qeverisjes së korporatave të lidhura me firmat e letrave me vlerë dhe sanksionet për abuzim të tregut*", tetor;
- Seminar "*Libri i shitjeve dhe infrastruktura e tregut*", nëntor.

AMF është anëtare e **Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS)** që prej vitit 2006.

Pjesëmarrja e AMF-së në këto aktivitete konsiston në angazhimin për hartimin e dokumenteve politikë dhe studimorë. Gjatë 2013, AMF informoi mbi disa materiale studimore të përgatitura nga IOPS, si dhe u përfshi në përmirësimin e tekstit të dokumentit politik mbi "Praktikat e mira të IOPS-it për qeverisjen e autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneve".

**Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me IOPS**

- Mbledhjet e Komiteteve Ekzekutive dhe Teknike, mars;
- Shkëmbim përvojash – Maqedoni, Çeki "*Mbikëqyrja e pensioneve*" në rajon, mars;
- Mbledhjet e Komiteteve Ekzekutive dhe Teknike, qershor;
- Forumi botëror "*Pensionet në Azi – mësime për botën*", nëntor;
- Mbledhja e Përgjithshme Vjetore, dhe miratimi i dokumentit "*Praktikat e mira të IOPS-it për qeverisjen e autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneve*", nëntor.

## Bashkëpunimi me institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët

Bashkëpunimi dhe marrëdhëniet efektive me institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët kanë vazhduar t'i shërbejnë realizimit të projekteve strategjike dhe rritjes së kapaciteteve institucionale të AMF-së.

**Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare (FSVC/USAID)** ka qenë një ndër organizatat e rëndësishme mbështetëse ndër vite dhe vazhdon të mbetet një ndër partnerët kryesorë të AMF-së, në drejtim të asistencës teknike që i ka ofruar institucionit vitet e fundit.

Gjatë 2013 FSVC mbështeti projektin për hartimin e strategjisë për zhvillimin e tregut të letrave me vlerë në Shqipëri. Projekti synon vlerësimin e kuadrit rregullues legjislativ, përcaktimin e nivelit aktual të zhvillimit dhe faktorëve kryesorë që e influencojnë atë, përcaktimin e barrierave të mundshme si edhe mundësitë për zhvillim më tej të këtij tregu. Ndërtimi i strategjisë për zhvillimin e tregut të letrave me vlerë në Shqipëri është i rëndësishëm në kushtet e zhvillimeve të sotme të këtij tregu.

**Veprimtaritë kryesore të bashkëpunimit institucional**

**CESEE** – "Nisma Rajonale e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve"

- Takimi i 5-të - Fokus në ndarjen e sigurimeve të Jetës dhe Jo-Jetës, kostot e ndërmjetësve financiarë, zbatueshmëria e vendimeve të autoriteteve mbikëqyrëse, Sarajevë, maj;
- Takimi i 6-të - Fokus në kontratat e sigurimit, dhe rolin e auditive të jashtëm, Budva, tetor.

**USAID/FSVC**

- *Workshop* "Mbikëqyrja me bazë riskun", janar;
- Hartimi i strategjisë për zhvillimin e tregut të letrave me vlerë, shkurt.
- Hartimi i strategjisë së administrimit dhe zgjidhjes së krizave, qershor;

**BB**

- *Workshop* "Aspekte Aktuariale të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në Shqipëri", shkurt;
- Shkëmbim përvojash "Përvoja në drejtim të sigurimit të detyrueshëm motorik dhe Kartonit Jeshil", Turqi, Itali, shkurt - mars;
- *Workshop* "Përmbyllja e projektit për liberalizimin e sigurimit të detyrueshme motorik", prill.

**Banka Botërore** mbetet një partner i rëndësishëm strategjik në përmbushje të misionit themelor të AMF-së. Gjatë vitit 2013, e mbështetur nga Programi **First Initiative, BB** Autoriteti përmbylli projektin mbi "Liberalizimin e sigurimit të detyrueshëm motorik, MTPL". Projekti i cili kishte filluar që prej vitit 2011, synonte përcaktimin e strategjisë së mbikëqyrjes dhe të tarifimit të portofolit të sigurimit të detyrueshëm motorik në Shqipëri. Pjesë e projektit është edhe zhvillimi i një strategjie për menaxhimin e numrit të të pasiguruarve dhe ngritja në të ardhmen e një baze të dhënash kundër mashtrimeve në sigurime. Specialistët e AMF-së në bashkëpunim me ekspertët e BB-së prezantuan përpara shoqërive të sigurimit propozimet e tyre për mundësitë që tregu shqiptar ka për ndërtimin e tarifave të primit të sigurimit të detyrueshëm motorik me bazë risku duke integruar mundësimin e përqasjes *Bonus-Malus*.

**Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar,** pranë BB, gjatë muajve janar-mars 2013 realizoi projektin për harmonizimin e legjislacionit të pensioneve private vullnetare me direktivat e Bashkimit Evropian dhe parimet e OECD-së. Nevoja për harmonizimin e plotë të legjislacionit vjen edhe si rezultat i angazhimeve që AMF ka marrë në procesin e anëtarësimit në BE. Projekti i shërbeu edhe unifikimit të praktikave dhe proceseve në kolonën e tretë, të sistemit të pensioneve duke i hapur rrugën dhe ndërtimit të infrastrukturës

së mbikëqyrjes. Projekti paraqiti një grup rekomandimesh për të përmirësuar aspekte të rregullimit si politikat e investimit të aseteve të fondeve të pensionit, taksimin mbi këto fonde, mënyrat e ndërtimit të fondeve të pensioneve profesionale, etj. AMF po punon për t'i konkretizuar rekomandimet në propozime legjislative.

## Bashkëpunimi rajonal

Një partner mjaft i rëndësishëm i AMF-së në konsolidimin e tregjeve financiare nën mbikëqyrje prej vitesh është **Autoriteti i Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA)**. Drejtori për Mbikëqyrjen e Tregjeve Financiare të FMA Z. Peter Braumüller, njëkohësisht edhe anëtar i Bordit të EIOPA (Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale) dhe Kryetar i Komitetit Ekzekutiv i IAIS, bëri një vizitë pune pranë zyrave të AMF-së. Objekt i takimit ishin çështje që lidhen me zhvillimet e fundit ligjore të mbikëqyrjes së tregjeve të sigurimit dhe identifikimin e fushave për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve midis dy institucioneve. Takimi i shërbeu vazhdimësisë së mbikëqyrjes së përbashkët të grupeve austriake të sigurimeve me prezencë dominuese në tregun shqiptar të sigurimeve. Po kështu ekspertë të departamentit të mbikëqyrjes së AMF-së morën pjesë në mbledhjen e Kolegjit të Mbikëqyrjes për shoqërinë *UNIQA Insurance Group (UIG)*. Takimi shërbeu për të bërë vlerësimin e riskut të shoqërisë UNIQA sipas rregullatorëve përkatës, fokusuar në kategori të veçanta të riskut, si risku makroekonomik, ligjor, shtetëror, etj. Ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe më tej për të gjitha shoqëritë austriake të sigurimit që kanë aktivitet në Shqipëri.

Gjatë vitit 2013, kontaktet e bashkëpunimit me **Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK)**, janë shtrirë në diskutimin mbi strategjitë dhe projektet e përbashkëta për një zhvillim të mëtejshëm. Kjo edhe sepse shoqëritë shqiptare të sigurimit kanë peshë të konsiderueshme në tregun e Kosovës. Gjatë vizitës zyrtare në AMF, delegacioni i BQK, i kryesuar nga zëvendësguvernatori i saj diskutuan mbi problematikat e mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve respektive si edhe mbi tema specifike si byrotë e sigurimeve. Takime të tilla i shërbejnë nxitjes më të madhe të bashkëpunimit midis institucioneve, shkëmbimit të informacionit dhe përvojave profesionale.

AMF ka bashkëpunuar ngushtë me **Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë (ISA)**. Marrëveshja e Mirëkuptimit midis të dy institucioneve që është në veprim prej vitesh ndikon pozitivisht në efikasitetin e mbikëqyrjes dhe rregullimit të industrisë së sigurimeve të të dy vendeve edhe në kushtet e shtrirjes së veprimtarisë të kompanive shqiptare të sigurimit në territorin e Maqedonisë.

Në tregun e pensioneve private vullnetare AMF ka bashkëpunuar edhe me **Agjencionin për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS) Maqedoni**. Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit për Bashkëpunim Teknik me këtë institucion vitin e kaluar përfshin shkëmbimin e përvojave të dy institucioneve në drejtim të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregut të pensioneve private vullnetare dhe kuadrit ligjor.

Ky bashkëpunim u ndoq nga një vizitë e nivelit të lartë të drejtuesve të AMF-së pranë zyrave të MAPAS, në mars 2013. Në takimet e drejtuesve dhe specialistëve u shkëmbyen përvojat e fituara në fushën e pensioneve private dhe legjislacionit për to, punën e fondeve pensionale, mekanizmat e mbikëqyrjes të këtyre fondeve, etj.

Në kuadër të nismës rajonale, "Iniciativa Rajonale për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore" **(CESEE)** AMF ishte pjesëmarrëse aktive e dy takimeve të zhvilluara. Gjatë 2013 janë zhvilluar takimi i pestë dhe i gjashtë i kësaj iniciative respektivisht në Sarajevë dhe Budva. Takimi i pestë i zhvilluar në maj 2013 pranë Agjencisë së Sigurimeve të Bosnjë-Hercegovinës kishte si tematika kryesore krijimin e një strukture mbikëqyrëse efektive, shkëmbimin e përvojave me mekanizma alternative të zgjidhjes së kontestimeve në sigurime, diskutimin e produkteve të sigurimit të Jetës dhe Jo-Jetës, eksperiencat e Solvency 1 dhe problemet brenda Solvency 2, etj.

Takimi i gjashtë u organizua në tetor 2013 nga FMA e Austrisë në bashkëpunim me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi (ISA). Në takim u diskutuan çështje të lidhura me kërkesat specifike që duhet të plotësohen nga menaxherët për shoqëritë e sigurimeve, luftën kundër pastrimit të parave, rolin e mbikëqyrësve në sigurime dhe rolin e auditit të jashtëm në sigurime. Gjatë takimit u theksua rëndësia e madhe që autoritetet mbikëqyrëse duhet t'i kushtojnë momentit të miratimit të drejtuesve të shoqërive të sigurimit, duke kërkuar që ata të jenë sa më të kualifikuar dhe me integritet të lartë moral.

Nisma CESEE konsiderohet e suksesshme, nisur nga interesimi i vazhdueshëm dhe pjesëmarrja aktive e vendeve të rajonit, duke ruajtur dhe nxitur më tej frymën e bashkëpunimit efektiv mbi çështjet dhe problematikat e përbashkëta që hasen në rregullimin e tregjeve të sigurimeve në rajon.

Bashkëpunimi me institucione homologe në fushën e pensioneve u konkretizua me takime me drejtues të **Bankës Kombëtare të Çekisë (CNB)** dhe fondeve të pensioneve private. Programi u realizua me mbështetjen e BB, në kuadër të projektit për shkëmbimin e përvojave në fushën e pensioneve private vullnetare. Tematikat kryesore të diskutimeve lidheshin me ndërtimin e një reforme në sistemin e pensioneve duke e përshtatur atë me rregullat e Bashkimit Evropian.

Bashkëpunimi me **Shoqatën e Siguruesve të Turqisë, Byronë e Kartonit Jeshil dhe Qendrën për Informacion në Sigurime të Turqisë** gjatë 2013 u konkretizua me vizita dhe takime me drejtues të lartë të këtyre institucioneve. Programi u realizua me mbështetjen e BB, në kuadër të projektit për liberalizimin e sigurimit të detyrueshëm motorik. Turqia është një vend me një treg të zhvilluar të sigurimeve motorike dhe ka hyrë shumë kohë me parë në procesin e liberalizmit të çmimeve të sigurimeve të detyrueshme motorike. Eksperienca e institucioneve të specializuar të Turqisë, lidhej me aspekte të tilla si ndërtimi i bazës së të dhënave për menaxhimin e sigurimit të detyrueshëm motorik, monitorimin e sistemit të tarifave të sigurimit të detyrueshëm motorik, rolin e aktuarëve në llogaritjen e rezervës së dëmeve, rolin e Fondit të Garancisë, aktivitetin e Byrosë së Kartonit Jeshil, zyrave të arbitrazhit në sigurime, etj.

# Kapitulli 5
# Organizimi i brendshëm

## 5.1 Pasqyrat Financiare

### Auditimi

Duke nisur nga viti 2007 e në vazhdim, pasqyrat financiare vjetore të AMF-së auditohen nga ekspertë kontabël të autorizuar, pavarësisht se një gjë e tillë nuk buron nga detyrime ligjore. Raportet e ekspertit kontabël në përgjithësi vlerësojnë se: … "Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të AMF-së si edhe performacën financiare".

Ndërsa funksioni i auditimit të brendshëm në AMF kryhet nga një specialist auditimi, i pajisur me certifikatën e audituesit të brendshëm të sektorit publik, i cili raporton te Kryetari dhe te Bordi i Autoritetit. Në vitin 2013, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përmbushur të gjitha detyrat e planifikuara. Në bazë të gjetjeve të auditimeve të kryera, gjatë vitit 2013, janë dhënë 28 rekomandime, të cilat u janë raportuar njësive të audituara, si dhe Bordit të AMF-së. Urdhri i Kryetarit është nxjerrë për të gjitha rekomandimet e lëna nga auditimi i brendshëm dhe më tepër se 93% e tyre janë vënë në zbatim.

### Buxheti

Prej vitit 2009 AMF financohet tërësisht nga burimet e veta. Të ardhurat gjithsej të AMF-së për vitin 2013 ishin 139.72 milionë lekë ose 1.97% më pak krahasuar me vitin 2012. Pothuajse të gjitha të ardhurat e realizuara,139.42 milionë lekë, përftohen nga tarifat e paguara prej subjekteve të mbikëqyrura, pjesa tjetër ka ardhur nga gjobat dhe interesat bankare.

Kontributi kryesor brenda grupit të të ardhurave të veprimtarisë i përket të ardhurave të përfituara nga kontributet e paguara prej subjekteve të tregut të sigurimeve, të cilat përbëjnë 86.48% të të ardhurave gjithsej. Niveli i realizimit të të ardhurave nga këto kontribute është rreth 10.35% më pak se viti 2012, si rrjedhojë e uljes së volumit të primeve të shkruara bruto në këtë treg.

**Tabelë 26: Burimet e fondeve të AMF-së** *(Në mijë lekë)*

| *Emërtimi* | | *Vlera* |
|---|---|---|
| **1. Të ardhura nga veprimtaria** | | **139,420** |
| 1.1 | Të ardhura nga tregu i sigurimeve | 120,841 |
| | 1.1.1 Të ardhura nga kontributet e shoqërive të sigurimit | 119,176 |
| | 1.1.2 Të ardhura nga licencime në tregun e sigurimit | 1,665 |
| 1.2 | Të ardhura nga tregu i letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve | 18,384 |
| 1.3 | Të ardhura nga kontributet e shoq. admin. të fondeve të pensioneve private | 195 |
| **2.** | **Të ardhura nga gjobat dhe interesat bankare** | **306** |
| **Totali (1+2)** | | **139,726** |

**Tabelë 27: Përdorimi i fondeve të AMF-së** *(Në mijë lekë)*

| *Emërtimi* | | *Vlera* |
|---|---|---|
| **1. Shpenzime funksionimi** | | **110,430** |
| 1.1 | Paga, shpërblime, sigurime shoqërore | 70,888 |
| 1.2 | Shpenzime operative | 39,542 |
| **2. Investime** | | **3,446** |
| 2.1 | Blerje pajisje dhe programe kompjuterike | 3,025 |
| 2.2 | Blerje aktive të qëndrueshme të trupëzuara të tjera | 56 |
| 2.3 | Të tjera (shpenzime për arkivën) | 365 |
| **3. Fonde të regjistruar për periudhat e ardhshme** | | **25,850** |
| **Totali (1+2+3)** | | **139,726** |

Gjatë vitit 2013 të ardhurat e përdorura gjithsej ishin 113.87 milionë lekë, pothuaj sa një vit më parë (0.53% më shumë). Shpenzimet e funksionimit përbëjnë përdorimin kryesor të të ardhurave të AMF-së, duke zënë 96.97% të shpenzimeve gjithsej. Për vitin 2013 ato janë realizuar në masën 113.87 milionë lekë ose 0.52% më shumë se viti 2012. Shpenzimet për investime në vitin 2013 janë realizuar në masën 3.44 milionë lekë ose 16.95% më shumë viti 2012.

Gjatë vitit 2013, AMF në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 366, datë 24.04.2013 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të disa ambienteve, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, te Ministria e Financave, për Njësinë e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit" liroi një pjesë të godinave të saj ku ndodhej arkiva ndër vite. Kjo rezultoi në pakësimin e Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara për AMF-në me një vlerë prej afro 16.5 milion lekë, e cila së bashku me veprimet korrigjuese për fondin e amortizimit, pasqyrohen në pasqyrat financiare të vitit 2013[15].

Kështu AMF, përshtati një pjesë tjetër të godinës së saj për mbajtjen e arkivës, duke investuar për këtë një vlerë prej 365 mijë lekë.

Në zbatim të planit të investimeve, AMF ka hartuar e zbatuar edhe planin e prokurimeve, i cili gjatë vitit 2013, përmbante 5 procedura prokurimi me tenderim, ndërsa mbulimi i nevojave të tjera është realizuar me prokurime me vlera të vogla. Të gjitha procedurat e planifikuara të prokurimit janë realizuar.

Shënim: [15] Aneks D: Raport i eksperti kontabël të pavarur mbi aktivitetin e AMF-së.

## 5.2. Struktura organizative e kualifikimi profesional

AMF funksionon në bazë të strukturës së miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me Vendim nr. 98, datë 30.04.2007 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Bordit të Autoritetit dhe ka 58 punonjës. Në fund të vitit 2013, shkalla e plotësimit të vendeve të punës në AMF, e matur me numrin e vendeve të punës sipas strukturës së miratuar dhe për të cilat janë punësuar punonjësit, ka arritur në 87%.

Numri i punonjësve që i përkasin njësive që kryejnë funksione kryesore të AMF-së, të tilla si licencimi, rregullimi e mbikëqyrja gjatë vitit 2013 zinte rreth 80%. Në këtë grup janë përfshirë edhe të emëruarit në nivelet e larta drejtuese. Pjesa tjetër, rreth 20% janë punonjës të angazhuar në funksionet mbështetëse, që mundësojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të institucionit.

**Grafik 20: Struktura e punonjësve të funksioneve kryesore sipas njësive** *(Në %)*




**Grafik 21: Struktura e punonjësve sipas profesionit** *(Në %)*



Duke ndjekur zhvillimet në tregjet financiare nën mbikëqyrje dhe sfidat që shtrohen përpara Autoritetit, sidomos në kushtet e krizës globale financiare, BB dhe KE në mënyrë të vazhdueshme kanë vënë theksin në forcimin e kapaciteteve njerëzore të AMF-së. Këto rekomandime që përmbahen në raportet e misionit FSAP dhe në raport progresin e KE-së, 2013, kanë të bëjnë me sigurimin e një strukture organizative më elastike që t'i përshtatet prirjeve të zhvillimit të tregut që mbikëqyr, me tërheqjen, mbajtjen dhe trajnimin e punonjësve të aftë e me integritet dhe me kualifikimin e vazhdueshëm të tyre. Bazuar në këto rekomandime, AMF ka përgatitur dhe paraqitur një paketë ndryshimesh të nevojshme ligjore, për të rritur shkallën e pavarësisë operacionale.

**Grafik 22: Struktura e punonjësve të AMF-së sipas grupmoshës** *(Në numër)*




**Grafik 23: Struktura e punonjësve sipas diplomimit** *(Në %)*



AMF edhe gjatë vitit 2013, është kujdesur të ruajë raporte optimale në strukturën e punonjësve bazuar në tiparet e tyre si arsimimi apo mosha. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar punësimit të të rinjve që janë diplomuar apo kualifikuar me rezultate të larta, duke mundësuar pasurimin e mjedisit profesional me përvoja të reja dhe shërbyer si një burim real zhvillimi të punës në Autoritet. Po ashtu, ruajtja e nivelit prej disa vitesh të moshës mesatare në 39 vjeç, ka sjellë harmonizimin më të mirë të cilësive të brezave të ndryshëm dhe ka siguruar transmetim të pandërprerë të njohurive dhe përvojës.

## Politikat e Burimeve Njerëzore

Zhvillimi i burimeve njerëzore në AMF i shërben rritjes së kapacitetit profesional të punonjësve në përputhje me misionin dhe objektivat strategjikë të Autoritetit. Gjatë vitit 2013, vëmendja u përqendrua në:

- Nxitjen dhe motivimin e punonjësve;
- Trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve;
- Punësimin e burimeve njerëzore gjithnjë e më cilësore.

Gjatë vitit 2013, për herë të parë u ndërtua dhe u zbatua plani profesional i pensionit suplementar për punonjësit e Autoritetit, një mekanizëm i ri që synon të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në motivimin e punonjësve dhe të lejojë plotësimin më të mirë të detyrave dhe objektivave institucionalë. Krahas tij janë aplikuar, sistemet e ndihmave ekonomike dhe diferencimit të shpërblimeve për rezultatet në punë, si pjesë e politikës nxitëse dhe motivuese për punonjësit.

Gjatë vitit 2013 numri gjithsej i punonjësve të AMF-së u shtua me 1, si rrjedhojë e punësimit të 4 punonjësve të rinj dhe largimit me kërkesa individuale të 3 punonjësve. Bazuar në rekomandimet e misionit FSAP dhe në raport progresin e KE-së, 2013, paketa e ndryshimeve të nevojshme ligjore e përgatitur dhe paraqitur nga AMF përmban dispozita që synojnë të forcojnë pavarësinë financiare të Autoritetit për të qenë në gjendje që jo vetëm të tërheqë, por edhe të arrijë të mbajë punonjës të aftë dhe me integritet.

## Kualifikimi profesional

Me qëllim rritjen e ekspertizës profesionale, edhe gjatë vitit 2013 u ruajt përgjithësisht linja e specializimit të punonjësve në profilin ku ata punojnë. Rreth 70% e stafit teknik ka marrë pjesë në aktivitete të tilla trajnimi, duke bërë një kombinim interesave personale për zhvillim profesional dhe objektivave të institucionit për kualifikim të punonjësve.

Një numër i madh trajnimesh, gjatë 2013 janë lidhur kryesisht me tregun e sigurimeve dhe veçanërisht me sigurimin e detyrueshëm motorik, si pjesa më dinamike e tregut. Kështu, AMF në bashkëpunim me BB organizuan në muajin shkurt programin e trajnimit "Aspekte Aktuariale të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në Shqipëri" me specialistë të

fushës së aktuaristikës në nivel të gjerë duke përfshirë edhe specialistë nga departamentet e marrjes në sigurim dhe të dëmeve të shoqërive të sigurimit. Ky trajnim mundësoi prezantimin e metodave të reja në llogaritjen e primit të riskut në kontratat e sigurimit te detyrueshëm. Aktivitete dhe trajnime të tjera të rëndësishme kanë vijuar përgjatë vitit 2013.

AMF ka vazhduar për të tretin vit radhazi përdorimin e trajnimit *online* të programit "*FSI Connect*". Nëpërmjet 5 pozicioneve përdoruesish *online* të këtij programi, AMF ka synuar dhënien e njohurive të reja dhe thellimi më tej të tyre, për të gjitha nivelet e punonjësve në AMF në drejtim të mbikëqyrjes në fushën e sigurimeve.

**Tematikat kryesore të trajnimeve gjatë vitit 2013**

- Tregjet e kapitalit dhe instrumentet e rinj financiarë;
- Mbi standardet ndërkombëtare të raportimit financiar;
- Vlerësimi i modeleve të brendshme në tregun e sigurimeve: Qasja sasiore dhe cilësore;
- Zhvillimet në ligjin e pensioneve dhe mbikëqyrja;
- Parimet kryesore në fushën e mbikëqyrjes në sigurime;
- Parandalimi dhe gjetja e mashtrimeve në sigurime;
- Mbrojtja e konsumatorit në tregun e sigurimeve;
- Legjislacioni i BE-së në fushën e shërbimeve financiare.

## 5.3 Kuadri rregullues i AMF-së

Gjatë vitit 2013, AMF ka punuar për ndryshimin e Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 **"Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare"**.

Përgatitja e këtij projektligji u bë nga AMF në bashkëpunim me grupin e ekspertëve të FSVC-së, duke marrë në konsideratë rekomandimet dhe komentet e paraqitura në vite nga BB në *aide memoire*, KE në raportet vjetore të progresit të përgatitura për Shqipërinë, FMN në raportin e vlerësimit të situatës për ngritjen e strukturave dhe forcimin e luftës kundër pastrimit të parave me origjinë nga veprimtaritë e paligjshme dhe që përdoren për financimin e terrorizmit si dhe kriteret dhe parimet ndërkombëtare të hartuara nga IAIS, IOPS dhe IOSCO.

Nxitja kryesore në bërjen e këtyre ndryshimeve dhe shtesave ishte krijimi i kushteve ligjore për të respektuar pavarësinë, që iu njoh fillimisht AMF-së, për të parashikuar mekanizmat e nevojshëm ligjorë për mbrojtjen e pavarësisë së AMF-së në të ardhmen, si dhe për të përforcuar përgjegjshmërinë e këtij institucioni.

Në zbatim të rekomandimeve të Misionit FSAP, nëntor-dhjetor 2013, Autoriteti dërgoi pranë Ministrisë së Financave draftin përfundimtar të Ligjit **"Mbi disa shtesa dhe ndryshime**

**në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare"".** Së bashku me këtë projektligj, AMF propozoi gjithashtu ndryshime në Ligjin nr. 152/2013, **"Për nëpunësin civil"** dhe në Ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 **"Për pagat"**. Këto ndryshime u bënë duke u bazuar në rekomandimin e dhënë nga FMN dhe BB.

### Rekomandimet e misionit FSAP

Misioni FSAP rekomandoi amendimin dhe miratimin nga Kuvendi të Ligjit "Për AMF-në", si paketë së bashku me amendimin e Ligjit "Për nëpunësin civil" dhe të Ligjit "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj". **Rekomandimi** për këtë paketë ligjore **synon forcimin e pavarësisë operacionale dhe financiare të Autoritetit**. Sipas rekomandimeve, këto ligje duhen amenduar:

- Për të shfuqizuar kërkesat ligjore që struktura organizative e AMF-së të miratohet nga Kuvendi;
- Për të përjashtuar AMF nga struktura e kompensimit dhe përfitimeve të punonjësve të qeverisë, me qëllim që të ketë mundësi të tërheqë dhe mbajë punonjës që kanë përvojë teknike të mjaftueshme;
- Për t'i dhënë Bordit dhe punonjësve të AMF-së mbrojtje të mjaftueshme ligjore gjatë ushtrimit në mirëbesim të funksioneve dhe kompetencave të tyre.

Gjatë vitit 2013, me qëllim rregullimin e veprimtarisë së përgjithshme, administrative të Autoritetit, Bordi i AMF-së, me Vendim nr. 12, datë 30.01.2013 miratoi Rregulloren **"Për hartimin, ndjekjen, miratim dhe zbatimin e buxhetit për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare"**. Qëllimi i kësaj rregulloreje synon përmirësimin e procesit të planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, ndjekjen më të mirë të procesit të arkëtimit të të ardhurave si përmirësimin e procesit të përdorimit të tyre.

Në zbatim të angazhimit të Autoritetit për mbrojtje e të dhënave personale gjatë përpunimit të tyre sipas rekomandimit të dhënë nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është hartuar dhe miratuar nga Bordi **Rregullorja nr. 93, datë 25.09.2013 "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale"**. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e procedurave organizative e teknike, masave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurisë, ruajtjes dhe administrimit të të dhënave personale nga strukturat e AMF-së. Ajo është hartuar në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe akteve ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe funksionimin e AMF-së. Kjo rregullore është pjesë e Rregullores "Rregullat e Brendshme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare" miratuar me Vendim Bordi nr 7, datë 30.08.2007.

## 5.4 Teknologjia e Informacionit

Teknologjia e Informacionit (TI) në AMF është zhvilluar në përputhje me strategjinë kombëtare të informatizimit, si pjesë e pandarë e institucionit duke pasur si objekt pune zhvillimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e strukturës informatike.

Edhe gjatë vitit 2013, sistemet kryesore të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në AMF kanë funksionuar në mënyrë të vazhdueshme duke siguruar mbështetjen e funksioneve bazë të Autoritetit si mbikëqyrja dhe rregullimi. Sistemet e TI në AMF kanë siguruar edhe koordinimin e punës me institucionet me të cilat AMF ka bashkëpunim për shkëmbimin e informacionit. Gjithashtu, është synuar edhe në zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve të brendshme të instaluara në AMF.

Gjatë 2013-ës është realizuar edhe projekti për menaxhimin e dokumentacionit dhe përmbledhja e materialeve të mbledhjeve të Bordit të AMF-së.

Përveç detyrave funksionale të lidhura ngushtësisht me funksionet e mbikëqyrjes, inspektimit dhe rregullimit, gjatë vitit 2013 dhe në vazhdim sistemet e TI në AMF do të kryejnë:

- Mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës teknike të Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik (Regjistri Elektronik *Online* të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, Regjistri i Dëmeve, përshtatja për aplikimin e strategjisë dhe sistemit *Bonus-Malus*);
- Mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së shërbimeve ndërinstitucionale të dhëna nga AMF;
- Përgatitjen dhe konfigurimin e mëtejshëm të infrastrukturës së brendshme të shërbimeve të AMF;
- Monitorimin e përditësimin e faqes zyrtare *online* të AMF-së;
- Zgjerimin e mirëmbajtjen e lidhjeve Internet dhe shkëmbimit të të dhënave të AMF-së në kuadër të përdorimit në rritje të sistemeve TI;
- Hartimin dhe zbatimin e programeve të sigurisë, duke ruajtur konfidencialitetin, integritetin dhe besueshmërinë e informacioneve të AMF-së.

Gjatë vitit 2013 është projektuar një investim cilësor në *hardware* tek serverat e AMF-së, si bërthama e sistemeve informatike të lidhur ngushtësisht me zhvillimin dhe forcimin tregut. Ky projekt do të zbatohet gjatë tremujorit të parë të 2014. Projekti do të aplikojë teknologjinë e gjeneratës së fundit *hyper-v* në çdo komponent përbërës të saj. Ky përmirësim i aktivitetit të brendshëm, siguron administrimin e vazhdueshëm në nivel *hardware*, aplikimesh, bazë të dhënash, menaxhimin e sigurisë, duke realizuar kështu një ndër objektivat kryesorë të AMF-së për t'i shërbyer sa më mirë konsumatorit në tregjet nën mbikëqyrje.

## Sfida dhe projekte të ardhshme, 2014-2016

Arritjet e deritanishme kanë krijuar një bazë të përshtatshme për përcaktimin e disa drejtimeve të rëndësishme për zhvillim për periudhën afatmesme (2014-2016), të cilat i përkasin:

- Forcimit të pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së AMF-së;
- Përmirësimit të cilësisë dhe efektivitetit të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve financiare nën mbikëqyrje;
- Nxitjes së zhvillimit dhe qëndrueshmërisë së tregjeve financiare nën mbikëqyrje.

***Objektivi themelor për zhvillimin institucional të AMF-së mbetet forcimi i pavarësisë dhe i përgjegjshmërisë***. Në përmbushje të këtij objektivi, AMF ka paraqitur në Qeveri paketën ligjore për ***forcimin e pavarësisë së AMF-së, sidomos të përmasës financiare***, si dhe përfshirjen e dispozitave të reja që do të shërbejnë si ***mekanizma mbrojtës që pavarësia të mos cenohet*** në të ardhmen.

Përmbushja e objektivit të ***përmirësimit të cilësisë dhe efektivitetit të mbikëqyrjes dhe rregullimit, si hap të parë ka stabilizimin e tregjeve financiare nën mbikëqyrje***. Kjo nënkupton marrjen e masave për forcimin e qëndrueshmërisë financiare në subjektet e mbikëqyrura, kryesisht në tregun e sigurimeve, të cilat kontribuojnë edhe në forcimin e qëndrueshmërisë së tregjeve në tërësi, si dhe rritjen e vetëdijes së konsumatorëve për rreziqet që marrin përsipër në investime. Në vitin 2014 masat do të përqendrohen kryesisht në:

- Përmirësimin e administrimit të Fondit të Kompensimit;
- Financimin e detyrimeve të prapambetura të Fondit të Kompensimit;
- Përmirësimin e praktikave për krijimin e rezervave për MTPL dhe financimin e tyre;
- Hartimin dhe zbatimin e strategjisë që lidhet me edukimin e klientëve të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive (SIK) dhe të fondeve të pensioneve private.

Bazuar në rëndësinë që ka qëndrueshmëria financiare dhe në rekomandimet që lindin nga planet e posaçme të veprimit të hartuara nga GKSF, AMF, me asistencën e FSVC-së dhe ekspertë nga BaFin[16], ka konceptuar një plan të posaçëm veprimi për situata të jashtëzakonshme, si pjesë përbërëse e një plani më të gjerë për bashkërendimin e veprimeve me MF, BSH dhe ASD për veprimin në situata të mundshme krizash.

Ndër elementet qendrore të këtij dokumenti është ***ngritja e një fondi garancie për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës***, për shkak të korrelacionit të produkteve të caktuara

Shënim: [16] Bundesanstalt für Finanzdienstleistungsaufsicht – Federal Financial Supervisory Authority – Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Gjermani.

me aftësinë paguese të siguruesve dhe me qëllim mbulimin e përgjegjësive të siguruesve të Jo-Jetës në kohë krize. Fillimisht vlerësohet se është e përshtatshme të krijohet një fond garancie për sigurimin e detyrueshëm motorik, si klasa më e rëndësishme dhe me korrelacionin më të fortë me performancën e shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës.

***Nxitja e zhvillimit të tregjeve financiare nën mbikëqyrje***, nënkupton marrjen e masave që çojnë në shtim të ofertës së produkteve në tregje; përafrimin me standardet ndërkombëtare në aktivitetin e mbikëqyrjes apo shtirjen e metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus riskun edhe në tregje të tjera. Për rrjedhojë, AMF në bashkëpunim me operatorët e tregjeve, po punon për:

- Rritjen e gamës së sigurimeve të detyrueshme për përgjegjësitë profesionale;
- Trajtimi tatimor për shërbimet në tregun e sigurimeve dhe të pensioneve private në harmoni me praktikat e mira botërore;
- Ndërtimin e kapaciteteve për mbikëqyrjen e AML/CFT;
- Përmirësimin e analizës së prospekteve.

Në kuadër më afatgjatë po punohet me strategjinë e zhvillimit të tregut të letrave me vlerë. *Duke pasur parasysh gjendjen aktuale të tregut të kapitaleve në vend, në strategji vërehet se nuk ka një zgjidhje të vetme për zhvillimin e këtij tregu*. Prandaj, ***rekomandohet që të ndiqet një metodë gjithëpërfshirëse***, ku të merren parasysh të gjitha palët e interesuara dhe ***të krijohet një Task Force ndër-institucionale për bashkërendimin e veprimeve*** që mundësojnë zbatimin e strategjisë. Si pjesë e kësaj strategjie përfshihen disa rekomandime konkrete për nxitjen e Bursës së Tiranës, si për shembull krijimin e platformës së tregtimit të titujve qeveritarë, lejimin e listimit të shoqërive të kontrolluara në Bursë dhe, mbi këtë bazë, ndryshimin e kritereve të listimit, apo krijimin e platformave të tregtimit për rishitjen e titujve me ofertë private, etj.

***Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullativ*** nëpërmjet hartimit të ligjeve dhe rregulloreve apo amendimeve të tyre, synimi është i pandryshueshëm, rritja e shkallës së përafrimit me direktivat e BE-së dhe me standardet e parimet ndërkombëtare të mbikëqyrjes financiare. Për vitin 2014 në fokus të punës së AMF-së do të jenë:

- Miratimi i paketës së ndryshimit të ligjeve të AMF-së, shërbimit civil dhe strukturës e pagave në institucionet e pavarura për të forcuar pavarësinë e autoritetit rregullator, si dhe kuadrit rregulator përkatës;
- Miratimi i ligjit për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve, së bashku me kuadrin rregullator përkatës, gjë që nënkupton hartimin dhe miratimin e 53 dokumenteve rregullatore;
- Miratimi i ndryshimeve në ligjin për pensionet dhe SIK;
- Miratimi i ndryshimeve në ligjin për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit.

***Mbikëqyrja me fokus riskun*** në shoqëritë e sigurimit, si dhe shtrirja e metodologjisë në tregjet e letrave me vlerë dhe pensioneve. Me hyrjen në fuqi të ligjit të sigurimeve, AMF do të ketë kuadrin e duhur ligjor, për të filluar zbatimin gradual të mbikëqyrjes me fokus riskun, në përputhje me rekomandimet e FSAP.

***Sistemi i Menaxhimit të Informacionit***. Synimi kryesor është që AMF të shtrijë platformën e raportimit elektronik edhe në segmente të tjera të tregjeve financiare që mbikëqyr AMF, përkatësisht në tregun e pensioneve dhe letrave me vlerë. Vlen të theksohet, që ky sistem përbën tashmë bërthamën e raportimit dhe të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve dhe në afatgjatë do të jetë platforma e vetme e raportimit të subjekteve në AMF. Në aspektin strategjik, sistemi ofron garanci për vënien në zbatim të paketave të raportimit të Solvency II, kur KE do të kërkojë përputhjen e plotë me Direktivën.[17]

***Ndërtimi i një sistemi të paralajmërimit të hershëm për tregun e sigurimeve***. AMF po punon për ndërtimin e një sistemi unik të paralajmërimit të hershëm për tregun e sigurimeve, nëpërmjet të cilit do të identifikohen fushat me risk të lartë në veprimtarinë e siguruesve dhe do të mundësohet identifikimi dhe shmangia e problemeve, përpara se ato të materializohen. Një sistem i tillë disponohet vetëm nga disa rregullatorë të konsoliduar dhe është, gjithashtu, pjesë e strategjisë së parandalimit të krizave, që AMF ka konsultuar dhe me GKSF-në.

***Zhvillimi teknologjik për të mbështetur aktivitetin mbikëqyrës*** *konsiston në këto veprime:*

- Kryerja e ndryshimeve në Regjistrin e Shitjeve për të mundësuar shfaqjen automatike tek agjentët e shitjes të të dhënave kryesore të mjeteve motorike, të pronarëve të tyre dhe të kategorizimit të riskut, si dhe marrjen në kohë reale për çdo policë sigurimi, të të dhënave mbi mjetin, pronarin, dhe elementet bazë të Certifikatës *Bonus-Malus* për secilin nga drejtuesit e mjetit;
- Shfaqja, nëpërmjet "Portalit të Shërbimeve për Shoqëritë e Sigurimit", e rezultateve në lidhje me kontrollin në kohë reale nga institucionet në bashkëpunim, si Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH), nëpërmjet integrimit të kontrollit të vlefshmërisë së policave me sistemin e kontrollit *online* të vendosur në qendrat operative "*eGjoba*", si dhe e elementëve bazë të Certifikatës *Bonus-Malus*, e cila krijon mundësinë e kategorizimit të riskut.

***Rregullimi efektiv i tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik.*** *Heqja e menjëhershme me ligj e regjimit të tarifave fikse në sigurimin e detyrueshëm motorik përbën një sfidë për rregullimin e këtij tregu në mënyrë efektive. Kështu, AMF po fokusohet kryesisht në drejtimet e mëposhtme:*

Shënim: [17] Sisteme të ngjashme moderne ekzistojnë vetëm në pak vende të botës, ku rregullatori financiar i Anglisë ka qenë nga institucionet e para që ka zbatuar një sistem të ngjashëm.

- Zhvillimin e proceseve drejt tarifimit me bazë riskun të produkteve të sigurimit të detyrueshëm motorik;
- Përafrimin e kuadrit aktual ligjor që rregullon sigurimin e detyrueshëm motorik me direktivat e BE-së;
- Rritjen e kapaciteteve aktuariale në funksion të provigjonimit të kujdesshëm dhe tarifimit me bazë risku;
- Zhvillimet në sistemet e teknologjisë së informacionit në mbështetje të procesit të tarifimit me bazë risku dhe provigjonimit të kujdesshëm.

Kalimi në një sistem të qëndrueshëm të sigurimeve të detyrueshme motorike nuk mund të kryhet në mënyrë të menjëhershme dhe pa pasur probleme gjatë zhvillimit. Siguruesit duhet të ndërtojnë një bazë të dhënash konkrete, ndaj si për AMF-në, ashtu edhe për siguruesit është kusht kritik përmirësimi i sistemit të teknologjisë së informacionit sikurse është zhvillimi dhe mbajtja e kapacitetit profesional të punonjësve të tyre. Siguruesit shqiptarë mund të lëvizin gradualisht drejt një sistemi të ekuilibruar, ku çmimet përcaktohen në mënyrë të qëndrueshme dhe në një formë të tillë që të nxitet drejtimi i automjeteve në mënyrë të sigurtë.

# SHTOJCA A
## Struktura e AMF



# SHTOJCA B
## Lista e institucioneve të mbikëqyrura

### TREGU I SIGURIMEVE

| | 1. INSIG sh.a. | 2. SIGMA Vienna Insurance Group sh.a. | 3. SIGAL Uniqa Group Austria sh.a. | 4. ATLANTIK sh.a. |
|---|---|---|---|---|
| *Drejtor i Përgjithshëm* | Tomor KALAJA | Qemal DISHA | Avni PONARI | Dritan ÇELAJ |
| *Fusha e Aktivitetit* | Sigurime Jetë + Jo-Jetë | Sigurime Jo-Jetë | Sigurime Jo-Jetë, Risigurime | Sigurime Jo-Jetë |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital shtetëror | Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas | Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas | Shoqëri me kapital vendas |
| *Adresa e Selisë* | ABA Center, Rruga "Papa Gjon Pali II", kati i gjashtë, zyra nr. 600, Tiranë | Rr "Komuna e Parisit", Kutia Postare Nr. 1714, Tiranë | Bul. "Zogu I", Nr. 1 , Kutia Postare Nr. 2387, Tiranë | Rr. "Themistokli Gërmenji", 3/1, Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 42 223 838 | +355 42 258 254/ 253 | +355 42 233 308/ 253 407/408/ +355 42 250 220 | +355 42 230 506 +355 42 235 088 |
| *Faqja e Internetit* | *www.insig.com.al* | *www.sigma-al.com* | *www.sigal.com.al* | *www.atlantik.com.al* |
| *Posta Elektronike* | *info@insig.com.al* | *info@sigma-al.com* | *info@sigal.com.al* | *atlantik@atlantik.com.al* |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 3 dt. 08.06.2000 Nr. 4 dt. 08.06.2000 | Nr. 01 dt. 03.02.1999 | Nr. 02 dt. 23.06.1999 Nr. 06 dt. 03.02.2006 | Nr. 5 dt. 13.04.2001 |
| *Dt. mbarimit të licencës* | Pa afat | Pa afat | Pa afat | Pa afat |

| | 5. INTERSIG Vienna Insurance Group sh.a. | 6. EUROSIG sh.a. | 7. INTERALBANIAN Vienna Insurance Group sh.a. | 8. ALBSIG sh.a. |
|---|---|---|---|---|
| *Drejtor i Përgjithshëm* | Gentian SULA | Muharrem BARDHOCI | Bardhyl MINXHOZI | Natasha DHOQINA |
| *Fusha e Aktivitetit* | Sigurime Jo-Jetë | Sigurime Jo-Jetë | Sigurime Jo-Jetë | Sigurime Jo-Jetë |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas | Shoqëri me kapital vendas | Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas | Shoqëri me kapital vendas |
| *Adresa e Selisë* | Rr. "Ismail Qemali", Ndërtesa Samos Tower, kati 2, Kutia Postare 8292, Tiranë | Rr "Papa Gjon Pali II", vila Nr. 5, Tiranë | Rr. "Sulejman Delvina", Zayed Business Center, Kutia Postare Nr. 277/1, Tiranë | Rr. "George W. Bush", Nr. 10, Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 42 270 576/577 | +355 42 238 899/999, +355 42 223 841 | +355 42 229 578 +355 42 229 511, | +355 42 254 770 +355 42 254 664 |
| *Faqja e Internetit* | *www.intersig.al* | *www.eurosig.al* | *www.interalbanian.com* | *www.albsig.com.al* |
| *Posta Elektronike* | *info@intersig.al* | *info@eurosig.al* | *info@interalbanian.com* | *info@albsig.com.al* |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 6 dt. 13.09.2001 | Nr. 7 dt. 8.07.2004 | Nr. 9 dt. 19.07.2004 | Nr. 10 dt. 19.07.2004 |
| *Data e mbarimit të licencës* | Pa afat | Pa afat | Pa afat | Pa afat |

| | 9. ANSIG sh.a. | 10. SICRED sh.a. | 11. SIGAL-LIFE Uniqa Group Austria sh.a. | 12. MAI sh.a. |
|---|---|---|---|---|
| *Drejtor i Përgjithshëm* | Edlir RUKA | Genc KOXHAJ | Edvin HOXHAJ | Elnar GASHI |
| *Fusha e Aktivitetit* | Sigurime Jo-Jetë | Sigurime Jetë | Sigurime Jetë | Broker në sigurime dhe risigurime |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital vendas | Shoqëri me kapital vendas | Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas | Shoqëri me kapital të huaj |
| *Adresa e Selisë* | Rr. “Donika Kastrioti”, Vila 9/1 (Rr. 4 Shkurti), Tiranë | Rr. “Jul Varibova”, përballë Top-Channel, Tiranë | Bul. “Zogu I”, Nr 1, Tiranë | Rr. “Ismail Qemali”, pallati Gener 2 (Valle Verde), Kati III, zyra 4, Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 42 263 490/445/486 | +355 42 237 549<br>+355 42 237 530 | +355 42 253 407/ 408<br>+355 42 233 308 | +355 42 500 514 |
| *Faqja e Internetit* | *www.ansig.al* | *www.sicred.com.al* | *www.sigal.com.al* | *www.mai-cee.com* |
| *Posta Elektronike* | | *contact@sicred.com.al* | *infolife@sigal.com.al* | *elnar.gashi@mai-cee.com* |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 12 dt. 22.06.2012 | Nr. 8 dt. 26.07.2004 | Nr. 11 dt. 28.07.2004 | Nr. 1 dt. 11.09.2008 |
| *Data e mbarimit të licencës* | Pa afat | Pa afat | Pa afat | Pa afat |

| | 13. 3B BROKER sh.a. | 14. DEVON sh.a. | 15. ALL - SIG sh.a. | 16. A-EJA INSURANCE BROKER sh.a. |
|---|---|---|---|---|
| *Drejtor i Përgjithshëm* | Bashkim KRYEZIU | Valbona CARCANI | Rezarta ZHUKRI | Anila QENDRO |
| *Fusha e Aktivitetit* | Broker në sigurime në klasat e Jo-Jetës | Broker në sigurime në klasat e Jo-Jetës dhe Jetës | Broker në sigurime në klasat e Jo-Jetës | Broker në sigurime në klasat e Jo-Jetës |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital vendas | Shoqëri me kapital vendas | Shoqëri me kapital vendas | Shoqëri me kapital vendas |
| *Adresa e Selisë* | Rr. “Mustafa Matohiti”, pallati 7, shk. 2, ap.8, Tiranë | Bul. “Bajram Curri”, Rr. “As-dreni”, pallati 4, shk. 1, ap1, Tiranë | Rr. “Abdyl Frasheri”, pallati De Rada, Tiranë | Rr. “Pjetër Bogdani”, Pall 20, kat 1, Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 42 248 768/42 248 756 | +355 42 379 925,<br>+355 69 20 58424 | +355 42 257 903 / 42 238 018, | +355 42 249 952<br>+355 42 227 307 |
| *Faqja e Internetit* | | | | |
| *Posta Elektronike* | *info@3bbroker.al* | *valbona_carcani@yahoo.com* | *allsigbroker@gmail.com* | *a.qendro@a-ejainsurance.com* |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 2 dt. 26.03.2009 | Nr. 3 dt. 10.12.2009<br>Nr. 12 dt 23.12.2013 | Nr. 5 dt. 19.03.2010 | Nr. 7 dt. 21.05.2010 |
| Data e mbarimit të licencës | Pa afat | Pa afat | Pa afat | Pa afat |

| | 17. SMART Brokers sh.a. | 18. WVP Ndërmjetës në sigurime sh.a. | 19. STAR BROKER sh.a. |
|---|---|---|---|
| *Drejtor i Përgjithshëm* | *Përparim ISUFI* | *Ardian KELMENDI* | *Arben SIMAKU* |
| *Fusha e Aktivitetit* | Broker në sigurime në klasat e Jo-Jetës | Broker në sigurime në klasat e Jetës dhe Jo-Jetës | Broker ne sigurime për klasat e Jo-Jetës |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital vendas | Shoqëri me kapital të huaj | Shoqëri me kapital vendas |
| *Adresa e Selisë* | Bul. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, kati 2, Tiranë | Rr. "Sami Frashëri", Pallati Vortek 2, shkalla 2, Ap.5, Tiranë | Rr. Nikolla Tupe, Pall. 1/1, Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 42 269 435 | +355 42 224 525 | +355 69 40 37 001 |
| *Faqja e Internetit* | | *www.wvp.al* | |
| *Posta Elektronike* | *p.isufi@gmail.com* | *wvptirana@wvp.al* | *arben.simaku@gmail.com* |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 9 dt. 18.01.2012 | Nr. 10 dt. 25.04.2012 | Nr. 11 dt. 23.05.2013 |
| *Data e mbarimit të licencës* | Pa afat | Pa afat | |

## TREGU I LETRAVE ME VLERË

| | 1. RAIFFEISEN BANK sh.a. | 2. BANKA KOMBËTARE TREGTARE sh.a. | 3. INTESA SAN PAOLO Bank Albania sh.a. |
|---|---|---|---|
| *Drejtor Ekzekutiv* | *Christian CANACARIS* | *Seyhan PENCAPLIGIL* | *Silvio PEDRAZZI* |
| *Fusha e Aktivitetit* | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH. | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH. | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH. |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital të huaj | Shoqëri me kapital të huaj | Shoqëri me kapital të huaj |
| *Adresa e Selisë* | European Trade Center, Bul. "Bajram Curri", Tiranë | Bul. "Zhan D'ark", Tiranë | Rr. "Ismail Qemali", Nr. 27, Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 42 381 381<br>+355 42 275 599 | +355 4 250 955, +355 4 250 956 | +355 42 276 000/42 248 762 |
| *Faqja e Internetit* | *www.raiffeisen.al* | *www.bkt.com.al* | *www.intesasanpaolobank.al* |
| *Posta Elektronike* | *info@raiffeisen.al* | *info@bkt.com.al* | *opinion@intesasanpaolobank.al* |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 3 dt. 25.06.2009<br>Nr. 6 dt. 29.09.2010 | Nr. 4 dt. 25.06.2009<br>Nr. 7 dt. 18.11.2010 | Nr. 6 dt. 25.06.2009<br>Nr. 2 dt. 21.05.2010 |
| *Data e mbarimit të licencës* | Pa afat | Pa afat | Pa afat |

| | 4. ALPHA BANK -Tirana sh.a. | 5. BANKA CREDINS sh.a. | 6. BANKA E TIRANËS sh.a. |
|---|---|---|---|
| *Drejtor Ekzekutiv* | ***Periklis DROUGKAS*** | ***Artan SANTO*** | ***Savvas THALASSINOS*** |
| *Fusha e Aktivitetit* | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH. | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH. dhe i obligacioneve të shoqërive aksionare dhe të Qeverisë vendore | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH. |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital të huaj | Shoqëri me kapital vendas | Shoqëri me kapital të huaj |
| *Adresa e Selisë* | "Rruga e Kavajës", G-KOM Business Center, Tiranë | Rr."Ismail Qemali", Nr. 21, Tiranë | Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 42 233 550 | +355 42 234 096, +355 42 222 916 | +355 42 269 616/617/429<br>+355 42 269 707 |
| *Faqja e Internetit* | *www.alphabank.al* | *www.bankacredins.com* | *www.tiranabank.al* |
| *Posta Elektronike* | *qualityassurance.albania@alpha.gr* | *info@bankacredins.com* | *info@tiranabank.net* |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 7 dt. 25.06.2009<br>Nr. 3 dt. 28.06.2010 | Nr. 8 dt. 25.06.2009<br>Nr. 4 dt. 30.08.2010<br>Nr. 1 dt. 13.12.2011 | Nr. 1 dt. 21.05.2010<br>Nr. 1 dt. 21.05.2010 |
| *Data e mbarimit të licencës* | Pa afat | Pa afat | Pa afat |
| | **7. BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA sh.a.** | **8. BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE sh.a.** | **9. FIRST INVESTMENT BANK sh.a.** |
| *Drejtor Ekzekutiv* | ***Frederic BLANC*** | ***Gideon Van Den BROEK*** | ***Bozhidar TODOROV*** |
| *Fusha e Aktivitetit* | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe në tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH. | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë | Shoqëri brokerimi ne letra me vlere te Qeverisë së R.SH.<br>në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH. |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas | Shoqëri me kapital të huaj | Shoqëri me kapital të huaj |
| *Adresa e Selisë* | Bul. "Dëshmorët e Kombit", Kulla Binjake I, Tiranë | Rr. "Murat Toptani", kati VII , pranë Gjergji Center, Tiranë | Bul. "Dëshmorët e Kombit", Twin Towers Nr. 2 Kati i 14 & 15, Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 42 280 442/3<br>+355 42 280 441 | + 355 42 256 254<br>+ 355 42 235 409 | +355 42 276 702/3<br>+355 42 280 210 |
| *Faqja e Internetit* | *www.societegenerale.al* | *www.icbank-albania.com* | *www.fibank.com* |
| *Posta Elektronike* | *sgalb.info@socgen.com* | *enquiry@icbank-albania.com* | |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 5 dt. 25.06.2009<br>Nr. 8 dt. 13.12.2011<br>Nr. 5/1 dt. 21.03.2012 | Nr. 11 dt. 25.06.2009 | Nr. 12 dt. 29.09.2010<br>Nr. 5 dt. 29.09.2010 |
| *Data e mbarimit të licencës* | Pa afat | Pa afat | Pa afat |

| | 10. POSTA SHQIPTARE sh.a. | 11. KAPITAL INVEST sh.a. | 12. TRIUMF GROUP sh.a. |
|---|---|---|---|
| *Drejtor* | *Ardit ÇELA* | *Lirim MUHARREMI* | *Mirela ANGJELI* |
| *Fusha e Aktivitetit* | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë (bono thesari) të Qeverisë së R.SH. në tregun me pakicë | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakice | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital shtetëror | Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas | Shoqëri me kapital vendas |
| *Adresa e Selisë* | Rr. "Reshit Collaku", nr. 4, Tiranë | Bul. "Dëshmorët e Kombit", Twin Towers Nr. 2 Kati i 11, Tiranë | Rr. "M. Gjollesha", Kulla 2, ap. 13, Tiranë |
| *Tel./Faks* | + 355 42 222 315<br>+ 355 42 266 559 | +355 42 280 202 | +355 68 20 58 275<br>+355 42 256 081 |
| *Faqja e Internetit* | *www.postashqiptare.al* | | |
| *Posta Elektronike* | *posta@postashqiptare.al* | | |
| *Nr. Licencës/ Data e Licencës* | Nr. 10 dt. 25.06.2009 | Nr. 9 dt. 25.06.2009 | Nr. 2 dt. 25.06.2009 |
| *Data e mbarimit të Licencës* | Pa afat | Pa afat | Pa afat |

| | 13. AKSIONER INTERNATIONAL SECURITIES BROKERAGE sh.a. | 14. BURSA E TIRANËS sh.a. | 15. QENDRA E REGJISTRIMIT TË AKSIONEVE sh.a. |
|---|---|---|---|
| *Drejtor* | *Alma HASANAJ* | *Anila FURERAJ* | *Genard KASTRATI* |
| *Fusha e Aktivitetit* | Shoqëri brokerimi në tituj për blerjen dhe shitjen e titujve me porosi të klientit në tregun e licencuar në territorin e R.SH. si dhe Agjent brokeri në letra me vlerë në emër dhe për llogari të shoqërisë "Saxo Bank" | Treg i organizuar letrash me vlerë | Regjistrues i aksioneve të shoqërive tregtare |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital të huaj | Shoqëri me kapital shtetëror | Shoqëri me kapital shtetëror |
| *Adresa e Selisë* | Rr. "Qemal Stafa", pall. 31, njësia tregtare 2, nr. 20, Tiranë | Rr. "Dora D'Istria", Nr. 2, Kutia Postare 274/1, Tiranë | Rr. "George W. Bush", Nr. 13, Kutia Postare 7424, Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 44 400 600 | +355 42 265 058 | +355 42 233 442, +355 42 233 425 |
| *Faqja e Internetit* | *www.aksioner.com* | *www.tse.com.al* | *www.qra.al* |
| *Posta Elektronike* | ***info@aksioner.com*** | ***tseinfo@abcom-al.com*** | ***info@qra.al*** |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 13 dt. 28.04.2011<br>VB. Nr. 64 dt. 28.04.2011 | dt. 13.07.2007 | dt. 05.11.2002 |
| *Data e mbarimit të licencës* | Pa afat | Pa afat | Pa afat |

| | 16. APIA WEALTH MANAGEMENT ALBANIA sh.a. | |
|---|---|---|
| *Drejtor* | ***Aleksandër PRIFTI*** | |
| *Fusha e Aktivitetit* | Shoqëri këshillimi për investime në tituj | |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital vendas | |
| *Adresa e Selisë* | Rr. "Tiranë | |
| *Tel./Faks* | | |
| *Faqja e Internetit* | | |
| *Posta Elektronike* | | |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 1 dt 16.07.2013 | |
| *Data e mbarimit të licencës* | Pa afat | |
| | **FONDI I INVESTIMIT RAIFFEISEN PRESTIGJ (Ref. FI-B1)** | **FONDI I INVESTIMIT "RAIFFEISEN INVEST EURO" (Ref. FI-B2)** |
| | Nën administrimin e "Raiffeisen Invest-shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive" sh.a. | Nën administrimin e "Raiffeisen Invest-shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive" sh.a. |

## TREGU I PENSIONEVE PRIVATE VULLNETARE

| | 1. Raiffeisen Invest - Shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive sh.a. | 2. Shoqëri administruese e fondeve të pensionit SIGAL-LIFE Uniqa Group Austria sh.a. | 3. Shoqëri administruese e fondeve të pensionit SiCRED sh.a. |
|---|---|---|---|
| *Administrator i Përgjithshëm* | ***Resmi HIBRAJ*** | ***Naim HASA*** | ***Estela KOCI*** |
| *Fusha e Aktivitetit* | Shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive | Shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar | Shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital të huaj | Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas | Shoqëri me kapital vendas |
| *Adresa e Selisë* | Rr. "Bajram Currri", ETC Kati 10, Tiranë. | Bul. "Zogu I", Tiranë | Rr. "Mustafa Matohiti", Nr. 4, Tiranë |
| *Tel./Faks* | + 355 42 277 901<br>+355 42 277 905 | +355 42 233 308<br>+355 42 250 220 | +355 42 237 549/ 496/ 44 538 674 |
| *Faqja e Internetit* | *www.raiffeisen.al* | *www.fppsigal.com.al* | *www.sicred-pensions.com.al* |
| *Posta Elektronike* | *invest@raiffeisen.al* | *naimhasa@sigal.com.al* | *ekoci@sicred.com.al* |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 1 dt 18.10.2010 dhe Nr. 1 dt. 13.12.2011 | Nr. 2 dt. 30.03.2011 | Nr. 3 dt. 23.11.2011 |
| *Data e mbarimit të licencë* | Pa afat | Pa afat | Pa afat |

| | 4. FIRST INVESTMENT Bank sh.a. | 5. BANKA E TIRANËS sh.a. | 6. SOCIETE GENERALE ALBANIA sh.a. |
|---|---|---|---|
| *Drejtor Ekzekutiv* | *Bozhidar TODOROV* | *Savvas THALASSINOS* | *Frederic BLANC* |
| *Fusha e Aktivitetit* | Depozitar i aseteve të fondeve të pensionit vullnetar dhe i sipërmarrjeve të investimeve kolektive | Depozitar i aseteve të fondeve të pensionit vullnetar | Depozitar i aseteve të fondeve të pensionit vullnetar |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital të huaj | Shoqëri me kapital të huaj | Shoqëri me kapital privat të huaj dhe vendas |
| *Adresa e Selisë* | Bul. “Dëshmorët e Kombit”, Twin Towers Nr. 2 Kati i 14 & 15, Tiranë | Rr. “Ibrahim Rugova”, Tiranë | Bul. “Dëshmorët e Kombit”, Kulla Binjake I, Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 42 276 702/3<br>+355 42 280 210 | +355 42 269 616/617/429<br>+355 42 269 707 | +355 42 280 442/3<br>+355 42 280 441 |
| *Faqja e Internetit* | *www.fibank.com* | *www.tiranabank.al* | *www.societegenerale.al* |
| *Posta Elektronike* | | *info@tiranabank.net* | *info@socgen.com* |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 1 dt. 30.08.2010 dhe<br>Nr. 1 dt. 13.12.2011 | Nr. 2 dt. 18.11.2010 | Nr. 3 dt. 13.12.2011 |
| *Data e mbarimit të licencës* | Pa afat | Pa afat | Pa afat |
| | FONDI I PENSIONIT VULLNETAR RAIFFEISEN (Ref. FP 1) | FONDI I PENSIONIT VULLNETAR SIGAL (Ref. FP 2) | FONDIN PENSIONIT VULLNETAR SiCRED PENSIONS (Ref. FP 3) |
| | Nën administrimin e “Raiffeisen Invest-shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive” sh.a. | Nën administrimin e “Shoqërisë administruese të fondeve të SIGAL-Life Uniqa Group Austria” sh.a. | Nën administrimin e “Shoqërisë administruese të fondeve të pensionit SiCRED” sh.a. |

# SHTOJCA C
## Anëtarësime dhe marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara

| | | Viti | Institucioni |
|---|---|---|---|
| A. | **Anëtarësime në Organizma Ndërkombëtare të Rregullatorëve** | | |
| | IOSCO (Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë) | 1998 | KLV (sot AMF) |
| | IAIS (Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve) | 2001 | AMS (sot AMF) |
| | IOPS (Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve) | 2006 | AMF |
| B. | **Marrëveshje të Nënshkruara me Institucione Homologe Jashtë Vendit** | | |
| | Komisioni i Tregut të Kapitaleve të Greqisë | 1999 | KLV (sot AMF) |
| | Komisioni i Letrave me Vlerë të Quebecut (Autoriteti i Tregjeve Financiare të Quebec) | 2000 | KLV (sot AMF) |
| | Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursës i Italisë | 2002 | KLV (sot AMF) |
| | Agjencia e Tregut të Letrave me Vlerë të Sllovenisë | 2003 | KLV (sot AMF) |
| | Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursave i Polonisë (sot Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë) | 2003 | KLV (sot AMF) |
| | Bordi i Tregut të Kapitaleve i Turqisë | 2003 | KLV (sot AMF) |
| | Autoriteti Bankar dhe Pagesave i Kosovës (sot Banka Qendrore e Republikës së Kosovës) | 2004 | AMS (sot AMF) |
| | Komisioni i Mbikëqyrjes së Tregut Financiar i Bullgarisë | 2005 | KLV (sot AMF) |
| | Komisioni Kombëtar i Letrave me Vlerë i Rumanisë | 2005 | KLV (sot AMF) |
| | Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursës së Maqedonisë | 2005 | KLV (sot AMF) |
| | Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursës së Malit të Zi | 2005 | KLV (sot AMF) |
| | Komisioni i Letrave me Vlerë i Kroacisë (sot Agjencia e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare të Kroacisë) | 2005 | KLV (sot AMF) |
| | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) | 2008 | AMF |
| | Ministria Austriake e Financave & Autoriteti i Tregut Financiar të Austrisë | 2009 | AMF |
| | Marrëveshja Multilaterale e Mirëkuptimit me IOSCO-n | 2009 | AMF |
| | Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë, (ISA) | 2010 | AMF |
| | Agjencioni për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional të Maqedonisë, (MAPAS) | 2012 | AMF |
| | Autoriteti Evropian i Tregjeve dhe Letrave me Vlerë (ESMA) | 2013 | AMF |
| C. | **Marrëveshje të Nënshkruara me Organizata Brenda Vendit** | | |
| | Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës | 2002 | KLV (sot AMF) |
| | Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) | 2003 | KLV (sot AMF) |
| | Banka e Shqipërisë | 2005 | AMS, KLV (sot AMF) |
| | Autoriteti i Konkurrencës | 2006 | AMF |
| | Drejtoria e Përgjithshme e Doganave | 2009 | AMF |
| | Bordi i Mbikëqyrjes Publike | 2010 | AMF |
| | Ministria e Brendshme | 2011 | AMF |
| | Ministria e Punëve Publike dhe Transportit | 2011 | AMF |
| | Marrëveshje në kuadrin e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF) | 2012 | AMF |
| | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor | 2012 | AMF |

# SHTOJCA D
# Raporti i Ekspertit Kontabël të Regjistruar të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

## Raporti i Ekspertit Kontabel të Regjistruar të Pavarur

### Bordit të AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të cilat përfshijnë bilancin më 31 dhjetor 2013 dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

### *Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Manualin Kontabël për Klasifikimin Buxhetor Ekonomik, Planin Kontabël për Institucionet Buxhetore dhe Udhëzimeve Nr. 14 dt. 28.12.2006 dhe Nr. 26. dt. 27.12.2007 të Ministrit të Financave si dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

### *Përgjegjësia e Ekspertit Kontabel të Regjistruar*

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë që mbështet tepricat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura janë në varësi të gjykimit tonë, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, prej gabimit apo mashtrimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne shqyrtojmë kontrollin e brendshëm, i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por që nuk kanë për qëllim shprehjen e një opinioni për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdoruara dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga Drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

## *Opinioni*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare më 31 dhjetor 2013 si dhe performancën financiare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Rregullat dhe Politikat Kontabel në fuqi për Institucionet Buxhetore dhe të ngjashme me to.

Tiranë, Shqipëri
31 Mars 2014

Rezarta KOCOLLARI
Eksperte Kontabël e Regjistruar
Adresa: Rr. Adem Seit Kruja, Nr.6/1, 1, 5.

## Bilanci për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012

| AKTIVI I BILANCIT KONTABËL | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012 |
|---|---|---|
| **AKTIVE TË QËNDRUESHME** | **74,918,988** | **90,086,273** |
| **I. TË PA TRUPËZUARA** | | |
| Studime dhe kërkime | | |
| Koncesione, patenta, licensa e të tjera të ngjashme | | |
| Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara (-) | | |
| Shpenzime për rritjen e AQ të patrupëzuar | | |
| **II. AKTIVE TË QËNDRUESHME TË TRUPËZUARA** | **74,918,988** | **90,086,273** |
| Toka, troje, terene | | |
| Ndërtime e konstruksione | 50,708,505 | 66,821,105 |
| Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune | | |
| Mjete transporti | 6,450,000 | 6,450,000 |
| Rezerva shtetërore | | |
| Kafshë pune e prodhimi | | |
| Inventar ekonomik | 43,466,180 | 50,400,168 |
| Amortizimi i aktiveve të qëndrushme të trupëzuara | (25,705,697) | (33,585,000) |
| Shpenzime në proces për rritjen e AQT | | |
| **III. AKTIVE FINANCIARE** | | |
| Huadhënie e nënhuadhënie | | |
| Pjesëmarrje në kapitalin e vet | | |
| **AKTIVE QARKULLUESE** | **31,798,899** | **35,866,631** |
| **I. GJENDJA E INVENTARIT** | **6,543,017** | **4,411,854** |
| Materiale | 3,962,589 | 1,851,596 |
| Objekte inventari | 2,580,428 | 2,560,258 |
| Prodhime, punime e shërbime në proces | | |
| Produkte | | |
| Mallra | | |
| Shuma të parashikuara për zhvlerësim të inventarit (-) | | |
| **II. KËRKESA ARKËTIMI MBI DEBITORËT** | **20,748,667** | **22,898,818** |
| Furnitorë (Debitorë), parapagime e pagesa pjesore | | |
| Klientë e llogari të ngjashme | 15,019,575 | 14,235,636 |
| Personeli, paradhënie, deficite e gjoba | 229,092 | 163,182 |
| Të drejtat e taksa për t'u derdhur në shtet | | |
| Debitorë të ndryshëm | 5,500,000 | 8,500,000 |
| Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-) | | |

| | | |
|---|---|---|
| **III. LLOGARITË FINANCIARE** | **4,507,215** | **8,555,959** |
| Llogaritë në bankë | 4,507,215 | 8,555,959 |
| Disponibilitete në thesar | | |
| Llogari në arkë | | |
| Garanci bankare | | |
| **LLOGARI TË TJERA AKTIVE** | | |
| Diferenca konvertimi aktive | | |
| Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime | | |
| Shpenzime të periudhave të ardhshme | | |
| **REZULTATI I USHTRIMIT** | | |
| **TOTALI I AKTIVIT** | **106,717,887** | **125,952,904** |

| PASIVI I BILANCIT KONTABËL | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012 |
|---|---|---|
| FONDE TË VETA | 66,700,524 | 83,182,536 |
| I. Fonde të veta | 66,700,524 | 83,182,536 |
| Fonde bazë | 66,700,524 | 83,182,536 |
| Grante të brendshme kapitale | | |
| Grante të huaja kapitale | | |
| Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme | | |
| II. Fonde të tjera të veta | | |
| Fonde rezervë | | |
| Caktim nga rezultati i vitit për investime | | |
| Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme | | |
| III. Rezultati i mbartur | | |
| IV. Subvencione të jashtëzakonshme | | |
| V. Pjesëmarrje të institucionit në investime për të tretë | | |
| VI. Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime | | |
| DETYRIME | | |
| I. Borxhe afatgjatë | | |
| Huamarrje e brendshme dhe të ngjashme | | |
| Huamarrje e huaj | | |
| II. Detyrime afatshkurtër | 8,666,924 | 4,933,409 |
| Klientë (Kreditorë), parapagesa pjesore | | |
| Furnitorë e llogari të lidhura me to | 6,689,594 | 3,010,314 |
| Personeli e llogari të lidhura me to | 26,407 | 55,652 |
| Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa | 826,169 | 801,998 |
| Tatime të mbledhura nga shteti për llogari të pushtetit lokal | | |
| Shteti fatkeqësi natyrore | | |
| Të tjera operacione me shtetin (kreditor) | | |
| Sigurime shoqërore | 1,124,754 | 1,065,445 |
| Sigurime shëndetësore | | |
| Kreditorë të ndryshëm | | |
| LLOGARI TË TJERA | 31,350,439 | 37,836,958 |
| Të ardhura për t'u rregjistruar në vitet pasardhëse | 31,350,439 | 37,836,958 |
| Diferenca konvertime pasive | | |
| Të ardhura për t'u klasifikuar ose rregulluar | | |
| Të ardhura të arkëtuara para nxjerrjes së titullit | | |
| REZULTATI I USHTRIMIT | | |
| TOTALI I PASIVIT | 106,717,887 | 125,952,904 |

**Pasqyra e të ardhurave e shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012**

| SHPENZIME TË USHTRIMIT | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012 |
|---|---|---|
| **A. SHPENZIMET E SHFRYTËZIMIT (I-III)** | **111,744,334** | **113,080,193** |
| **I. Shpenzime korrente** | **113,717,705** | **113,166,023** |
| Paga, shpërblime e të tjera personeli | **60,211,975** | **57,689,713** |
| Paga, personel i përhershëm | 49,476,882 | 48,767,557 |
| Paga, personel i përkohshëm | 2,303,282 | 1,640,995 |
| Shpërblime | 7,993,837 | 7,281,161 |
| Shpenzime të tjera personeli | 437,974 | |
| Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore | **10,675,885** | **7,377,074** |
| Kontribute për sigurimet shoqërore e shëndetësore | 7,750,319 | 7,377,074 |
| Kontribute për fondet e pensioneve vullnetare | 2,925,566 | |
| **Mallra dhe shërbime të tjera** | **42,829,845** | **48,099,236** |
| Materiale zyre dhe të përgjithëshme | 1,278,174 | 1,682,571 |
| Materiale dhe shërbime speciale | 721,200 | 482,200 |
| Shërbime nga të tretë | 5,784,816 | 5,164,793 |
| Shpenzime transporti | 1,966,175 | 898,853 |
| Shpenzime udhëtimi | 13,311,110 | 14,113,269 |
| Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme | 828,096 | 814,164 |
| Shpenzime për qeramarrje | | 0 |
| Shpenzime për detyrime për kompesime legale | | 2,956,479 |
| Shpenzime të tjera operative | 18,940,274 | 21,986,908 |
| **Subvencionet** | | |
| **II. Ndryshimi i gjendjeve të inventarit (+-)** | **(2,131,163)** | **-516,469** |
| **III. Kuota amortizimi dhe shuma të parashikuara** | | |
| Kuotat e amortizimit të shfrytëzimit | | |
| Vlera e mbetur e AQ të nxjerra jashtë përdorimit e të shitura | | |
| **B. SHPENZIME FINANCIARE (I+II)** | **157,792** | **430,639** |
| Interesa për bono thesari dhe kredi direkte | | |
| Interesa për huamarrje të tjera | | |
| Shpenzimet nga këmbimet valutore | 157,792 | 430,639 |

| | | |
|---|---|---|
| **C. SHPENZIME TË JASHTËZAKONSHME** | | |
| Humbje nga gabime të lejuara në ushtrimin paraardhës | | |
| Shpenzime të tjera të jashtëzakonshme | | |
| **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **111,744,334** | **113,080,193** |
| **D. OPERACIONE KORRIGJUESE TE REZULTATIT** | | |
| Tituj të ardhurash të anulluara | | |
| Caktim të ardhurash funksionale për investime | | |
| Derdhje të ardhurash në buxhet | | |
| Derdhje në buxhet e të ardhurave të pa përdorura | | |
| Transferim të ardhurash brenda sistemit | | |
| Transferime për ndryshim gjendjeje | 2,131,163 | 516,469 |
| Transferim për debitorë të konstatuar e të ngjashme | | |
| **TOTALI I OPERACIONEVE** | **113,875,497** | **113,596,662** |
| **REZULTATI NGA FUNKSIONIMI** | | |
| **TOTALI** | **113,875,497** | **113,596,662** |

| TË ARDHURA TË USHTRIMIT | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012 |
|---|---|---|
| A. TË ARDHURA TË SHFRYTËZIMIT | 113,869,514 | 113,596,662 |
| I. TË ARDHURA JO TATIMORE (a+b+c) | 113,869,514 | 113,596,662 |
| a) Nga ndërmarrjet dhe pronësia | 113,869,514 | 113,589,163 |
| Nga njësi ekonomike publike dhe private jo financiare | | |
| Nga njësi ekonomike publike dhe private financiare | 113,569,514 | 113,369,163 |
| b) Shërbime administrative e të ardhura sekondare | | |
| Të ardhura nga vlerësimi i dëmeve | | |
| Nga shitja e mallrave e shërbimeve | | |
| Gjoba dhe kamatvonesa, sekuestrime e zhdëmtime | 300,000 | 220,000 |
| c) Të tjera të ardhura jo tatimore | | 0 |
| II. GRANTE KORENTE | | |
| a) Grant korent i brendshëm | | |
| Nga i njëjti nivel Qeverisjeje | | |
| Nga nivele të tjera Qeverisjeje | | |
| B. TË ARDHURA FINANCIARE | 5,983 | 7,498 |
| Nga interesat e huadhënies së brendshme | | |
| Të ardhura nga interesat e depozitave | 5,983 | 7,498 |
| Të ardhura nga këmbimet valutore | | |
| C. TË ARDHURA TË JASHTËZAKONSHME | | |
| Nga veprimtari të mbyllura e ndryshime të tjera strategjike | | |
| Nga gabime të lejuara në ushtrimet paraardhëse | | |
| Korrigjime nga vitet e kaluara | | |
| Të ardhura të tjera | | |
| TOTALI I TË ARDHURAVE | 113,875,497 | 113,596,662 |
| D. OPERACIONE TË KORRIGJUARA TË REZULTATIT | | |
| Urdhër për shpenzime anulluar ose parashkruar | | |
| Transferimi i ndryshimit të gjendjeve | | 0 |
| TOTALI I OPERACIONEVE | 113,875,497 | 113,596,662 |
| REZULTATI I VEPRIMTARISË | | |
| TOTALI | 113,875,497 | 113,596,662 |